DRITËRO & SADIJE AGOLLI



KRONOS 10
PUBLICISTIKA DHE MEMUARISTIKA



Sadije dhe Dritëro Agolli, Pogradec 1965

DRITËRO AGOLLI
SADIJE AGOLLI

DASHURI NË MOSHËN E KRISHTIT

Letërkëmbim 1964 – 1965



Copyright © 2018 - Botimet "Dritëro"

Redaktorë:
Sadije Agolli, Shaban Sinani

Korrektor:
Artan Agolli

Përgatitje për botim:
Eris Risto

Arti grafik:
Dorart Sopoti

Kopertina:
Ormira Lulani

Botues:
Elona Agolli

© 2018 Shtëpia Botuese "DRITËRO"
E-mail: publisher@driteroagolli.org
Faqja Zyrtare Dritëro Agolli
Shtëpia Botuese Dritëro
Tel: +355 4 22 363 80

Me mbështetjen e
Institucionit Financiar AK-Invest sh.a.



SEKRETI I NJË DASHURIE JETËGJATË

Më 3 shkurt 2017 Dritëroi vendosi të flinte përgjithnjë, të bënte gjumin e përjetshëm. Ai vendosi të mos merrte ndihmë nga "sisët e miut", siç i emërtoi tubat e oksigjenit, ngaqë mushkëritë e tij nuk ngopeshin me frymën e tyre.

Ai i mbylli sytë vetë, fytyra ishte shumë e qetë, me një lloj nënqeshje. Trupin e kishte drejtuar si dhe kokën, me flokët e bardha, shumë të bardha, që ia kalonin edhe ngjyrës së argjendit, e kishte vendosur në mesin e jastëkut. Në ballë thellonin vijat e rrudhave, që kishin nisur ravijëzimin e tyre gjatë viteve të maturimit, pjekurisë dhe sidomos gjatë pleqërisë. Në ato rrudha fshiheshin mendimet, dilemat, vuajtjet, pyetje-përgjigjet e një jete të gjatë...

Ky është imazhi që më ka mbetur dhe dhe që më ndjek këto ditë-netë, këto muaj në shtëpi: në dhomën e gjumit, në krevat dhe në divanin e kuq kur flinte dy vitet e fundit, më ndjek me hapa të javashëm në sallonin e madh, ulet me mua në kolltukun e tij të përhershëm, ku mbështeste krahët e gjatë dhe vinte një letër të bardhë mbi tavolinë. Qëndronte në heshtje, ndiqte lajmet në televizor, hante mëngjesin rregullisht, nxirrte stilolapsin e zi, e vendoste mbi letër dhe në heshtje fillonte ditën duke shënuar ndonjë gjë në letrën e bardhë.

Shkrepte çakmakun, pasi e kishte mbushur me benzinë, ndizte cigaren *Kent*, pinte kafen ekspres *Lavazza* të Andreas dhe shijonte ditën me diell apo me shi, e nxehtë apo e ftohtë. Kur nuk kishte fjetur natën (dhe kjo ishte bërë e zakonshme) flinte përsëri mëngjeseve dhe ngrihej më i gjallëruar, më me humor, duke ndjekur rrjedhën e ditës me ngjarje, me letrën e bardhë përpara, me fjalorë apo enciklopedi në anë të tavolinës, me ndonjë libër me poezi që ia kishin dhuruar kohët e fundit.

Qetësia prishej nga tingëllimat e telefonit, që i binin fëmijët, të afërmit, miqtë për të na pyetur për natën, planet që kishim për të dalë në qytet. Asnjë herë nuk ishim vetëm, edhe kur dolëm në pension, por, sigurisht, bënim jetën e të moshuarve, si në gjithë botën.

I rralluam shëtitjet dhe daljet në Tiranë dhe në rrethe të ndryshme, dilnim vetëm për festa ose kur na ftonin në ndonjë aktivitet, përkujtimore a në ceremoni lamtumirash të miqve...

Megjithatë, ai e mbushte ditën me punë, pasi i kërkonin artikuj vazhdimisht, i kërkonin intervista, i kërkonin mendime për probleme politike, letraro-artistike, shoqërore. Edhe punën e kërkonte vetë, kur nuk ishte i angazhuar. Ai përgatiti dhjetëra dosje me artikujt që botonte, me blloqet me shënime, me poezi, me aforizma, me tregime, që kishte shkruar, por që nuk i kishte botuar.

- Çdo gjë që shkruhet, nuk humbet, zbulohet një ditë, po të dish ta ruash, - më thoshte vazhdimisht.

Prandaj i kërkonte Elonës blloqe të mëdhenj dhe dosje për të sistemuar dorëshkrimet dhe i vendosëm të dy në sirtarët e shumtë të dy bibliotekave: të dhomës së gjumit, më të shumtat, dhe të bibliotekës në studio.

Kur ditën e 3 shkurtit Dritëroi vendosi të flinte, u trondita shumë, shumë.

Pas 52 vjetëve bashkëjetesë kjo ishte hera e parë, sekreti i vetëm, që mori me vete, vendimi i parë dhe i fundit që nuk më pyeti që kur vendosëm të martoheshim së bashku.

Tani që jam më e qetë, pas 10 muajve të largimit të tij nga kjo botë, mendoj, se kishte menduar më parë që të gjitha veprimet t'i kryente vetë, nuk donte të dëshpëronte njeri, nuk donte t'i shihte të trishtuar, nuk i duronte lotët; sytë, sidomos sytë, kërkonte t'i shihte të qartë, ku të lexonte vetëm gëzimin.

Qysh në takimet e para të dashurisë, ne i kishim rrëfyer rast pas rasti çdo gjë njëri-tjetrit për vendlindjen, për familjen,

farefisin, shoqërinë, miqësitë... Mendoj se dhe besimtari më fanatik, nuk është rrëfyer tek prifti, siç i rrëfeheshim njëri-tjetrit në ditë-netët, që kalonim së bashku.

Dhe kjo filloi qysh natën e parë, kur iu dhashë në shtëpinë e tij, kur humba virgjërinë, që ishte gjëja më e çmuar për një vajzë në ato kohëra. Ky ishte vendimi im, pa marrë lejen e askujt. Atë natë të dy u lidhëm përjetë, u betuam, se nuk do ta lëmë njëri-tjetrin, ishte celebrimi ynë pa dëshmitarë, vetëm në dritën e zbehtë të hënës dimërore. Ne i dhamë njëri-tjetrit shqetësime dhe gëzime, vuajtje dhe dashuri, mundime, përpjekje, rëndime dhe lehtësime, psherëtima dhe lot, por edhe të qeshura me shpirt, me zë të lartë, ndarje dhe afrime njësh, pra i dhamë njëri-tjetrit çdo gjë. Unë pata privilegjin, që u rrita qysh në moshën 22-vjeçare me Dritëroin, që u maturova, u poqa, u mplaka së bashku me Atë. Pata fatin e madh që atij ia pasurova Muzën për të shkruar një libër me 238 faqe poezi dashurie, përveç personazheve në romane, tregime, drama, komedi...

E ndjej veten të plotësuar në jetën time me Atë, pasi arritëm të kuptoheshim me një lëvizje dore, gishti, këmbe, syri, kollitjeje...

Ne kishim qenë kudo bashkë. Edhe shërbimet jashtë Tiranës përpiqeshim t'i bënim bashkë. Kur ai sëmurej (rrallë ndodhte, numëroheshin me gishtërinjtë e dorës) isha gjithnjë pranë tij. Edhe në kohën e socializmit, kur u sëmur me bronko-pneumoni dhe ulje tensioni, u shtruam të dy në pavijonin 12 të spitalit të sëmundjeve të brendëshme; ishim bashkë edhe në Sanatorium, edhe në spitalin *Hygeia*, kur theu këmbën në pleqëri.

Unë nuk arrita ta kuptoj vendimin e tij, dëshpërimin e tij, lodhjen e tij nga "sisët e miut" oksigjen dhe patjetër i ka hequr vetë ato për t'u çlodhur përjetësisht nga mundimet 4-vjeçare me frymëmarrjen dhe kollën e thatë; nga vuajtja se po më lodhte me vajtje-ardhjet në spital, që në atë fund janari nuk isha pranë tij, si çdo herë.

Unë i thashë doktor Perlat Kapisyzit: "Dritëroi është mësuar

që të jem pranë tij edhe në spital. Mundësisht të rri pranë tij."

- Si do të rrish? Ku të marrim gjithë atë aparaturë për ta vendosur në një dhomë të veçantë, që të rrish bashkë me të? - m'u përgjigj prerë.

Unë po citoj një poezi, që është më pak e njohur nga Dritëroi, "Në pritje":

Në rrugë është vonë e ngrin heshtja,
Zverdh hëna në perden e qiellit si buka e misrit,
Në guvën e duarve të mia ndrit shkrepësja,
Të ndizet cigarja me filtër.

Në guvën e gjoksit digjet ngadalë
Kandili i shpirtit,
Pres një grua nga porta të dalë,
Si drita e fundit e vitit.

Ta pijmë tok nga cigarja helmin e hidhur
Dhe vrerin e verdhë nga hëna,
Mbase kështu do të bëhemi pak më të ditur,
Në botën e çmendur me shpresa si fletë të rëna.

Këtë përgjigje ma dha poezia e Dritëroit. Ai kishte parashikuar dhe parashikonte në qetësi, pa bërë alarme, çdo gjë. Ishte shumë i ditur, kishte kujtesë të mahnitshme, kishte logjikë, dinte të përmbante emocionet edhe në momentet më të vështira.

Edhe vdekjen e kishte parashikuar dhe tani kujtoj kur më thoshte: "Po të shtrohem në spital, nuk kthehem më gjallë në shtëpi. Është fundi im.''

E dinte, më mirë sesa mjekët, ecurinë e sëmundjes dhe të jetës së njeriut. Atë e kishte parashikuar qysh më 13 maj të 2014-tës, kur më bëri kushtimin:

E dashur Sadije,

Të dua si jetën time, madje më shumë; unë dëshiroj sinqerisht që unë të vdes dhe ti të jetosh. Unë edhe i vdekur, do të ndjek për të të parë buzëqeshjen tënde, megjithëse kjo buzëqeshje, brenda errësirës së varrit nuk duket, por unë do të bëj të pamundurën, qoftë edhe me anën e një fluture, që do të dalë nga kockat e mia."

Dritëro Agolli

Ai, megjithëse e deklaronte veten ateist, mund të them me bindje të plotë, se në gjak kishte trashëguar besimin bektashian, duke parashikuar se do të vdiste vetëm fizikisht, pasi shpirti i tij do të jetonte përjetësisht në frymën e çdo Njeriu të mirë dhe të bukur.

Ai mbetet Perëndia e Diturisë, Mënçurisë, e Dritës, në çdo kënd ku ka jetë.

Baba Ahmeti i Kuçit kur i vuri emrin, ia paracaktoi edhe të ardhmen, që e shoqëroi nga lindja deri sa i mbylli sytë, drejtoi trupin, vendosi kokën e hijshme mbi jastëk, dhe në heshtje i dha lamtumirën të gjithëve, pa ankesa, pa ulurima...

Dhe këto i arriti duke bërë një jetë të plotë: me luftë, me përpjekje, me mundime, duke i dashur të gjithë pa përjashtim, ata që ndodheshin rreth e përqark tij. Por Ai duhet të jetonte edhe fizikisht, pasi kishte akoma për të thënë, për të folur, për të ndihmuar të tjerët, por duket se u lodh dhe vendosi vetë edhe fundin e jetës.

Mua më ka mbetur peng vetëm që nuk mora pjesë, siç kisha qenë gjithnjë përgjatë një jete, edhe në këtë vendim të tijin. Siç duket ka lënë fluturën që fluturon dhe më jep forcë për të shkruar këto rradhë, ka lënë fluturën kudo në shkrimet e tij, në sjelljet e tij, në mendimet e tij, në takimet me njerëzit e shumtë jo

vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera ku ka shkuar dhe ka udhëtuar.

Kur kthehej nga këto udhëtime, sillte përshtypjet, mbresat, sillte blloqet me shënime, copëza letrash, sillte lapsa, stilografë dhe stilolapsa.

- Duhet çdo gjë - më thoshte - edhe lapsi, se të mbetet boja e stilografit apo stilolapsit, ndërsa lapsi, si më i vjetri, të mbaron punë, prandaj bli dhe lapsa, se atë e mpreh dhe nuk mbaron kurrë, të mbaron punë në çaste të domosdoshme, kur të vjen ndonjë mendim i vlefshëm.

Kur shkonte në takime, në vizita, në mbledhje, madje dhe kur dilte në shëtitje i merrte me vete këto mjete, me bllokun e vogël ose dy-tre copëza letrash dhe i fuste në xhep.

Çdo mbledhje, çdo takim letraro-artistik, shoqëror dhe politik e merrte me seriozitet. Përgatitej, hidhte dy-tre mendime në bllok apo në letër.

- Duhet t'i respektosh njerëzit që janë mbledhur për të dëgjuar, që nga fëmija dhe deri tek më plaku. Fjalën duhet ta mendosh dhe ta hedhësh në letër, se ashtu ngjit më mirë. Ndërsa fjala që të vjen në çast, të gëzon apo të fyen pa të drejtë. Asnjëherë mos e nënvleftëso tjetrin, i çdo rangu qoftë, i çdo formimi, i çdo moshe. Duhet t'i përshtatesh, që të dëgjohet fjala dhe të komunikosh me atë - më thoshte kur më shihte se unë prishja fytyrën apo rrudhja buzët në ndonjë rast, kur paragjykoja takimin apo ndonjë mbledhje si të parëndësishme.

Ai i vinte rëndësi edhe pamjes fizike. Nuk e kam parë asnjëherë të parruar, vishej me kostumin, që e mbante kur dilte në shëtitje apo në mbledhje.

Me këshillat e tij më ndihmonte në çdo problem që më dilte, në çdo shqetësim, i rëndësishëm apo i parëndësishëm, madje edhe për ndonjë budallallëk që më vinte nga naiviteti apo sinqeriteti im i momentit.

- Me seksin e bukur duhet të sillemi me delikatesë të mos jemi brutalë, të mos e fyejmë, megjithëse kjo që më the, ishte një gomarllëk

me brirë - më thoshte duke vënë buzën në gaz, për ndonjë pyetje të pamenduar që i bëja.

Harmonia familjare mund të prishet edhe nga një gjë fare e vogël në dukje, nga gjaknxehtësia, nga indiferenca, nga ndonjë veprim i pamenduar. Prandaj çifti, sidomos kur nuk janë njohur mirë, duhet të kenë kujdes të përbashkët.

Po kujtoj një nga ngjarjet që më shkaktoi shumë dilema për zgjedhjen time. Kjo ka ndodhur 45 vjet më parë, ngjarje të cilën e kam gjallë edhe sot që kam mbushur 75 vjeç.

Jetonim në apartamentin me dy dhoma dhe një kuzhinë të vogël në pallatin karshi ndërtesës së "Zërit të Popullit", qysh në vitin 1965 kur u martuam.

Po e përshkruaj ngjarjen siç më ka mbetur në kujtesë. Duhet të kem qenë 27 vjeç, ndërsa Dritëroi, burrë i pjekur, 38-vjeçar. Elona ishte e vogël, e dërgoja në çerdhe. Sa kisha mbetur shtatzënë me Artanin, 2-3 muajsh. Pleqtë e Dritëroit, babai Riza dhe nëna Xhexhe (Hatixhe) që jetonin me ne, nuk ishin atë ditë në shtëpi, kishin shkuar nga vëllai i Dritëroit, Tajari, për drekë.

Sapo u ktheva nga shkolla e mesme "Partizani", ku isha mësuese e gjuhës dhe letërsisë shqipe, e lodhur. Ngrihesha që në orën 4 të mëngjesit për të blerë qumështin, pasi zinin radhë. Ishin kohë të vështira për të siguruar ushqimet e ditës. Dritëroi si gazetar dhe poet ishte mësuar me një jetë të lirë prej bohemi. Erdhi i gëzuar me një shok dhe duke thirrur që sapo hapi derën e shtëpisë, m'u drejtua:

- Ç'bën nusja ime e bukur, të lodhën nxënësit çamarrokë? Të kam sjellë dhe një shokun tim për drekë, se nuk kishte ku të shkonte i shkreti. Sot jemi dhe vetëm, pa pleqtë, kështu që do të gëzohemi cazë. Verën e kam sjellë. Është verë Kallmeti, nga Shkodra, qyteti yt, që na përmend gjithnjë. Do të gëzohemi bashkë me Vangjushin (shoku i tij, Vangjush Zallëmi, gazetar në "Zëri i Popullit"). Kishin pirë disa gota konjaku në klubin e gazetarëve dhe ishin çakërrqejf e llafazanë.

- Sa të shohim disa libra në dhomën tjetër, nusja ime përgatit tavolinën dhe na thërret për t'u shtruar të tre së bashku, që të gëzohemi në këtë kohë të mërzitshme.

Dhoma e pritjes, siç e quanim, kishte një bibliotekë të pasur, sidomos me libra dhe revista në gjuhën ruse, me një raft me pasqyrë të madhe à la Bourbon, franceze, me kolltukë të mëdhenj. Ishte dhe një akuarium me peshq të vegjël të kuq.

Unë isha aq e lodhur, sa doja vetëm të pushoja, të rrija shtrirë dhe mos të flisja. U ngrita nga krevati, shtrova tavolinën me ato ushqime që kisha përgatitur ndërsa shishet e verës i mora dhe i derdha në banjo.

U shtriva përsëri, pasi lajmërova Dritëroin për tavolinën e shtruar.

Zhurmonin të dy, duke më lavdëruar për drekën.

- Po shishet e verës ku janë? Mos u kanë dalë krahët dhe kanë fluturuar për në Shkodër?! - bënte humor Dritëroi.

Në dhomën e gjumit erdha në vete për atë që kisha bërë, por tani nuk zhbëhej. Superlodhje nga puna, nga thashethemet për Dritëroin qejfli i pijes, që kishte disa ditë që pinte dhe binte në gjumë pasdrekeve, të tëra këto kishin bërë punën e tyre, derisa humba logjikën; isha edhe grua e re, pa përvojë. Isha rritur në një familje kur përveç kafes, nuk pihej pije nga asnjëri. Nuk njihja zakonet e Shqipërisë jugore dhe sidomos të fshatrave.

- Na nxirr verën tani, se nuk na shijon dreka e mirë që ke shtruar. Vangjushi i gjorë mezi ç'pret për të pirë gjakun e Krishtit - më fliste Dritëroi tek krevati.

- Unë e derdha në banjo, atje i ke shishet - iu përgjigja me një farë ndrojtjeje.

- Po unë i hapa shishet për të pirë verën me Vangjushin! Si mund t'i derdhësh në banjo ? - u nxeh Ai dhe më kapi për flokësh duke më rënë dy shpulla të forta.

Unë ngriva. As nuk qava, as nuk bërtita, por vetëm qëndroja e ngrirë në krevat, pa lëvizur.

Dritëroi mbeti në këmbë pranë meje dhe më shihte i hutuar. Vangjushin e dëgjova, që thërriti: "Ika unë Dritëro."

Dritëroi u hodh tek unë në krevat dhe më tundte, ndërsa unë kisha ngrirë, as lotë, as fjalë nuk nxirrja.

Atëherë Ai u ngrit dhe u ngjit një kat më lart tek shoqja ime e shkallës, Xhina Tanini, gruaja e Niko Taninit. Me atë ndanim shpeshherë shqetësimet e jetës së përditshme.

Kisha shumë vite, që nuk kisha provuar shpulla ose shkulje flokësh. Babai ishte autoritar në shtëpinë me 10 fëmijë, por vetëm na bërtiste, na shante kur bënim prapësira, ose kur nuk shkonim në shkollë. Ai sa nevrik ishte, aq i dashur dhe fjalë të ëmbla na thoshte.

Me nënën nuk e kishim dëgjuar të zihej. Mbyllej me atë në dhomë dhe i shprehte pakënaqësitë që kishte, shkarkonte lodhjen e ditës. Nënën e kisha parë të qante fshehurazi ose nxirrte rrobat tona dhe i lante në një legen të madh tek rrasa e pusit. Aty me lodhjen e të larave, shkarkonte dufin e mbledhur nga ne fëmijët, nga im atë dhe nga të tjerët. Porosia e vetme që më dha kur u martova ishte: "Mos mbaj në shpirt asgjë. Kur ke dëshpërim, nxirre jashtë, mos e mbaj brenda helmin, por përpiqu mos të shohin, se nuk arrin të shkarkohesh dhe të qetësohesh. Shko në ndonjë vend, ku të jesh vetëm me veten tënde, shaji, nxirre atë që të mundon." - më kishte porositur ajo.

Ashtu e ngrirë kujtoja vetëm nënën time, që i kishte bërë ballë jetës me 10 fëmijë. Çdo 1 vjet e gjysëm lindte mes dhimbjeve për të nxjerrë një krijesë, pale pastaj t'i mëkëmbte dhe t'i rriste; me një burrë fanatik që ia kursente fjalët e ëmbla, që punonte në shtëpi dhe në bahçe, madje gjente kohë të lirë për të mbjellë edhe lulet.

Në atë gjendje më gjeti shoqja ime, Xhina të cilën e thërriti Dritëroi.

Ajo erdhi e tronditur, se nuk kishte ndodhur asnjëherë që Dritëroi të ngjitej në apartamentin e saj.

"Sadija është pak e sëmurë dhe nuk flet. Ulu, po deshe, poshtë, që ta shohësh, mos ka nevojë për ndonjë gjë" - i kishte thënë.

Xhina sapo erdhi, u lëshua tek unë në krevat, më tundte, më fliste pa pushim, më përkëdhelte me fjalë dhe me duar.

"Ja sa të bukura të janë bërë flokët e tua të zeza dhe kaçurrela. Fol një fjalë. Ke harruar të flasësh. Foli Xhinës tënde. Çfarë të ka ndodhur?" - më tundte ajo mbi krevatin bashkëshortor.

Ndërsa Dritëroi sillej vërdallë sa në dhomën e gjumit, sa në studio, duke marrë ndonjë libër a revistë në dorë.

Atë natë, të vetmen gjatë 52 vjetëve e kaluam të ndarë, në dy dhoma (nuk ishin pleqtë në shtëpi), pa fjalë. Këtë ngjarje ia tregova vjehrrës, Xhexhesë dhe nënës time Fatushe. Xhexheja më tha: "Edhe ti merr zjarr si pushka e jevgut." Ndërsa nëna ime, si nënë më këshilloi: "Burri, sado i shkolluar të jetë, mbetet burrë, prandaj s'duhet t'ia prishësh, deri sa e detyron të të godasë. Ja pse unë flas shpesh me vete. Ju shaj juve, të gjithëve. Edhe Qerimin (tim atë) e shaj. Shpërthe, asnjëherë mos mbaj në shpirt pakënaqësitë, pastro shpirtin, se vuan më shumë, e mbyll në vetvete dhe ngrin siç ke ngrirë ti. I bën dëm edhe vetes, edhe Dritëroit që bëri gabim me ty. Kështu lehtësohesh dhe i sheh gjërat më me gjakftohtësi." - më foli ajo si filozofe, por këto leksione i kishte nxjerrë nga përvoja e jetës së gjatë me fëmijët dhe babain fanatik, dogmatik, i cili e mbante të mbyllur në shtëpi me ferexhe dhe perçe dhe më vonë me benevrekë e shami në kokë.

Kjo histori u mbyll dhe nuk e kujtuam asnjëherë. Dritëroi i ka shprehur në shumë poezi gjatë viteve, përjetimet e veta për këtë ndodhi, që përsëritet në jetën e çdo çifti.

Unë do të citoj një poezi, që më kujton ngjarjen: "Para dhe pas shkrepëtimës" të cilën e zgjodha mes shumë poezive të tjera:

Para dhe pas shkrepëtimës

Një qetësi e tmerrshme ra mbi tokë
Dhe s'pipëtinë zogj e bar e gjeth
Veç kuvendonin kokë më kokë
Këto strategë shirash e rrufesh.

Pastaj e hodhi blozën errësira,
Çdo gjë e ndali frymën dhe u tkurr,
Veç ndonjë gur shkëputej nga rrëpira
Dhe ankthi i rëndë ngrihej si një mur.

Të dukej se në heshtje diçka ziente,
Të dukej se të fshehta ishin grindjet
Dhe pritej një tronditje të shpërthente
Dhe me rrëmbim të hynte gjer në indet.

Por shkrepëtiu dhe malet kryelartë,
Si perandorë u ngritën prapë në fron;
Kurorën e rrufeve, krejt të artë,
Me mburrje e treguan në horizont.

Dhe bari derdhi gjithë gjelbërimin
Dhe zogjtë derdhën këngë e ligjërim,
I verdhi ankth me heshtjen dhe trishtimin
Rrëpirave u shkrinë me nxitim.

Dhe burri la dyshimet dhe mërzitë,
Dhe gruan përqafoi në prag me mall,
Pas shpine mbetën zënkat dhe mëritë
Dhe dashuri e hershme u ringjall...

Çdo gjë e turbullt, e paqartë u qartësua,
Çdo grindje e mërzitshme mori fund,
Se tërsëllima me rrebeshe u lëshua
Dhe botë e vogëlsirave u shkund.

Ndofta ky është një nga ata sekretet kryesore të dashurisë së përjetshme, që më vjen në ndihmë edhe sot që jam në gjendje të vështirë shpirtërore dhe fizike. Ky është edhe sekreti i letërsisë që e ka frymëzuar dhe ka shkruar Dritëroi, që pëlqehet dhe lexohet nga shumë dashamirës të veprave të tij. Ai ka qenë njerëzor, që prekte shpirtin e njerëzve me gjithë veprën e tij, në poezi, në prozë apo në dramë, qoftë edhe në këtë letërkëmbim që do të lexoni, të shkruar 52-53 vjet më parë.

Nga ky letërkëmbim m'u zgjua kujtesa për një kohë që e kisha harruar, kishte mbetur në sirtaret e trurit, të fjetura vite dhe vite me radhë. M'u zgjuan vitet e para të njohjes, të dashurisë në mes dy të rinjve në botën e madhe dhe në kohë krejt të ndryshme nga kjo e sotmja. Në ato letra, të dashur lexues, do të gjeni naivitetin, sinqeritetin, modestinë, intimitetin e dy të rinjve, që kanë vendosur të lidhin jetën, fatet e tyre të përbashkët në njësh.

Në ndihmë më vjen përsëri Dritëroi me poezinë e tij "Letrat", i cili, duke pasur dhe fatin e një jete të gjatë, duke qenë i mënçur, i ditur, filozof, nuk ka lënë pa cekur edhe atë, që duket e parëndësishme, që ka kapur me penën e tij gjithë dukuritë njerëzore, natyrore, shoqërore...

Letrat

Kur dashuroheshim në kohën tonë,
Kur tretesha dhe digjesha për ty,
Nga njëri-tjetri letrat vinin vonë,
Kalonte dhe një muaj apo dy.

Po ndofta dashuria mbahej gjallë,
Se zjarrin mbanin letrat në udhëtim,
Me biçikletë a mushkë apo me kalë,
Me vapë e shi, dëborë dhe thëllim.

Kur dashuroheshim në kohën tonë,
Me zor na vinin letrat fshat-qytet
Nuk kishim nëpër dhoma telefonë
Dhe në ëndërr nuk kishte faks dhe internet.

Megjithatë, më mirë që nuk kishte
As telefon, as internet, as faks,
Se fjalë e nisur shpejt dhe mund ta vriste,
Një dashuri të vjetër për një çast.

Dhe ja, përsëri më vjen në ndihmë Dritëroi, i cili më jep frymë dhe kurajo për të jetuar, për të punuar, për t'u hidhëruar, por edhe për t'u gëzuar me dorëshkrimet që ruajti, i sistemoi, i përgatiti, madje, shpesh dhe i emërtoi me titullin, siç ka bërë edhe me këtë libër. Në heshtje ka punuar, i ka lexuar këto dorëshkrime dhe i sistemuam bashkë.

Ai më shihte se unë isha e ngarkuar me punë dhe probleme të ndryshme të shtëpisë, jashtë shtëpisë, me daktilografimin e romanit "Arka e djallit", të artikujve që shkruante pa mbarim, punonte i vetmuar. Emocionet e ngjallura nga leximi dhe sistemimi i tyre, i mbante për vete. Ne nuk vuajtëm asnjëherë nga boshllëku, përkundrazi nuk kishim kohë të lirë për t'u sorollatur kot.

Për të mbaruar punët dhe dosjet, që ka lënë, duhet një institut me drejtori të veçanta, pasi i ka të fushave të ndryshme.

Edhe këto dosje që gjeti Elona, u hapën kur ende ishim në jerm, kur na ndiqte Dritëroi me hapat e tij të javashme.

Kur hap dosjet, ndjej dhimbje të thellë, të papërshkruar, e kam të vështirë të shkëputem qoftë ditën, qoftë natën, me gjithë ilaçet e shumta, që pi.

Vdesin pleq, vdesin të rinj dhe të reja nga aksidente apo sëmundje të rënda, vdesin fëmijë, shuhen deri sa japin frymën

e fundit të moshuar mbi 80-90 vjeç... Secili lë pas dhimbjen, një plagë të hapur, që ngacmohet vazhdimisht nga kujtimet, mbresat, nostalgjitë, me vdekjen asnjëri nuk mësohet. Edhe unë nuk po mësohem dot. Nuk kam dëshirë të dal, të pres dhe të përcjell njerëz, e ndiej veten më mirë në vetminë time, të hedh shënime, të shfletoj dosjen e letërkëmbimit, librin me poezi "E bukura, lozonjarja, tokësorja grua" dhe çdo gjë që ka lidhje me Dritëroin...

Kjo më qetëson. Pi kafe dhe cigare pa mbarim, megjithëse përpiqem t'i rralloj.

Mendoj si do ta përjetonte Dritëroi vdekjen time. E di, se megjithëse i dobët fizikisht do të shkruante poezi të bukura për jetën dhe vdekjen, për lindjen dhe ngrysjen e ditës, për zogjtë dhe lulet, për fluturat. Do të shkruante, megjithëse gishtërinjtë i kishte të shtrembëruar nga stërmundimi i një jete të tërë.

Megjithatë, unë nuk e prisja të vdiste. Shpesh herë e kisha parë në gjendje më të vështirë, me tension shumë të ulët, me frymëmarrje shumë më të rënduar, me duar që i dridheshin, me kokë të vendosur mbi dy jastëkë, ndërsa në datën 3 shkurt ishte i qetë, i qartë në mendime, me një fill humori për politikën e ditës dhe infermieret, që i shërbenin. Prandaj m'u mbush mendja gjithë këto muaj se Ai vendosi vetë të largohej nga kjo botë, kur unë dhe fëmijët nuk ishim pranë tij. Ai donte të vdiste i bukur, siç vdiq. U drejtua në krevat, kokën e rënduar nga mendimet e vendosi në mes të jastëkut, buzët i la pak të hapura me një nënqeshje...

Kjo më qetëson dhe them, se duhet të forcohem, që të arrij me aq sa nuk kam humbur mendjen, të botoj disa vepra që ka lënë: Letërkëmbimet "Dashuri në moshën e Krishtit", publicistikën, që mund të dalë në shumë vëllime, romanin e pambaruar "Vrasja e kukuvajkës", albume me fotografi e jetëshkrimin e tij.

Por për Dritëroin kanë shkruar dhe kanë folur shumë, kanë shkruar poezi, që mund të përmblidhen në disa vëllime...

Për ta mbyllur këtë parathënie, të shkruar me shumë vështirësi, kam zgjedhur këto tre poezi:

E parëndësishmja

Vërtet ç'ka s'është e rëndësishme
Në ty e dua pa kufi
Sikur një gjë madhore të ishte
Sikur të kishte rëndësi.

Për shembull, palën e fustanit
Dhe kopsën e varur në një pe,
Apo tri qimet e nishanit,
Që për të trija bëj një be.

Ti qesh me mua shumë e hijshme
Kur them: ta dua si fidan
Atë ç'ka s'është e rëndësishme,
Se vetë i rëndësishëm jam...

Endërra e hapur

Larg nga njëri tjetri asnjëherë,
S'kemi qenë e s'jemi gjer tani;
Gjumi im për ty s'ka kyç në derë,
Ëndrra ime natën hapur rri.

Gjumin ma ke kthyer në ëndërr
Ku veç ti pa çelës hyn e del;
Ëndrrën ma ke mbyllur për të tjerët
Si një depo armësh në tunel.

Kur të jesh mërzitur shumë

Këtu s'do jem, do jem larguar
Në tokë i tretur si të tjerët,
Në kafenenë e preferuar
Nuk do të më shohin kamarierët.

Dhe nëpër udhët ku kam ecur,
S'do ndihet kolla ime e thatë,
Mbi varrin tim do rrijë i heshtur,
Një qiparis, si murg i ngratë.

Ti do trishtohesh atëherë,
Se s'do më kesh në dhomë gjallë,
Dhe kur në xham të fryjë erë,
Do qash me erën dalëngadalë.

Po kur të jesh mërzitur shumë
Në raft të librave kërkomë,
Atje i fshehur do jem unë.
Në ndonjë fjalë a ndonjë shkronjë.

Mjafton që librin pak ta heqësh
Dhe unë do zbres, do vij pas teje,
Ti si dikur me mall do qeshësh
Si një blerim pas një rrëkeje.

Sadije Agolli
1 dhjetor 2017

1964

[13.VII.1964]

E dashur Sadije,

Po punoj në shtëpi sot, se dua të mbaroj një artikull nga ata të ciklit të shërbimit tim në Korçë. Nuk më punojnë mëntë. M'u kujtove ti dhe, në vend të artikullit, po të shkruaj këtë letër. Sikur ta merrte vesh kryeredaktori, ç'komedi do të ishte!

Më duket se tani unë po e provoj që me të vërtetë të dua. Ndofta sa ishe këtu ti, më tërhiqnje instinktivisht si vajzë, si njeri i mirë, që donja të këmbenja dy-tri fjalë, që donja të ndjenja një frymëmarrje të ngrohtë. Po tani tek unë po vjen duke u thelluar një ndjenjë tjetër e fortë, e çqetësuar, me nerv të math. Unë nuk të kam thënë shumë ty për ndjenjat e mija ndaj teje, ose të kam folur përciptazi, se duhet të të flisnja sipas zakonit të përgjithshëm. Po tani unë rri i vetëm në dhomë e mendoj: Mos vallë unë veçse u ambjentova me këtë vajzë? Sikur të ishte kështu, do të ishte fatkeqësi. Pse? Sepse nuk ka gjë më të keqe se sa ambjentimi në marrëdhëniet e dy njerëzve që duan të martohen. Ambjentimi është ujë i fjetur, bile fare i palëvizshëm. Në ambjentim jeta jonë do të kalonte afërsisht kështu: Do hanim bukë në mëngjes, do shkonim në punë, do ktheheshim në shtëpi, do çlodheshim, do thoshim: "Dalim pak, hamë ndonjë pastë"? Do dilnim, do hynim në "Flora" apo "Kafe Tirana", do të të linja të futeshe ti e para për hir të mirësjelljes dhe etiketës. Do vinim në shtëpi. "E, po na thuaj ndonjë fjalë!" E unë do thosha ndonjë fjalë. Do mbaronim fjalët e do flinim. Ja ky është ambjentimi. Dhe këtij unë i kisha frikë, frikë si djallit. E shoh, pra, se unë nuk jam ambjentuar me ty në këtë mënyrë dhe as që mund të ambjentohem. Unë ty të dua në një mënyrë tjetër. Është një kërkesë shpirtërore e madhe, janë ca ndjenja të turbullta, bile ndonjëherë edhe si të egra. Tek ty unë gjithnjë synoj, gjithnjë përplasem, vij. Vij i ngatërruar; mos e dish se vij aq i qartë dhe aq shpejt ti më njohe e më analizove. Eh, moj fisheke! Veçse gjithnjë të dua.

Unë nuk jam aq i sjellshëm. Më mungon shumë etiketa në marrëdhëniet me seksin delikat. Ti edhe mund të mërzitesh ndonjëherë se gruaja do vëmendje, kujdes. Mua këto shpesh më mungojnë. Ja për shembull. Unë shkova në Korçë. Mund të të telefononja që andej. Harrova. Vij në Shkodër. Duke parë ambjentin, mund të jem më i rregullt në veshje e në të gjitha. Harroj. Nuk i bëj dot. E ndjej që janë ca gjëra të këqia në sjelljen time, po nuk ju shmangem dot. Unë e di që do ta kesh ca vështirë me mua, se jam i pagdhëndur, po kryesoren unë e kam: dashurinë e vërtetë për ty, jo një dashuri thjesht për një puthje në hënë.

E, si vajti kjo punë! Nis të shkruaj artikull dhe përfundoj në letër dashurie. E di ti se unë nuk di të shkruaj letra dashurie? Ti nuk e beson, po kjo është letra e katërt në tërë jetën time. Letra jote nga Shkodra më bëri shumë përshtypje dhe më trembi. Një vit të tërë ty do të mundohen të ta çkulën atë çka ke të bukur e të mirë ndryshe të tjerëve. Ti atje në rrethin tënd më duket se ke hyrë si një pykë në një dru të trashë e të vjetër, dru të madh, të pamposhtur. Ky dru çdo pykë mund të thyejë. Kam frikë, se, megjithëqë dashuria shpesh vajzat i bën heroike, ti, duke dëgjuar ngaherë të flitet keq për mua, do të mërzitesh e do të ftohesh, do bëhesh si të gjithë dhe druri i madh e i vjetër do vazhdojë jetën e tij të mëparëshme pa u çqetësuar. Çuditem me ca njerëz. Si nuk ka përtuar ai plaku komshi për të shkuar tek yt atë e për të më mbuluar mua me baltë? Unë me asnjë plak nuk kam pirë, se nuk kam ç'të bisedoj me njerëz të tillë. Njeriu kur pi ka dëshirë edhe të bisedojë, të bëjë muhabet. Ne kemi patur një komshi e ky ishte i ati i I.GJ., një shkodran i vjetër dhe i nderuar. Ai vetë është një qejfli i rakisë sa s'bëhet. Si është e mundur të ketë derdhur mbi mua kaq baltë? Ky plak i urtë na ka parë ne të dyve për krahu. Jam i bindur se do të ketë qënë ai vetë që i ka folur keq të t'eti. Çuditem edhe nga një fakt tjetër. Gruaja e Ilirit, dmth nusja e plakut, i pat thënë Xhexhesë se ata kanë një të kushërirën e Ilirit për të martuar. "Mirë do të ishte sikur Dritëroi të fejohej me të". Natyrisht

që unë as e vura në zjarr atë ujë. Pastaj gruaja e Ilirit filloi të më shajë në sy të të tjerëve. Si është e mundur që unë për kushrirën e tyre të mos jem pijanec dhe për ty të jem pijanec. Po ti mos u mërzit nga këto. Janë thashetheme të zakonëshme. Një njeri i urtë ka thënë se asaj dardhe që ka kokrra i bijen me gurë.

Ti më thua që unë të bëj një kostum. Më duket se nuk ka ndonjë rëndësi. Dramaturgu dhe poeti i dëgjuar francez, Korneli nuk i jepte asnjë rëndësi veshjes dhe delte jashtë si të mundëte. Kur një miku i tij desh ta kritikonte për këtë, ai iu përgjegj: "Mos vallë kështu jam më pak Kornel?" Me këtë nuk dua të justifikoj vehten. Sidoqoftë po të duash ti, edhe kostumin mund ta bëj. Unë nuk dua që ty të të bëjnë me nerva. Bile mendoj, që edhe ato dreq shënja (shënja quhen?) t'i dërgoj. Veç ty mos të të mërzitin.

Unë nuk mund të mos të të shoh ty. Ti duhet të vish në Tiranë herë pas here. Tek unë do të vish dhe jo tek ndonjë i huaj. Është një këmbëngulje e kotë ajo e njerëzve të tu. Në qoftë se ti e ke lidhur jetën me mua, s'ka përse të bësh "dashuri me ferexhe". Tani po e le letrën se më kërkojnë artikullin.

Të puth,
Dritëro

P.S. *Nuk donja ta nisnja këtë letër, se e dinja që do të vinte më vonë se sa të mbrinja unë në Shkodër. Megjithatë mendova që ta dërgoj, pasi çka është shkruar nuk duhet të humbasë. E mbajta letrën në xhep vetëm për arsye se m'u duk mjaft sentimentale ajo që kisha shkruar! Unë në përgjithësi jam sentimental, megjithëse shkruaj kundër sentimentalizmit. Në përgjithësi, unë nuk i kam aq qejf letrat, po ti më shtyn të bëj kundër dëshirës sime. Se të dua, prandaj, moj fisheke!*

D.
[16.VII.1964]

[9.VIII.1964]

E dashur Sadije,

Do të të shkruanja më parë, po pata frikë se vallë do të ishe në shtëpi, kur të vinte letra ime. Më the se do shkonje në Shëngjin. Le që ç'të të shkruaj! Unë vij kaq shpesh në Shkodër tek ti, sa që posta me tërë ato mekanizma mbetet prapa.

Në Tiranë tani bije shi e unë mendoj për ty. "E gjora, them, shkoi në plazh të prehet! Në vënd të rrezeve të diellit gjeti erë e shi!" S'ke ç't'i bësh, kur nuk i ec të varfrit njeri!

Të shtunën ti më bëre një lajm-thirrje[1]. Isha me nerva, se u zura me një bilmes, po kur mendonja se do flisnja me ty e do dëgjonja zërin tënd, qetësohesha pakëz. Po edhe zërin tënd nuk e dëgjova, se, siç duket, llogaritjen e kohës ti e kishe bërë keq. Erdha pastaj në shtëpi. Këtu ishte qetë, vetëm herë pas here dëgjohej kolla e thatë e babait nga kuzhina. Piva duhan dhe vura Sonatën e 8-të të Bet'hovenit. Ajo të pëlqen edhe ty. Më shumë ndjehet, kur je vetë e kur ke në shpirt pak trishtim. Mos e merr për të keq! Nuk ankohem ndaj teje, që nuk dolle në telefon; për din e iman, nuk ankohem, veçse po ta tregoj si ngjarje pa të bërë ndonjë koment. Ti, padyshim, duhet të shkonje në Shëngjin. Unë dua që ti të prehesh e të jesh mirë. Mua më vjen shumë keq që ti nuk zbavitesh në këtë kohë të lirë, që nuk çlodhesh, ashtu si mund të çlodhet një intelektual normal (ti tani hyn në radhën e intelektualëve).

Unë e shoh që larg teje pushtohem nga një mërzi. Edhe kur lexoj libra, duke kaluar me sy nëpër radhët, më kujtohesh ti, më kujtohet ndonjë veprim apo ndonjë ngjarje që ka të bëjë

[1] *Lajm-thirrje*: Njoftim në formën e një telegrami që i dërgohej dikujt në atë kohë për ta lajmëruar të paraqitej për një bisedë telefonike në një orë të paracaktuar.

me ty dhe qëndroj për një copë herë ose të qesh me vehte ose të të sjell ndër mënd ty. E bëhem si miku im i dashur don Kishoti, që ëndërronte në ndonjë han të qetë për Dylqinjën e tij. (Mos të fyeva që të krahasova pa dashur me Dylqinjën e nderuar? Ajo ishte shumë e mirë, megjithëse miku im i dashur don Kishoti e kish idealizuar tepër). Tani, unë jam dhënë kaq shumë pas teje, sa po të ishe ti një çupë lozonjare (dhe dashka zoti që ti s'qënke), mund të më vërtitnje nga të donje dhe si të donje. Po unë e ndjej se ti e meriton këtë dashuri dhe jam shpirtërisht i qetë.

Do të thuash ti se çfarë bëj unë tani? Pasi lexova ca libra për bombat, po lexoj një vëllim të Lion Fojhtvangerit nga historia e Romës pas vdekjes së Neronit. Dikur e kam çfletuar shpejt e shpejt, po këtë herë po e shijoj. Nga ky shkrimtar unë mësoj më tepër se nga dhjetë shkrimtarë të tjerë të mëdhenj. Kam edhe mjaft telashe të tjera: shkruaj, citoj, botoj. Gjithnjë trurin e kam të kurdisur. Ndofta nga të tëra këto andralla truri nuk më çkurdiset as natën dhe kam një pagjumësi të bezdisur, që meriton mallkim. Siç duket nga pagjumësia ngrihem në mëngjes i hutuar. Nga ky hutimi im i përjetshëm dje u turpërova në rrugë. U përplasa me një grua që kish blerë një tas kos tek një privat që e kemi në mëhallë. U përplasa dhe, o Allah, gruas i ra kosi para këmbëve të mija. Tasi u thye dhe pantallonat e zeza të mija u bënë me pikla kosi të bardha. Një breshëri fjalësh të rrepta u derdhë mbi mua nga goja mitraloz e asaj gruaje. Xhexheja[1] nuk ishte që të m'i fshinte pantallonat dhe u mora vetë me këtë punë, që nuk është aq e këndëshme. Ja se ku të shpie pagjumësia! Të të kisha ty, Sadije, këtu, ndofta do të isha më normal dhe jeta ime patjetër do të ishte më e mirë. Pse vallë ti je bërë aq e afërt dhe e domosdoshme për

[1] *Xhexheja*: Formë e shkurtër e emrit Hatixhe, emrit të nënës së Dritëroit, siç thirrej në familje. Për "të bukurën Hatixhe" D. Agolli ka shkruar një poezi të njohur.

mua? Unë mendoj se po të mos ekzistojë një domosdoshmëri e tillë njeriu nuk duhet të martohet, se ai do të gënjejë vehten.

Për pak harrova të të thosha se do të vij të shtunën më 15 gusht, ora 8. Më prit.

Të puth,
Dritëro

[19.VIII.1964]

E dashur Sadije,

Nuk e di se ç'ka ndodhur me mua. Në moshën e Krishtit unë të bëhem kaq i papërmbajtur në çfaqjen e ndjenjave të mija? Mjafton të qëndroj pakëz në vetmi e të jepem i tëri pas teje. Kurse kur jam me shokët nuk e kam mëndjen në muhabetin e përgjithshëm. Më thonë se paskam ndryshuar kaq shumë sa s'njihem. Unë nuk kam qejf të ndryshoj natyrën time, prandaj ngushëlloj vehten, duke menduar se shokët, me që dijnë historinë time me ty, gabojnë në gjykimet e tyre. Po ç'është e vërteta unë ju jap të drejtë atyre se diçka ka ndodhur. Në mesditë të jetës dashuria qënka e çuditshme.

Dua që në këtë çast të jem me ty. Ti të rrish karshi meje, të flasësh, të qeshësh. E di ti se më pëlqen qeshja jote? Ti qesh fare-fare[1].

E sheh si është natyra e njeriut e dyfishtë? Unë në tregime e në vjersha jam shumë i përmbajtur, apo jo? Edhe në shkrimet e dashurisë bile jam i përmbajtur. Po kur nis të të shkruaj ty dhe e humb gjakftohtësinë. Adio, gjakftohtësi, armë e shkrimeve të mija! Pse vallë? Kjo siç duket është merita jote. Unë në përgjithësi kurrë nuk kam hapur sytë rrugëve pas fustaneve, po tani i kam mbyllur fare - kudo vetëm ty të shoh.

Letra është një shprehje e çastit. Sikur ne t'i shkruanim letrat e t'i mbanim pa i dërguar qoftë edhe një ditë, natyrisht po të ishim në gjëndje shpirtërore normale, të tretën ditë do t'i grisnim e do të thoshim me vehte: ç'marrëzi kemi shkruar! Të tri letrat që të kam nisur para kësaj kanë plot marrëzira, se shpirtërisht nuk kam qënë mirë. Po mos u mërzit, njeriu

[1] *Fare-fare*: Me gjithë shpirt, shumë; fjalë me përdorim të rrallë.

duhet të ketë edhe çaste marrëzie, se do të na mbyste atëherë monotonia. Duhet të zbavitemi me ndonjë letër me nuanca anormale. Njerëzit zakonisht në këto letrat e dashurisë kanë qejf të bëhen ose hamletë, të tregojnë sa vuajnë e sa janë të mërzitur nga bota, ose të bëhen si xhaxhallarë të urtë me shprehje plot mirësi e didaktikë, t'i mësojnë vajzat të mos bijen në gabime, t'u thonë atyre se ka njerëz që janë të liq e ku të di unë. Këta u shëmbëllejnë atyre njerëzve, të cilët kur flasin me femra i venë më shumë rëndësi intonacionit të zërit, gjesteve elegante, manierës së të qëndruarit dhe harrojnë të mjerët, natyrën e tyre. Fatkeqët! Me këtë, pa ditur edhe vetë, bëhen të mërzitëshëm.

Unë sot gjithnjë kam jetuar me ty. Shkonja në rrugë - isha me ty, shkonja në kafe - isha me ty, shkonja në bibliotekë të kërkonja ndonjë libër - isha me ty. Po ç'u bë kjo, thosha me vehte, ëngjëll mbrojtës? Dreq o punë. Është mirë kur të duan, apo jo? Po jo kur të duan "se na bashkojnë zakonet dhe afërsitë krahinore!"

Kur të duan krejt ndryshe, krejt pa përcaktuar, pa rregulla, atëherë mund të jesh e lumtur. Unë nuk kam qejf të më duan me rregulla, nuk dua të hyj nëpër unazë si akrobat. Bile unë kam qejf kështu: nuk e ndjen vehten mirë me mua një ditë, thua: më mërzite, Dritëro, sot nuk të dua, nesër mund të të dua, m'u çduk tani nga sytë! Çaste të tilla ka, apo jo? Po njeriu është edhe rrufjan-hipokrit, që ka frikë të hapet e të shprehë gjithnjë të vërtetën. Megjithëse ti kështu nuk më ke thënë asnjëherë, po unë ka patur raste, që çaste të tilla, të shkurtra fatmirësisht, i kam nuhatur. E di që këto janë në natyrën e njeriut, prandaj as jam mërzitur fare. Po mos nuhatnja të tilla çaste, unë nuk do të të desha dhe nuk do martohesha me ty. I marrë, do thuash, po është e vërtetë.

Tani të të them pse nuk të kam marrë në telefon. E di ti se unë nuk kam qef të flas në telefon, se më mbarohen fjalët? S'di ç'të them. Që të flas, unë dua ta shoh njerinë, ose ta përfytyroj.

Në telefon as e shoh, as e përfytyroj. Nuk e kuptoj se si më ka lindur kjo mani e pse më mbyllet goja në telefon. Duhet të jetë ndonjë sëmundje! Prandaj mos ma merr për të keq që nuk të kam telefonuar.

Në Durrës nuk kam shkuar për të pyetur atë shokun tim, se ç'bëri me syzet që kam porositur për ty. E kam marrë ca herë në telefon, po ka qënë me leje dhe nuk më ka dalë.

Kam filluar të bëj një jetë më normale, më realiste. Për librin tim me tregime kam pyetur në ndërmarrje të botimeve e më kanë thënë se së shpejti duhet të dalë në qarkullim. Më nxori mjaft telashe ky libër. Sipas numrit ky është libri i katërt që botoj, po më i vështiri dhe më i ngatërruari. Ky i pesti me vjersha që po pregatit s'besoj të ketë fatin e tregimeve. Në vjersha jam në terrenin tim dhe di të orientohem, megjithëse një zvarranik më tha se shumë vjersha duhet t'i heq.

Lexova një libër nga Dostojevski dhe më ka lënë pa gjumë me tipat dhe figurat e tij të tmerrshme. Një burrë tërë natën mendon para qivurit të gruas së tij, që ka vrarë vehten. Cilat kanë qënë arsyet që gruaja e tij vrau vehten? Rreth kësaj shkruhet tregimi. Ka një moment të hatashëm. Burrin e ka ftuar një njeri në duel (përpara se ky të martohej). Ai refuzon, nuk pranon të bëjë duel. Të gjithë e quajnë frikacak. Pas shumë situatash gruaja e çdashuron atë. Ai është shtrirë e fle. Ajo merr revolen dhe ia vë në tëmbth tytën e hekurt. Ai hap sytë, e shikon me gjakftohtësi tytën dhe i mbyll prapë. Gruaja tronditet. Për herë të parë kupton se ky nuk është frikacak. Po si është e mundur që refuzoi duelin? "Të refuzosh duelin - tha ai - kërkon më shumë burrëri!"

Me të vërtetë është tregim i fortë. Gjynah që ti nuk e lexon dot.

E kështu, moj e dashur, mjaft griva, po e mbyll letrën.

Të puth,
Dritëro

[11.IX.1964]

E dashur Sadije,

Donja të të shkruanja që mbrëmë, po e lashë për sot në mëngjes. Mëngjesi është kohë optimizmi. Pak njerëz ka që janë pesimistë mëngjeseve. Le të besojmë se kjo është edhe koha më e bukur për të shkruar letra dashurie. Letrën nuk ia shkruajmë njeriut për ta mërzitur, po për t'ia ngritur humorin e për ta bërë atë më jetëdashës. Ti mua, edhe kur ke qenë e zemëruar, më ke shkruar letra të mira, të ngrohta e plot dashuri. E duke bredhur me sy nëpër radhët e shkrimit tënd të afërt për mua, unë kam ndjerë se ti më do me tërë mënt. Unë i dua njerëzit që e thonë fjalën me zë të lartë e me plot gojën. Për herë të parë kam rilexuar kaq shumë një letrën tënde. E kam fjalën për letrën e fundit. Ajo më ka bërë të mendohem. Megjithëse në dukje ishte letër normale, atë e përshkonte një notë pak e ftohtë. Nuk dua të them që letrat artificialisht të dalin të ngrohta; ato duhet të shkruhen siç ndjehen. As kam kërkuar dhe as kërkoj që mezor nëpër dhëmbë të më betohen për dashurinë në çdo letër e frazë. Kurrë nuk kam qenë i përkëdhelur nga dashuriçkat dhe nuk kam dashur kurrë të përkëdhelem. Unë nuk jam si ca që fejohen e martohen vetëm për të fjetur me gruan, pasi ajo të ketë bërë punët e kuzhinës. Për të patur një grua në krevat e për të ngrënë nga duart e saj një tas fasule apo çorbë, unë s'kam patur dhe s'kam kurrë nevojë.

Nejse, për ftohtësinë e letrës nuk të qortoj dhe s'dua me qortime t'u shëmbëllej meskinëve. Ti shkruaj si të duash dhe mendo si të duash për mua. Nuk dua vetëm që letrat të shkruhen sa për të kaluar radhën me sy gjysmë të mbyllur nga gjumi e me kokë të rënduar, as kur ke uri dhe e ke mëndjen atje. Natyrisht në këtë gjëndje nuk mund të dish si të përgjigjesh në ndonjë pyetje, e jo pyetje të dorës së dytë, po pyetjes kryesore të jetës.


Jeta ime këtej është e zakonëshme. Është po ajo zyrë, po ai klub, po ajo shtëpi. Në dhomën time të mërzitëshme janë po ato lule dhe peshq që ma kanë sjellë në majë të hundës. Do t'i nxjerr të gjitha jashtë - edhe lulet, edhe peshqit, edhe qilimin; do të mbaj vetëm librat dhe krevatin tim. Tani për tani nuk merrem me ndonjë punë të lodhëshme. Lexoj shumë dhe shkruaj pak. Megjithëse kam mjaft shokë dhe nga natyra jam optimist, e ndjej vehten çuditërisht të vetëmuar dhe me humor të keq. Dje kam pirë shumë konjak që në mëngjes dhe jam bërë tapë. U zura me njerëzit e shtëpisë dhe më thumboi një grerë në qafë. Aq më dhëmbi sa për pak më dolli pija. Tani që nuk të kam ty pranë nuk i vë rëndësi asgjëje: rri i parruar, i pahekurosur dhe me duar në xhepa. Kostumi s'ka ç'më duhet, e kam inat dhe nuk do ta qep.

Siç duket po fillon vjeshta. Në Tiranë është mirë nëpër kopshte. Të djelën mendoj të nisem vetëm në këmbë në mal të Dajtit, do fle në ndonjë fshat e do kthehem në mëngjes në Tiranë. Shtëpia më është mërzitur. Po të isha me lejë do të shkonja në ndonjë pyll në ndonjë kasolle rojtari. Sa keq që nuk mora sivjet lejë krijonjëse! Jam bërë pak qesharak apo jo? Ti patjetër duhet të jesh e zëmëruar me mua për ndonjë arsye. Edhe pse po i shkruaj këto radhë në mëngjes, kur njeriu është plot humor, letra ime më duket se ka dalë e rëndë. E kam grisur disa herë, po këtë radhë do të ta dërgoj. E prapë se prapë kjo nuk ka të bëjë me kryesoren: ty unë vazhdoj të të dua më shumë e më thellë. Bile nga që të dua shumë kam filluar të bëhem xheloz.

Të uroj ditëlindjen dhe të puth fort si më parë, edhe më fort akoma.

Të shtunën më datën 19 shtator më prit. Nuk më durohet pa të parë.

Yti, i mërzitshmi, plangprishësi
Dritëro



E dashur Eadije,
Të dërgove një letër. Letra është e marrë dhe mos e lexo. E shkruajta i mërzitur me një farë mëkatimi. Mua më vjen keq të të mërzit ty, po ndofta se të dua shumë shkruaj ndonjëherë marrëzira. Më rot jam shumë i mërzitur dhe kurrë kaq fort mik e kam patur nevojën tënde. Mos pyesja natën mesën Aa dinja se të vinja më këmbë për atje e do vinja.
Edhe një herë të lutem mos e merr mëgjithëmend mënt atë letër. Po përfundoj se po më këputet më redaksi.
Të puth shumë herë
e fort
Orteza
11.8.64

[11.IX.1964]

E dashur Sadije,

Të dërgova sot një letër. Letra është e marrë dhe mos e lexo. E shkrojta i mërzitur me një farë keqkuptimi. Mua më vjen keq të të mërzit ty, po ndofta se të dua shumë shkruaj ndonjëherë marrëzira. Unë sot jam shumë i mërzitur dhe kurrë kaq fort nuk e kam patur nevojën tënde. Mos punonja natën nesër, ta dinja se të vinja më këmbë gjer atje e do vinja.

Edhe njëherë të lutem mos e merr me gjithë mënt atë letër. Po përfundoj se po më kërkojnë në redaksi.

Të puth shumë herë e fort,
Dritëro

[24.IX.1964]

E dashur Sadije,

Sot nisem në Rrëshen me urgjencë. Dje më telefonoi Ramizi për të gjetur ca valutë[1], por nuk munda dot të kërkoj, sepse më duhej me doemos të nisesha. Kur të kthehem përsëri në Tiranë me doemos do të gjej aq sa ti kërkon, veçse kam frikë se mos i deshe shumë shpejt. Mendoj të shkëputem ndonjë ditë nga Rrësheni për të ardhur tek ti. Po të vij shpejt do të dukem drejt nga shkolla jote. Bën ftohtë dhe andej nga ato male të Mirditës do të ngrij, veçse në më ngrohtë fryma jote, po edhe ti do të jesh larg.

Mos u çudit që po të shkruaj me makinë. Nuk e kam penën me vehte dhe përtoj të ngjit shkallët ta marr.

Si je me shëndet, me gjëndje shpirtërore, me punë?

Hë për hë mirupafshim! Shpejtoj. Po më ik autobusi.

Të dua e të puth si gjithnjë.

Yti,
Dritëro

[1] *Valutë*: Në periudhën e triskëtimit quhej "lek valutë" një prerje e monedhës kombëtare që mundësonte blerje në dyqane të veçanta. Kjo monedhë kishte për qëllim tërheqjen e parasë prej tregtarëve. Nuk gjendej në qarkullim të lirë.

[5.X.1964]

E dashur Sadije,

Kur kthehem nga ndonjë udhëtim e kam shumë vështirë të ulem e të shkruaj përshtypjet e mija për gazetën, sepse andej nga kam qënë jam mësuar të vrej, të mbaj shënime, por jo të mendoj për t'i kthyer këto vrejtje e shënime në artikuj apo reportazhe. Nuk e merr me mënt sa përtoj të merrem me udhëtimin tim nëpër Mirditë. U mundova sot të shkruanja diçka, po s'dolli gjë. Të shohim nesër. Për ne që shkruajmë në gazeta e revista njerëzit mendojnë që kemi punën më të lehtë.

Kam dëshirë që ti të vish nesër pa pritur e kujtuar. Eh ç'do të vejë sikur të ngjasë një mrekulli e tillë! Patjetër tani që shkruaj unë këto radhë ti duhet të kesh bërë gjumin e parë se është vonë. Unë ndonjë herë jam si lugati, atje i qoftë të paudhit! Rrij vonë, zgjohem, braktis shtratin, lexoj ose mendoj kot.

Këto ditë i kam shkuar të zbehta, bile fare të murme. Kam dëgjuar shumë thashetheme e shpifje të liga (këto nuk kanë lidhje me ty), jam zënë e gati sa s'jam rrahur. Po tani jam i qetë dhe pres mëngjesin. Poemën që e lexove ti - po shumë të përmirësuar - më duket se do ta botoj në "Ylli"[1], pasi asaj redaksie ia kam premtuar.

Për ty mendoj gjithnjë, ngaherë të dua e të puth.

Dritëro

[1] *"Ylli"*: Revistë e përmuajshme politio-shoqërore dhe letraro-artistike që doli deri në vitet 1990. Në këtë revistë është botuar poema "Baladë për komisarin" e autorit dhe për të bëhet fjalë në letër.

[13.X.1964]

E dashur Sadije,

Edhe 33 vjetët e mija mbetën prapa. Dje nuk mendonja fare për ditëlindjen, bile e kisha harruar. Në mëngjes, sot, u kujtova. "More, po unë mbush 33 vjet"? - thashë me vehte. Nga s'jam hedhur në këta 33 vjet! Të rrish të mendohesh të zjen koka. Dhe kur po ikte i 33-ti vit, ose më mirë që kur kish hyrë, unë të njoha ty. Kjo ndofta ka qënë gjëja më e mirë në këta 33 vjet.

E ndjej vehten mirë. Ti më dërgove telegram, më more në telefon, të dëgjova të flasësh. Të hënën ne të dy nuk u ndamë aq mirë. Tërë rrugës kam qënë i dëshpëruar dhe asgjë nuk mund të më zbaviste. Në Milot nga hutimi e humba ombrellën. Nuk ka gjë, shkoi edhe ajo të kërkojë të tjerat.

Mua më duket se ti ke nevojë që unë të jem pranë teje. Ti nevrikosesh, nxehesh dhe duhet patjetër të kesh afër një njeri që të të përkëdhelë e të të qetësojë. Edhe unë bëhem ndonjëherë i padurueshëm, po jo se dua. Edhe ti bën ca pyetje fishekësh[1] në letër: "Mos t'u mërzita?" Unë vetë të kam zgjedhur ty të atillë që mos më mërzitesh kurrë.

Në dasëm nuk do të shkonja atë ditë, po ti po iknje shpejt dhe unë e shihnja se po më vërtitej një mërzi më e madhe se kalaja juaj[2]. Sikur mos kisha shkuar do të ishte më keq se do të zinja ndonjë qoshe e do të rrinja vetëm. E di që qyteti juaj ka shumë fjalë, por mua nuk më bëjnë përshtypje. Dasmat prandaj bëhen, që njerëzit të mos jenë si në ditët e zakonëshme. Më shumë më pëlqeu një shofer dhe i vëllai i Verës. Atje u

[1] *Bën pyetje fishekësh*: Bën pyetje të papjekura, pyetje pa kuptim.
[2] *Kalaja juaj*: Rozafa, kalaja e Shkodrës.

grinda me njërin se për t'u tallur e mori këngën "Te rrapi në Mashkullorë". Kur tha ai:

Foli Çerçizi me gojë
Leri djemtë e mij të shkojnë
Se ju kuq ju bëj me bojë,

unë i thashë, duke e përmbajtur inatin: "Çerçizi ka skuqur në ballë edhe bimbashë, kurse ti nuk din të skuqësh as …", e këtu thashë një fjalë që nuk ishte shumë e këndshme.

Librin me vjersha u mërzita duke e daktilografuar vetë dhe prandaj ia dhashë një daktilografisteje.

Ti më thoshe në telegram se Elena[1] lindi djalë. Unë i telefonova në shtëpi. Më thanë se ishte në punë. I telefonoj në punë. "Si moj, ç'bën atje? Ku e ke djalin"? Ajo u çudit.

Nga e more vesh ti se ka lindur?

Për paret mos kij merak se kam vënë agjentë të fortë për të kërkuar.

Ka mundësi që pak më vonë të vij andej afër me ndonjë shërbim dhe të dukem papritur e kujtuar nga ti. Po ky është hë për hë një projekt.

Si je tani? U qetësove? Kot sa bëhesh merak.

Të puth shumë,
Dritëro

[1] *Elena*: Është fjala për Elena Havalen, një nga shoqet e Sadijes.

[15.X.1964]

E dashur Sadije,

Që kur jam kthyer nga Shkodra nuk kam marrë asnjë letër nga ti. Kjo nuk është ndonjë kohë e gjatë, po kam dëshirë që gjithnjë të jesh pranë, të të dëgjoj, të të shoh. Për mua ti merr vesh se si jam e ç'bëj, pasi e shikon emrin tim në shtyp ngaherë e thua: Ja, jetuaka ky.

Megjithëse ti më the në telefon që të mos dukem në Shkodër një muaj të tërë, mua sikur s'më durohet kaq shumë pa ardhur.

Sonte isha në klub të shkrimtarëve dhe kur po iknja erdhi Elena me Ismailin[1]. Ajo më tha se kish marrë një letër prej teje. Erdha në shtëpi e thashë të të shkruanja nja dy fjalë. Këto nja tri-katër ditë kam qënë me një gjëndje shpirtërore të keqe. Bile dje më ishte mërzitur edhe vehtja. Të të kisha ty afër, si atëherë kur ishe studente, do të vinja të të takonja e ndofta do të lehtësohesha. Nuk e di si do të bëj gjer të vij në Shkodër tek ti.

Jam fare vetëm. Edhe *plaku*[2] edhe Xhexheja[3] kanë shkuar nga vëllai. Më duket se plaku do të shtrohet ca ditë në spital. Ai gjithnjë ankohet: më dhëmb këtu, më dhëmb atje. Plak njeri, i gjori. Ka qënë i fortë në rini, por ra përnjëherë. E gjora Xhexhe, e kaloi shumë keq rininë. Kurrë nuk pa asnjë përkëdhelje.

Po ti Sadije si je? A të dëshpërojnë nxënësit? Mua më vjen shumë keq kur ty të dëshpërojnë. Unë shpesh shaj vehten, kur të bëj ty me nerva pa dashur. Këtë radhë në Shkodër të kam

[1] Elena Kadare dhe Ismail Kadare.

[2] *Plaku*: *Formë familjare të thëni për babain e Dritëroit, Riza Agolli*.

[3] *Xhexheja*: Si në shënimin në faqen 33.

dëshpëruar. Edhe me ato paret të kam dëshpëruar! Jo se ato në vetëvehte kanë ndonjë rëndësi të madhe, po se kanë të bëjnë me kujdesin tim për ty. E di që duhet të jem më i kujdesshëm. Po unë kam bërë gjithnjë një jetë bohemi e nuk i kam vënë rëndësi kujdesit dhe etiketës.

Po afrojnë edhe festat. Ne duhet patjetër t'i festojmë bashkë, apo jo? Në klubin tonë pasnesër më duket se ka një mbrëmje. Më thanë Ismaili dhe Elena të vinja me ta. S'besoj të shkoj, se kam frikë mos pij. Dreq o punë, përsëri po e zë në gojë këtë fjalë!

Kam shumë dëshirë të të shoh.

Të puth fort,
Dritëro

[16.X.1964]

E dashur Sadije,

Po të dërgoj me Jani Toçkën 2.500 lekë valutë. 500 pas trikatër ditësh. Më fal që i vonova, po nuk kam eksperiencë në punë të tilla, se nuk jam marrë kurrë me to. Tani sa po e mora letrën tënde të rreptë. Ke ca të drejtë, po ndofta e ekzagjerojnë pijen time. Dasmat nuk quhen dasma, po nuk u pinë njerëzit. Ky ka qënë zakon që në lashtësi. S'kam përse të të gënjej. Unë nuk e kam sëmundje të pirën. Mund të rri pa pirë edhe një pesëvjeçar! Po ta kisha sëmundje pijen, unë nuk do të isha i zoti të bënja asgjë. Ti e sheh se unë ditë për ditë botoj. Pse, mos kujton ti se unë i pirë i shkruaj ato? Siç duket tek ty po bëjnë përshtypje llafet në adresën time. Unë nuk jam hoxhë, që mos vë në gojë raki. Ata shkodranët e tu në dasëm u dehën me ujë. Unë nuk shkova si ata njëqind herë në nevojtore! E kam zakon që në dasma të jem gazmor e mos rri, për etiketë, me buzë të varura sikur të më ketë ngrënë macja gjizën. Ne nuk e kemi zakon që pas dasme të trillohen thashetheme. Ato që ndodhin në dasmë, mbeten në dasmë. Dasma s'pranon thashetheme. Njerëzit në dasma mund të rrihen, po prapë kjo nuk quhet marrëzi. Qënkan veshgjatë nga më veshgjatët ata që e kanë bërë të madhe pijen time. Unë në dasëm më shumë shkova nga mërzia. Ti më le vetëm mua që më 8.30 apo 9. Ku të vinja unë? Unë nuk vij në Shkodër se më ka marrë malli për ndonjë surrat, apo për xhamitë mizerabël, po për ty. Ti ike që kur ikin pulat në kotec, ç'të bënja?

Më fal që po nxehem, po nxehem se nuk jam indiferent. Unë ty të dua, e kjo nuk varet nga dashja apo mosdashja jote. Në Shkodër do të vij kur të dua dhe nuk më mban as muri i

llafeve, as i ndonjë gjëje tjetër. Për deri sa unë ty të dua asgjë s'ka fuqi që të më mbajë. Ti mendon se bëjnë efekt tek unë fjalët? Gjepura! Se mos jam unë ndonjë mashkull-nuse me pudër!

Të puth shumë,
Dritëro

[17.X.1964]

E dashur Sadije,

E kështu, tani do të pajtohemi, se tërë këtë javë jemi grindur. Edhe unë nuk jam sjellë mirë. Për atë që më thua ti në letrën tënde të rreptë se gjoja unë gabohem po të mendoj që nuk ka njerëz të mirë nga punëtorët, është një paralajmërim krejt i kotë. Unë kurrë nuk mund të mendoj një gjë të tillë, po gjithëmonë pikërisht punëtorët më janë dukur më të mirë edhe nga vehtja ime. E në përgjithësi unë për njerëzit kam mendim të mirë. Unë kur u njoha me ty nuk të thashë që më merr mua, se jam më i miri dhe të tjerë s'ka të mirë. Kjo duhet të të bënte ty jo të më duanje, po të më neveritnje. Pastaj në dashuri nuk ka kontratë: në qoftë se unë t'u bëra i mërzitshëm dhe i lik, ti mund të më thuash lamtumirë. Sikur të mendonja se tani Sadija iku nga unë e mbaroi puna e saj, s'ka njerëz të tjerë të mirë, do të isha jo vetëm budalla, por edhe qen bir qeni.

Tërë këtë javë nuk e kam ndjerë vehten mirë. Këtë letër po ta shkruaj në fund të javës, të shtunën. Kam qënë edhe i lodhur, edhe shpirtërisht i sëmurë. Letra jote më ka bërë shumë përshtypje. Unë e di që ti më do edhe se shkruan kështu, bile këtë e bën nga dashuria, po mua më çqetëson diçka tjetër. Ndonjë sjellja ime mjaft e lirë dhe e çkujdesur bën shumë përshtypje tek njerëzit që më njohin. Atëherë sjellje të tilla të mijat ekzagjerohen, kalojnë nga goja në gojë e vijnë deri në veshët e tu. Ti mërzitesh nga këto thashetheme, vuan shpirtërisht, mundohesh me vetëvehten. Prandaj këtej e tutje unë në Shkodër do të mundohem të sillem krejt si zyrtar; edhe në kafene kur të jem, do të pij limonadë, kafe dhe do ha një karamelkëzë.

Këtë të shtunë më ka marrë malli më tepër se çdo herë tjetër. Mirë thonë që grindjet rastis që ta shtojnë më shumë dashurinë.

Librin e daktilografova. Të hënën e jap në ndërmarrje të botimit. Sonte do t'i gjej një titull. Kam ca tituj në kokë, po nuk më pëlqejnë.

Ç'të bëj tani? S'më mbetet gjë tjetër veçse të të puth me mall e dashuri kësaj të shtune të ftohtë.

Dritëro

Një letre që të dërgova me Janin mos i ver shumë rëndësi, se isha i nxehur.

[19.X.1964]

E dashur Sadije,

Sa zemër të butë ke ti! Sikur të ishin të gjitha gratë kështu si ti! Nxehesh e pastaj prap të shkon. E unë fisheku të dëshpëroj me marrëzitë e mija! Me të vërtetë meritoj një grusht në fizionomi. Të kam çqetësuar ty, që të dua aq shumë e që mendoj aq shumë!

E si je tani? A mërzitesh? Unë të kam shkruar shumë letra, aq sa e kam harruar shifrën. Sot mora letrën tënde të dytë, atë letrën e shkurtër, po të përzëmërt e të mirë. Ti gjithnjë mua me përzemërsi më flet. Në këtë çast që shkruaj këto radhë jam i dhënë fare pas teje, jam plot me dashuri e adhurim për ty. Më duket sikur gjithçka në botë për mua je ti. Nuk janë fjalë të thëna në erë këto, duhet ta dish. Ç'të bëj unë për ty?

E më në fund në jetë unë gjeta një njeri kaq të mirë, kaq të mrekullueshëm! Edhe këto nuk janë fjalë të thëna në erë, duhet ta dish.

Të puth, njëqind herë të puth,
Yti, Dritëro

P.S. *Sadije, ti ke bërë një gabim, letrën që do t'ia dërgonje Lenit, ma ke dërguar mua. Unë kujtova se ishte për Lenën e Ismailit, po është për atë të mjekësisë. Nuk ia di mbiemrin se do t'ia dërgonja unë. Dërgo adresën e saj që t'ia postoj. Në qoftë se vij të shtunën ta sjell letrën t'ia dërgosh vetë. Unë nuk e kisha lexuar e u nisa t'ia shpinja Lenës së Ismailit, por më shkuan sytë në një "Lenkë" e thashë me vehte: nuk do të jetë Elena kjo.*

Të puth, Dritëro

[20.X.1964]

E dashur Sadije,

Më ka marrë malli të të shoh. Po të shkruaj ca fjalë.

Sot mbarova një punë të mirë: e dhashë librin me vjersha[1] në ndërmarrje të botimeve. U mendova të gjenja një titull tërheqës, po e pata vështirë ta gjenja, megjithëse unë nuk prirem shumë pas titujve. Pra, titullin ia vura "Trotuare dhe shtigje malesh". S'dihet, gjer të hyjë në shtyp, mund edhe t'ia ndërroj.

Kjo lagështia në Tiranë nuk më pëlqen fare. Më mirë të bjerë shi i fortë e të fryjë erë, se sa tërë ditën të jetë lagështirë e rëndë, e keqe.

Tani jam bërë si ata filozofët e antikitetit, fatalist e skeptik. Udhëtoj me makinë e them: s'dihet, mund të rrëzohet makina. Shkoj rrëzë strehëve të shtëpive të larta e them: s'dihet, mund të më bjerë ndonjë vazo e të ma bëjë përshesh kafkën, që prodhon vargje e artikuj! Hë hë, për të qeshur!

Ç'kemi ndonjë gjë andej nga ti? Mërzitesh? Lodhesh? Mos je e sëmurë? Tani bien shira e është ftohtë. Ruaju nga ndonjë grip i pabesë. Unë vazhdimisht e kam mendjen tek ti; sidomos sot, që është ftohtë, them: mos më sëmuret zoçka!

E bleve pardesynë? Mua më mbetën edhe 500 lekë pa t'i dërguar. Njëqind i kam në xhep, 400 më ka premtuar njëri nesër. Është shumë vështirë për t'i gjetur. Vetëm mos kij merak, moj zoçkë, se do të rregullohet çdo gjë. Ti do thuash: sa optimist është ky!

S'kam ç'bëj, do të të puth fort e do ta mbyll letrën.

Dritëro

[1] *"Shtigje malesh dhe trotuare"*, libër me vjersha e poema i autorit, botuar më 1965 nga shtëpia botuese "Naim Frashëri".

[22.X.1964]

E dashur Sadije,

Ti tani je lëshuar me tërë forcën tënde për të mos më lënë të pij. E shoh edhe unë që kjo të mundon. Kërkon edhe në letër që të të them si qëndron puna, të të them me fjalë të "thjeshta, po të sinqerta", siç shprehesh ti. S'e mohoj, kam pirë, bile kam pirë shumë. Po ti asgjë nuk di sa kam pirë më parë. Këtë kohë që jam me ty, nga marsi e këtej, unë nuk kam pirë as një të pesëmbëdhjetën e kohës së dikurshme. Sikur të isha alkoolizuar doemos do të vazhdonja në progres gjeometrik të pinja. Ndodhi e kundërta. Unë s'pij. Në raste të rralla kam pirë. Nuk kam kohë. Unë punoj. Si mund të vihem pas pijes? Sikur të ishe ti gjithnjë me mua, unë bile edhe një gotë konjaku nuk do ta pinja.

Po të dolli nami, një gotë të pish, dhjetë t'i bëjnë. Nuk kam asnjë shkak që të dehem. Kur nuk më shkojnë mirë punët në krijimtari, ma ka qejfi të hedh një gotë. Tjetër shkak unë, të betohem, nuk kam. Të kisha shkak tjetër unë nuk do të lidhesha me ty kaq ngushtë. Nuk është e vërtetë që gjithnjë kur më ke takuar ti kam patur hedhë ndonjë gotë. As fjalë të bukura unë ty s'të kam thënë. Kohët e fundit, kur kish mbaruar çdo gjë e ne ishim fejuar, të kam thënë fjalë të bukura; që duhet të ndodhte e kundërta: më parë të të thosha të tilla fjalë. Edhe këto fjalë të bukura si t'i kuptosh: ato janë të sinqerta, pa janë të bukura. S'të gënjej, pijen ka kohë që e kam lënë. Janë raste të rralla ato kur pij shumë. Edhe këto raste të siguroj se do të çduken. Unë s'jam nuse, një gotë, patjetër, do të ndodhë që do të pi. Ama konditë më ke vënë: o gotën, o ty! Ç'të them unë? Të përdor parullën e kubanezëve[1]? Gota jo, Sadija po?

[1] *Parrullë e kubanezëve*: Është fjala për sloganet e Kubës: "Atdheu ose Vdekje! Socializimi ose Vdekje!".

Mos u çqetëso fare për këto gjepura. Unë, ti e di, që kam aq vullnet sa një ves ta çduk. Ky nuk është as ves. Edhe të ketë qenë ves, është çdukur; ka mbetur ndofta jehona e tij. Kaq për këtë të bekuar pije.

Tek ajo Elena mua më vjen ca zor të shkoj, po do të vete megjithatë, do t'ia shpije edhe unazën.

Për atë që thua ti, se unë shpenzoj duke pirë, prandaj nuk blej pardesy, nuk është edhe aq e vërtetë. Do marr honorare dhe gjithçka do të rregullohet. Për të ardhmen tënde mos kij frikë dhe mos u bëj fisheke. Ajo duhet të jetë e mirë, bile më e mirë se ç'mendon. Po ti bën mirë që m'i thua dyshimet.

Unë në Shkodër vetëm një herë (ditën e asaj dasmës) kam pirë (që mund të quhet e pirë). Herë tjetër, sa njihem me ty, nuk kam pirë kurrë. Prandaj ç'faj kam unë kur ekzagjerohen gjërat? Të pish një gotë, nuk do të thotë të pihesh. Ama ç'fishekë!

Në djall të venë të gjitha. Mërzitem pa ty, e sidomos tani. Sa kalon koha aq më shumë mërzitem. Ç'budallallëk kam bërë që s'të mbajta këtu!

Mos u dobëso, mos u nevrikos e mos u mërzit. Të gjitha llafet dëgjoji, po mos i beso të gjitha. Kupton? Po t'u besonim të gjitha llafeve duhet të çmëndeshim, për din për iman duhet të çmëndeshim.

Të puth shumë e të dua shumë.
Dritëro

Më vjen keq që qënkan mbaruar pardesytë. Këtu jam edhe unë fajtor, dreqi ta marrë!

[22.X.1964]

E dashur Sadije,

Jam shumë i gëzuar që ty të gjithë të duan në shtëpi. Ti ke shumë nevojë për përzemërsi. Nuk kam takuar njeri deri më sot që të ketë kaq nevojë për përzemërsi e ngrohtësi sa ti. Këtë unë ka kohë që e kam kuptuar. Po megjithatë unë shpesh nuk jam sjellë në dukje aq mirë me ty, ndërsa në shpirt ndryshe: gjithnjë kam qënë i sinqertë e i dashur.

Edhe sot mora një letër nga ti. Sido që të shkruash unë i dua letrat e tua. E ndjej që ka ngjarë një kthesë e madhe tek unë, që kur nisa të të dua. Po unë ty të dua jo se ke ti nevojë për dashuri e përzemërsi - kjo do të ishte e keqe. Unë të dua se kështu janë kërkesat e mija shpirtërore. Aq më mirë që kjo përputhet me kërkesat e tua.

Ka edhe dhjetë ditë që tetori të ikë e të vijë nëntori. Nuk e di se si do t'i kaloj ato ditët e festave pa ty. Do të mendoj ndonjë gjë: do të vij në Shkodër. Besoj të marr ca honorare edhe nga poema[1], edhe nga libri që dërgova në ndërmarrje të botimit[2].

Ti Sadije mos pi shumë duhan, se nuk të bën mirë; e humb edhe freskinë. Ti je tepër delikate dhe e ndjeshme, mos kërko me pahir ta prishësh këtë freski me nikotinë. Nejse, bëj si të duash, se po të mësoj si ndonjë teze.

Mirë e ka motra jote. Është gjë e madhe kur të kesh një motër pranë tërë jetën. Asaj do t'i gjejmë një burrë "kaur". Ç'barbare janë këto ndarje! Vetëm për këtë ndarje meriton të rrihesh qoftë edhe me farefisin! Ajo letra që kish përmbajtje të ndryshme me këtë që mora, megjithëse i ke postuar në një

[1] *"Baladë e re për komisarin"*, poemë e autorit.

[2] *"Shtigje malesh dhe trotuare"*, vëllim me vjersha e poema i D. Agollit.

ditë, mua nuk më ka ardhur. Mos e ke postuar në zarfin e Lenit dhe të sajën ma ke dërguar mua?

Ç'budallaqe bëhesh ndonjëherë ti Sadije! Mendon se unë pij "për të harruar ndonjë kapitull tjetër të jetës sime!" Për këtë asnjë dyshim s'duhet të kesh. Në botë ka vetëm një njeri që unë dua - Sadija.

Tani duhet ta mbyll letrën.

Të puth shumë,
Dritëro

[25.X.1964]

E dashur Sadije,

Nisem për në Vlorë, natyrisht jo në çmendinë[1], po në detyrë. Me një mikun tim po të dërgoj 500 lekët valutë që më kishin mbetur pa i kthyer. Siç e sheh planin e realizova 100 %, veçse me pak vonesë; ta merr mëndja që duhej plotësuar para afatit, po s'kisha ç'të bënja. Letrën tënde, ku thua se e bleve pardesynë, e mora. Do ta shohëm si të rri ajo pardesy. Ta mbash me shëndet. Mua më ka marrë malli për ty dhe hiç fare nuk jam i zëmëruar. Të dua më shumë se ngaherë. Pallton e shpura ta qep. Do të dalë e mirë. Edhe pardesy mund të ble më vonë.

Letra ti dërgo, s'ka gjë se jam në Vlorë. Pak ditë do të rri atje. Do të të dërgoj ndonjë letër nga andej. Besoj me shëndet je mirë. Mos u mërzit dhe mos u lodh.

Të puth shumë,
Dritëro

[1] *Jo në çmendinë*: Fjalë me humor e autoironi. Në Vlorë ndodhej spitali psikiatrik, themeluar në vitin 1921. Në kohën kur u shkrua letra quhej "Çmendina e Vlorës."

[30.X.1964]

E dashur Sadije,

Besoj se një letër që të dërgova nga Vlora duhet ta kesh marrë. Nuk ndenja shumë në Vlorë. Po atë kohë të pakët që qëndrova takova plot të njohur. Kam qenë me ta çdo mbrëmje. E takova Minush Jeron[1]. Ai jep letërsi në një shkollë 11-vjeçare dhe m'u ankua se bën një jetë monotone. E kujton me mallëngjim Tiranën, i ziu. Drejtor i tij është një Pirro Andoni[2], edhe ky një bashkëstudenti juaj. Natyrisht Minushi nuk pyeti për ty; të gjithë shokët e shoqet e tua më pyesin se si ti u rregullove në punë e të tjera e të tjera.

Në Shkodër, siç duket, nuk do të vij dot as të shtunën më 7 nëntor, jo se nuk dua të vij, po se kam ca punëra dhe halle të tjera. Mos kujto se nuk kam mall për ty, prandaj nuk vij. Kam shumë mall.

Më kanë ngatërruar edhe në zhurinë[3] e konkursit për novelën, kështu që duhet të lexoj disa qindra faqe. Them të lexoj tërë të shtunën dhe të djelën, se të hënën do të mblidhemi për të dhënë gjykime.

Kur erdha në shtëpi nga Vlora, Tajari[4] më tha se më ishte kthyer një letër, se, si i hutuar që jam, kisha harruar të shënonja qytetin ku drejtohej letra (Shkodrën). Ai e kish futur në një zarf tjetër dhe ta kish nisur. Qyfyre, ë?

Në shtëpi tani pi duhan me llullë, se m'u mërzitën cigaret. Po në xhep nuk e marr se është i madh dhe duket si kobure.

Disa herë kam menduar t'u jap fund kafeneve e klubeve dhe nuk e kam realizuar. Këtë radhë vendosa plotësisht. Do rrij në shtëpi të punoj, do t'i vihem të mësoj frëngjishten e të shpëtoj nga thashethemet e fjalët e kota që të bëjnë me

[1] *Minush Jero*: Dramaturg, autor i veprës "Njollat e murrme", dramë e kritikuar dhe e ndaluar për liberalizëm. Autori i saj u dënuar me burgim.

[2] *Pirro Andoni*: Në vitet e mëvonshme diplomat i njohur, ambasador në Argjentinë.

[3] *Zhuri*: Trajtë që përdorej për "juri" para njësimit të gjuhës letrare.

[4] *Tajari*: Vëllai i Dritëroit, Tajar Agolli.

nerva. Njeriu kur nuk ka punë, merret me thashetheme dhe ul dinjitetin e tij.

Për xhaxhanë tënd[1] më vjen keq. Patjetër kur të vij do ta shoh. Po mos kij frikë, njeriu është shumë qënie e fortë dhe di se si të mos vdesë.

Sot më telefonoi shoqja jote. E kishte marrë letrën tënde, që ia kisha postuar unë. I thashë të vinte të takoheshim në kafe "Tirana" për t'ia dhënë edhe unazën, natyrisht edhe për ta qerasur, po ajo tha se më mirë të vinte tek stacioni i autobusëve afër Bankës së Shtetit. Nesër në ora katër do shkoj ta takoj. Janë të turpshme të gjorat vajza. S'kanë edhe faj, të bekuarat, ka llafe poshtë e përpjetë.

Si moj? Po qënka larg ajo e dreqosur shkollë? Po kur të bjerë shi? Oh, e gjora!

I more ato që të dërgova me atë Tonin Dedën (paret)? Ramizi besoj se do ta ketë blerë pardesynë. I priste paret i gjori me padurim. Edhe ty të dukej si fantazi që unë të gjenja aq lekë! Të kujtohet si u dëshpërove, kur i pritnje atë të shtunë dhe unë nuk t'i solla? Nejse, ta përmend këtë ashtu kot, jo për të të mërzitur: falna, o Zot, se s'dimë ç'bëjmë! Apo jo?

Nesër them të shkoj të qethem se jam bërë si prift orthodoks, po përtoj. Sa mërzi kam të qethem; më mirë të hap kanal se sa të qethem. Ama ç'qyfyre po të shkruaj. Po s'ka gjë, se kështu flas me vehte, pasi jam vetëm, është vonë e të gjithë flenë, sikur të kenë lëruar tokën tërë ditën.

Mos u mërzit që unë ka kohë që s'kam ardhur në Shkodër. Edhe sikur mos të vij, unë ngaherë e kam mëndjen tek ti, e ngaherë të dua. Ky, siç e sheh edhe ti, është si një lejtmotiv në letrat e mija: dhjetra herë është përsëritur. Ti s'mërzitesh kur e dëgjon, se përsëritja është nëna e dijes. He-he, shprehje! Kjo letër do të të vijë nga e mërkura. Vonohen këto të uruara letra.

Të puth shumë, shumë
Dritëro

[1] Këtu është fjala për xhaxhain e Sadijes, tregtar, dënuar prej sistemit të atëhershëm për fshehje pasurie.

[18.XII.1964]

E dashur Sadije,

Po të shkruaj edhe sot ca radhë, që kur ta shohësh postierë, mos thuash për mua: Si nuk shkrojti dy fjalë, xhanëm!

Sonte do të rrij zgjuar gjer afër mëngjesit, se kam një punë të ngutëshme. Po para se të filloj, mendova të të shkruaj këtë letër të vockël.

Ti patjetër tani fle e sheh në ëndërr hartime e diktime. Më vjen keq që lodhesh aq shumë. Sikur të isha unë atje, me siguri nuk do të lodheshe. Atë javë nuk u lodhe fare.

Hiç nuk e di si do ta kaloj vitin e ri. Edhe të vij në Shkodër, ku të vemë? Viti i ri zakonisht bëhet në shtëpi, apo në një rreth shokësh. Kështu që atje vështirësohet shumë çështja. Sidoqoftë kaloi edhe ky vit. Për mua e për ty ky vit ka patur një rëndësi të madhe, aq të madhe sa ta mendosh mallëngjehesh. Prandaj ne këtë vitin tonë duhet ta kalonim bashkë, të dy, e dashur.

E more vesh? Shoqja jote, Elena e Ismailit, bëri çupë. Të atin e çupës e urova. Ende nuk e di rëndësinë e babait, i gjori.

A shkoi ushtar Mehdiu[1]?

Unë mërzitem për ty e gjithnjë më merr malli. Sot piva një kafe vonë në "Flora". Isha vetëm e m'u kujtove ti. Mirë do ish të pinim të dy. Me kaq, të puth shumë herë.

Dritëro

P.S. *Sapo mora letrën tënde. Sa ishte vonuar! Po thuaj se një javë. Unë gjithnjë të kam dashur, kot sa ke dyshuar. Patjetër tani të dua më shumë se kurrë. Më të dashur se ty unë s'kam njeri në botë. Edhe unë jam i lumtur që të kam gjetur ty. Ti je për mua ai njeri që gjithë ëndrrat e mia drejtohen drejt tij. Pa ty unë kushedi si do të isha! E tërë jetën kështu do të të dua.*

Të puth shumë, Dritëro

[17.XII.1964]

[1] *Mehdiu*: Vëllai i Sadijes.

[31.XII.1964]

E dashur Sadije,

Po të shkruaj shpejt e shpejt dy-tri radhë. Sonte ti, siç duket, do ta festosh vitin e ri në shtëpi. Edhe unë, besoj se do të çdukem në ndonjë vënd.

Në qoftë se i mbaroj ato punët që duhen për celebrim do të vij patjetër të djelën pasdite, ndryshe të hënën në mëngjes. Mua më vjen keq që nuk e bëmë bashkë Vitin e Ri. Po t'i thuash ndonjërit i duket si e pabesueshme arsyeja. Megjithatë, s'ka gjë.

Edhe njëherë të uroj 1965-ën, të uroj siç mund të urojë një njeri kaq i lidhur me ty, e kaq i dashur.

Të puth,
Dritëro

E dashur Sadije,

Kjo është letra e fundit për 1964-n. Bukur ndodhi me ne. Na ishin dy njerëz diku në një qytet, u takuan, u dashuruan. Viti ecte, ecte. Dhe kështu erdhi dita e fundit e 1964-ës. Njeriu ditën e fundit të vitit bëhet pak filozof, apo jo? Të kujtohet kur më ke takuar mua me një shishe në dorë vjet në këtë kohë? Ku ta dinje ti se ai njeri me atë shishe një ditë do të bëhej burri yt? E sheh sa të papritura ka në një vit? Po ti mund të mos bëheshe gruaja ime. Kudo që të ishe e me këdo që të takoheshe ti do të ishe njeri i mirë dhe i bukur. Ndofta unë ty të kam ëndërruar edhe në vite të tjerë, edhe pa të parë? Ë, ku ta dish? Po bëhem pak mistik e qesharak.

Në fund të këtij viti, plot dashuri për ty, të uroj të jesh e mirë, e bukur, e dashur. Unë jam ngaherë edhe burri edhe i dashuri yt.

Të puth shumë, shumë,
Dritëro

1965

[7.I.1965][1]

E dashur Sadije,

U ktheve në shtëpi e lodhur, po me fitore. U bëre zyrtarisht gruaja ime. S'ka tani tërc-mërc. Emrin tim e ke edhe në pashaportë. Bëjmë shaka, se s'ka ndonjë rëndësi një vulë e thatë. Ne edhe sikur mos e kishim atë vulë prap bashkë do të ishim.

Sa u lodhe dhe sa nerva prishe ato nja dy ditë që isha unë në Shkodër. Po kushdo që të ishte ashtu do të mërzitej si ti. Nisesh për një gjë serioze e të del përpara një pengesë mizerabël! Mua më vinte shumë keq për ty. Po mirë që mbaruam shpejt. Unë ty të dua gjithnjë e më shumë. Mos kij për këtë asnjë dyshim.

Edhe celebrimin e bëmë, edhe e duam shoku shokun. Vetëm, me që janë bërë tërë formalitetet, ti duhet të vish ndonjëherë në Tiranë. Llogjikisht tani nuk duhet të kesh asnjë pengesë nga asnjeri. Të them të vijsh se mua ngaherë më merr malli për ty.

Dje, pas celebrimit tonë të famshëm, unë kam qerasur gjithë ata njerëz. Të trashëgohesh, thosh njëri; të trashëgohesh, thosh tjetri. Sikur ne u fejuam dje! Siç duket ajo e djeshmja paska rëndësi dhe u quajtka si martesë.

Sot më erdhi telegrami yt dhe u gëzova që e ndjen vehten mirë. Kur u nise dje unë u trëmba, se do të sëmureshe shumë rrugës.

Lutjen a e bëre? Mos e lër pasdore dhe mos i nënvleftëso formalitetet, si unë se ngatërron punën siç e ngatërrova unë në zyrën e gjëndjes civile në Shkodër. Po më mirë që e bëmë celebrimin në Tiranë, u bë më natyrshëm e më njerzishëm. Edhe Qakua me Vaskën[2] ishin simpatikë.

Eja papritur ndonjëherë.

Të puth shumë,
Dritëro

[1] Në këtë datë Dritëroi dhe Sadija e bënë lidhjen e tyre zyrtare.

[2] *Qakua me Vaskën*: Qako Dango dhe Vaskë Rafi, miq të Dritëroit dhe Sadijes, dëshmitarë në ceremoninë zyrtare të martesës.

[8.I.1965]

E dashur Sadije,

Ngrive ti sot tek autobusi, moj e dashur; dimri është stinë e vështirë për dashnorët! Sa marr udhën për në shtëpi, mendoj për të ardhur prap tek ti. Mua gjithnjë kur nisem më vjen keq që ndahem, dhe pa marë biletën them me vehte: sikur të mos ketë bileta e të ik pasdite! (megjithëse duhet ikur në mëngjes).

Nesër ti do të fillosh punën. Mos u nevrikos e mos u mërzit. Katër muaj pune ikën shpejt. Nesër unë do të bëj lutjen për të të regjistruar në Tiranë. Ka çaste kur ti për mua çfaq ndonjë dyshim se vallë të dua aq shumë, dhe se unë kushedi se ç'mendoj. Ç'budallaqe bëhesh! Unë pa ty nuk mund të marr me mend jetën. Nuk e sheh ti? Mund të bëhem dot unë artist e të luaj rol? Ja rri tani pas mangallit, dua ta shkruaj atë artikullin që e lashë që në Shkodër, po s'mundem, më venë mëntë tek ti.

Sonte binte dëborë. Dolla në rrugë me republikën e plakut, megjithëse është e vjetër, po ç't'i bënja se më ngrinte koka. Ti ke të ftohtë? Atëherë po të puth fort që mos kesh të ftohtë.

Yti,
Dritëro

[10.I.1965]

E dashur Sadije,

Si je, moj gruaja ime e shtrënjtë? Je bërë fare dembele, as shkruan letra, as na vjen këtej nga Tirana. Unë rri këtu vetëm e mërzitem për ty. Kur vij ndonjëherë vonë, në dhomë s'ka dritë, në dhomë është ftohtë. Atëherë them me vehte se po të ishte Sadija ime e dashur nuk do të mbretëronte kjo gjëndje!

Interesante. Tani unë krejt jam i martuar, veçse ti - gruaja ime - nuk je në shtëpi po në një dhomë tjetër diku.

Ato ditë, edhe në Shkodër, edhe në Tiranë, ne të dy nuk ndenjëm fare vetëm. Ishim aq të preokupuar. Kur të takohemi do çmallem, se kam një mall të madh për ty, aq sa më duket sikur kam një vit që s'të kam parë.

Në telefon ik shumë shpejt koha e njeriu nuk bisedon dot. Atë ditë që telefonove ti u çduke menjëherë.

Besoj se qerase shumë njerëz të enjten. Të uruan. Njerëzit këtë (kur shohin shënimin e gjendjes civile) e quajnë seriozisht të mbaruar. Letrën do të ta drejtonja në mbiemrin tënd të ri (Agolli), po kam frikë se postieri nuk është mësuar dhe mos e humbë. Prandaj më parë duhet mësuar.

Unë besoj se tani, me që kemi të drejta të barabarta, edhe ti duhet të vish në Tiranë. Është mirë ta bëjmë me rradhë: një herë unë, një herë ti.

Ramizit e Lumes[1] thoju të fala nga unë. Më kishin dërguar një kartolinë për Vit të Ri. Nuk ia dinja adresën e shtëpisë që t'u kisha dërguar. Nuk m'u kujtua që t'ua dërgonja në punë.

Po ta gjesh Ahmetin, merrja ato librat që i kam dhënë, merrja gjithashtu edhe një numur reviste "Inostranaja literatura". Lutjen e bëre?


[1] *Ramizi dhe Lumja*: E motra e Sadijes, Lumja, dhe bashkëshorti i saj, Ramizi.

Edhe unë do bëj një lutje, që të të pashaportizojnë[1] ty në Tiranë. Duhet bërë që tani.

Prushi në mangall po më shuhet. Në dhomë po bën ftohtë. Më duket sikur jam brenda në ujë, si peshqit e mi në akuarium. Dua të mbulohem me jorgan, pra, që t'i shpëtoj këtij të ftohti. Prandaj natën e mirë.

Të puth shumë,
Dritëro

[1] *Pashaportizim, pasaportizim*: Term zyrtar i dikurshëm për të treguar njohjen e së drejtës për t'u zhvendosur nga një vendbanim në një tjetër, kryesisht në qytet.


E dashur Sadije,
Po të dërgoj ato dy dokumentat
që kërkove. Ata fishekë pse
i kërkojnë një nga një e
s'të thonë që më parë se
ç' duhet të marrësh? Të lodhën
kot së koti!
Ç'kemi, si je? As letra
shkruar! Duket sikur je zë-
mëruar.
Nuk erdha dot këtë të
shtunë. Isha dezhurn të hë-
nën. Për ty si gjithnjë më
merr malli.
Të puth
Dritëro
13.1.65

[19.I.1965]

E dashur Sadije,

Po të dërgoj ato dy dokumentat që kërkove. Ata fishekë pse i kërkojnë një nga një e s'të thonë që më parë se ç'duhet të marrësh? Të lodhën kot së koti!

Ç'kemi, si je? As letra shkruar! Duket sikur je zëmëruar.

Nuk erdha dot këtë të shtunë. Isha dezhurn të hënën. Për ty si gjithnjë më merr malli.

Të puth,
Dritëro

[23.I.1965]

E dashur Sadije,

Ti ndofta sot më pret të vij, ndërsa unë jam dezhurn. Me të vërtetë më ka marrë shumë malli për ty, se ka kohë që nuk të kam parë. Sa inatosesh ti që edhe këtë radhë s'erdha! Kushedi ç'mendon. Mos u mërzit e dashur. Po të jesh larg kështu ndodh.

Unë e prita Ramizin të premten, që më tha se do të vinte, po nuk pashë njeri.

Koha po kalon shpejt, e dashur, e ti së shpejti përgjithnjë vjen tek unë. Atëherë nuk do të të le të shkosh më në Shkodër. Do të nxjerr inatin që kam grumbulluar këto muaj larg teje. Sikur ti të vinje herë pas here tek unë, nuk do të të pengonja të shkonje në Shkodër edhe kur të martoheshe. Tani s'ka, do të të mbyll edhe unë brenda! E zeza ti!

Unë nuk kam bërë ndonjë gjë të rëndësishme. Kam lexuar shumë. Dy-tri ditë përpara fillova të lexoj novelat e Prosper Merimesë, disa prej të cilave i kisha lexuar shumë vjet më parë. Në rininë studenteske ai mua nuk më pëlqente fare. Mund të them se sot më ka mahnitur. Ti do të ndjenje një kënaqësi të çuditshme sikur të lexonje, p.sh., një novelë të gjatë të tij "Gabimi i dyfishtë", apo "Vazua etruske", "Purgatori i shpirtit", "Venera e Ilit", "Rrugica e zonjës Lukrecia", "Abati Oben", "Dhoma e kaltër" etj. Kur lexova "Gabimin e dyfishtë" ndenja deri më katër pas mesnate. Unë nuk tronditem shumë nga veprat letrare dhe jam mjaft gjakftohtë, po Merimeja më tronditi. Ç'fishek edhe unë! Po të shkruaj siç mund të shkruajë ndonjë student i kurseve të ulëta që çuditet me dy-tri radhë që lexon! Por unë të shkruaj kështu se për Merimenë kam patur përbuzje. Dikur më ka pëlqyer nga ai vetëm "Kolomba" dhe "Mateo Falkone", që ti duhet t'i kesh lexuar, kurse "Karmeni" asnjë përshtypje s'më ka bërë.

Ti, besoj se je mirë, gruaja ime e dashur; provimet i ke

mbaruar e je në pushime. Të kam zili, moj e dashur, të kam zili!

Më duket se të hënën do të vij për nja dy ditë në Shkodër, do të vij përpara kësaj letre me siguri.

E mora letrën tënde që më shkruanje për atë ëndrrën e tmerrshme që kishe parë për mua. Mos kij merak, e dashur, siç duket do të jetoj shumë!

Të puth shumë e shumë me dashuri,
Yti, Dritëro.

[31.I.1965]

E dashur Sadije,

Mos u mërzit nëse vonohet ndonjë letër. Edhe kur të dërgoj rrallë letra gjithnjë ti më vjen në mënt.

Të premten u ktheva nga udhëtimi. Isha në Durrës, Lushnjë e Berat. Tërë udhës kam menduar për ty. Për të shkruar për gazetën nuk gjeta ndonjë gjë, po mbresat m'u shtuan. Kam dëshirë të shkruaj një tregim për një ngjarje që dëgjova. Takova një njeri, që kish ikur me ciganët (kurbatët). Ky ishte një vagabond interesant dhe ishte bërë pothuajse përgjegjës i ciganëve nomadë. Kish edhe një ciganke që i vërtitej. Ngjarje si e Karmenit të Merimesë, apo si "Ciganët" e Pushkinit, po natyrisht pa gjakderdhje. Që ta shkruash këtë duhet të njohësh ca zakone cigane. S'do ment se unë do ta shkruaj në plan humoristik.

Të premten e takova Bedrinë[1]. Kur e pashë u gëzova se mendova mos kishe ardhur ti. Ndenjëm gjatë me të. Shkuam edhe në shtëpi. Të shtunën ka mundësi të vij. Do më presësh? Në letër më thoshe se ishe e sëmurë. U bëra merak e donja të të telefononja, po e lashë se pata frikë mos çqetësoheshe. Kur telefonove sot, unë sapo kisha dalë. Vërtet, tani ne të dy jemi shumë të lidhur njëri me tjetrin. Edhe unë e shoh dhe e ndjej këtë. E kjo vjen dita ditës duke u forcuar. Mua ti tani më duhesh e je bërë krejt e domosdoshme. Kjo dreq distancë na mërzit. Po edhe kjo po shkurtohet. Është vonë në dhomën time, dy pas mesnate.

Të puth shumë, shumë,
Yti, Dritëro

[1] *Bedriu:* Vëllai i madh i Sadijes.

[2.II.1965]

E dashur Sadije,

Mërzi është të rrish vetëm kështu si unë. Më dhëmb edhe një vesh. Duhet të jetë ftohur i uruari. Ky ma shton akoma mërzinë.

Kam ndërmënd të vij të shtunën, po të djelën me autobusin e orës dy duhet të kthehem prapë në Tiranë. Besoj se ti tani duhet të jesh shëruar. Mbrëmë të kam parë në ëndërr në një mënyrë të pabesueshme (të gjitha ëndrrat janë të pabesueshme!). Të kam parë sikur u ndave nga unë. Ishte një çast i trishtuar. Me që të pashë kështu në ëndërr, do të thotë se të dua shumë.

Po të dërgoj një fotografi komike nga udhëtimi im, që të qeshësh.

Të puth shumë,
Dritëro

Shkodër, [2.II.1965]

I dashtuni im,

Më fal që të kam shkrue në atë mënyrë. Mos e lexo dy herë, mos mbaj në mend asgjë nga ato që të kam shkrue. Ajo letër s'ka të bajë me dashuninë që ushqej për ty. Jam mësue keq, unë rrallë kam mendue vetë për të zgjidhë ma të randësishmen në jetë. Gjaja e vetme që përfundova pa ndihmën e tjerëve deri në nji farë vendi, asht fejesa e ime me ty. Gjithmonë, për çdo gja kanë mendue të tjerët, ato që më donin. Kjo asht e meta e ime ma e madhe që kam unë. Të kujtohet sa nevrike isha ba në kohën e celebrimit. Kështu bahem edhe kur ndeshem me gënjeshtrën, me burokracitë e njerëzve. Due që ta zhduk këtë të metë, po nuk mundem. Ka të drejtë motra kur më thotë se për disa gjana të jetës kam mendjen e një 15 vjeçareje. Ajo atëherë ma tha në inat e sipër, po unë tashti e ve re, se ka pasë të drejtë.

Ja të shkrova ato marrëzi nga fjalët e ndryshme që ndëgjova, nuk mendova ma thellë se sa mund të vrasin ato që të kam shkrue kur je larg meje. Por ti kujto se Sadija asht ndonjiherë budallaqe dhe pendohet ma vonë kur kupton budallallëkun.

Të shkrova ashtu nga që kisha frikë se mos ftohem nga ti kur të lindin edhe nevoja e të hollave. O, unë s'due të mendoj hiç për ato. Sa mirë që kemi Xhexhenë, se unë do ta baja lamsh shtëpinë. Ai konvikti i 4 vjetëve më vlejti shumë, por ja prapë jam midis këtyne që më dojnë dhe që më plotësojnë çdo dëshirë.

Dikur, kur isha e re shumë, kur shihja dashninë dhe kujdesin e madh të prindërve mendoja t'ua shpërbleja tue punue për ato, ose tue i ndihmue në mënyra të ndryshme. Por andrra e ime nuk u plotësue.

Në vend që t'i ndihmoj, vazhdojnë ato të më ndihmojnë, vazhdojnë të më plotësojnë çdo dëshirë që çfaq. Ja pse të shkrova atë letër. U frikësova tue mendue se edhe burri im

nuk mendon shumë për disa çështje që do të lindin ma vonë. Asnjiherë nuk kam mendue për atë që veshëshe të re në trup, por tashti jam pak a shumë afër këtyre gjanave dhe s'di se si kam një frikë. A do të di unë vetë, kur të jem krejt e pamvarun të veproj si duhet. Lenin dhe Verin që i kisha shoqe të ngushta, më këshillonin për çdo gja. Po tashti, kush do të jetë këshilluesi i im. Nanën s'do ta kem pranë, as Verin, as Lenin. Do të thuesh ti më ke mue. Deri në një farë vendi, i dashtun.

Më vjen inat që jam rritë në nji ambjent që nuk din ç'asht djallëzia, që beson në të mirën, në paragjykimet.

I dashtun, ti dikur më ke thanë, s'kam hasë njeri të tillë që të ketë kaq nevojë për dashuni. Kjo asht e vërtetë. Bile më duket e çuditshme që një njeri të më urrejë.

Mue ndonjiherë më lind ideja se do të vdes, edhe tashti e ndjej këtë. Nuk e kuptoj as unë se si më vjen ndonjiherë, kërcej nga një gëzim i mbrendshëm, i due të gjithë që shoh, çdo qenie. Më dhimbset ndonji që vuen.

S'di si jam i dashtun, por ty të due ma shumë se të gjithë, megjithëse edhe prindët i due shumë. Dritëro, kam frikë se ndonjëherë do të mërzitesh prej meje, sa do të vuej unë atëhere.

Tashti ora 7 e mbramjes, nuk kam dalë hiç nga shtëpija. Fryen nji erë e ftohtë shumë jashtë. Nana po më lut të ha ndonji gja, se në drekë nuk kishe oreks.

O Zot, them, po ma vonë si do ja bëj. Ishalla kur të vi tek ti, s'do jem kjo.

Ti vetë më ke paralajmërue se unë nuk jam i kujdesshëm ndaj grave. Po s'ka gja unë të due sido që të jesh. Njeni prej nesh do të ndryshojë se nuk ban. Si thue ti, a kam të drejtë? Më thuej po. Letrës i erdhi fundi, si nji hartimi të zgjatun sentimental me nji temë të lirë.

Të puth shumë, Sadija
Natën e mirë, i dashtun.

[3.II.1965]

I dashun Dritëro,

S'due të shkruej ma i dashtun se po të mërzis me letra. Kjo asht letra e fundit që po marr mundimin të bezdis. U banë 10 ditë pa asnji lajm për ty. Kjo asht pak a shumë kuptimplote për mue. Sa je këtu të bjen ndër mend për mue. Më thuej të paktën arsyen. Ky asht nji ndryshim i madh që ve re tek ti. Sa ishim pa ba celebrimin edhe letrat i kishe ma të shpeshta. Nuk të kushton asgja gjysmë ore sa të më shkruesh një letër, megjithëse mund të kesh punë të shumta. T'i kanë marrë mendtë klubet e kafenetë dhe s'kujtohesh. Edhe unë jam tue dalë çdo ditë në shkollë paradreke, ndërsa mbasdreke vizita ndër shoqe. Nuk jam tue u mërzitë aq shumë, nanën nuk e pyes a kam apo nuk kam letër. Sikur të kem e di se më tregon, bile tashti të them të drejtën edhe sikur të kem do ta lexoj me indiferencën ma të madhe, ku di vetë sikur jam ftohë edhe unë pak nga moskujdesi dhe mospërfillja që tregon për mue. Sot bile mora rrogën dhe bleva nji këmishë të bardhë nate shumë të bukur. Isha me shoqen time, Anën. Më tha natën e parë do ta veshësh, unë qesha vetëm sa për zakon se nuk më bani përshtypje. Edhe pse të kem një vulë të madhe në pasaportë, nuk më ndalon, nëse vë re se ti nuk më don. Ma mirë herët se vonë të veprojsh i dashtun, si thue ti?

Më shkruej të paktën përgjigjen e kësaj letre.

Kjo asht e katërta që po të shkruej pa marrë asnji letër prej teje.

Sadija

[8.II.1965]

I dashtun,

Në Shkodër po bjen borë. Ç'mrekulli! Sikur të ishe edhe ti do të ishte edhe ma mirë. Megjithëse ndejta deri tashti tue ba plane simestrale, gëzimi i dëborës së parë që po bjen nuk më asht shue. Kjo dëbora lidhet gjithëmonë me kujtime të bukura. Nesër filloj edhe shkollën, do dal të baj disa fotografi. Sot më dukesh sikur të përcillnja në ndonji vend të afërt, sikur ti do të vijsh përsëri së shpejti. Vetëm kur ikën, më kap mërzia. Tashti e shoh sa e lidhun jam me ty. Mirë thue ti, jemi lidhë me fije të padukëshme aq keq sa nuk mund të zgjidhemi ma. Tashti hajde mbas tre javësh se këtu harxhon edhe shumë të holla. Unë të premtoj se nuk do të mërzitem. Tashti fillon edhe shkolla, kështu që do të jem gjithëmonë e zanun, por mos kujto që s'do kem kohë të lirë të mendoj për ty. Çdo natë mendoj dhe due që të shoh në andërr. Ti je njeriu ma i mirë dhe ma i afërt për mue, edhe atëherë kur jam e inatosur me ty. Mor fishek meqenëse ke premtue se do të mbarojsh novelën, puno, mos u sill shumë. Artikullin a e shkrove, do të kesh mendue mjaft në autobus. Katër orë nuk i thojnë pak, mandej bashkëudhëtari nuk besoj të të ketë mbajtë me muhabet. S'kisha pse të bahesha xheloze. Po shkoj të fle se ora shkoi vonë.

Të puth përpara se të marrë gjumi, sidomos synin që s'para të sheh mirë. Do ta shëroj edhe atë me të puthuna.

Të puth shumë,
Sadija

P.S. *Sot sa ika prej shkollës së tregtisë, mora tre letrat e tua. Natën e mirë i dashtun*

[12.II.1965]

I dashtun Dritëro,

Mbramë të pashë në andërr sikur ishe majë nji shpat mali të thepisun dhe më kërkoje ndihmë. Unë s'mund të vija tek ti dhe thërrisnja. Megjithëse jashtë ftohtë dhe në pullazet vezullonte dëbora e bardhë unë kishe nji të nxehtë të madh. Mirë që asht andërr mendova dhe nuk donja të flinja nga frika mos shoh prapë andërr të keqe. Atë natë që ti nuk ishe në Shkodër ra shumë dëborë. Shkuem me Myskan[1] e bamë disa fotografi, por nuk na lenin gangsterët tue na gjuejtë me topa dëbore dhe s'besoj të kenë dalë të mira.

Atë ditë dy herë u rrëzova, por mirë që kishe veshë pantallona. Edhe në shkollë kam shkue kështu, megjithëse deri tashti në mbramje s'kam ba asnji orë mësim se nuk na kanë ardhë nxanësit. Sonte kam 4 orë dhe besoj se do kemi mësim, mbasi dëbora ka fillue të shkrijë. Fryn nji erë e freskët, që të pëlqen ty. S'kam hangër shumë topa dëbore. Ditën e parë më gjuejtën, megjithëse kudo dilnin nxanësit e mi, kështu që shpëtonja. Ndonjiherë shpëtonja edhe si e fejuemja e Dritëro Agollit. Bile mbramë kur dola prej shkolle ishin dy djem dhe zinin në gojë emnin tand, sigurisht pse para tyne ishe unë. Kishte plot që thonin: profesoreshën e natës mos e gjueni. Bile nji djalë i hangri gjithë topat nga shokët pse më doli në mbrojtje. Edhe nga fëmijët shumë më delnin në mbrojtje. Njiherë kur dola prej shkolle ishin grumbullue shumë djem dhe m'u desh që t'i kërkoj ndihmën nji burri, i cili më shoqnoi një copë rruge. Tashti nuk kam frikë se bora po shkrihet dhe asht ftohtë.

Sa mirë të ishe ti këtu, të rrinje edhe nji ditë do mbesnje në

[1] *Myska*: Motra e Sadijes, bashkëshorte e Ismail Lulanit (Piktor i Popullit).

Shkodër. Muhameti i shkretë mbeti këtu. Filloi dëbora, ndaloi qarkullimin dhe ai s'kishte nga shkonte në Berat. Çdo ditë tue dalë me Verin, por s'ja kam shumë zili.

Dritëro, a shkrove gja apo e le fare artikullin. Leni Havalen a e ke pa? Duhet të ketë ardhë prej shtëpije, nëse nuk e ka zanë dëbora. Po Elena e Ismailit a erdhi prej Elbasanit? Vajzën si e ka? Ajo vetë a asht shëndoshë apo dobsue? Mos harro për V.K. Kije parasysh atë që të kam thanë. Mund të jetë ma vonë një çift i lumtun. Të kam gjetë një nuse shkodrane, thueji, mos gabo t'i tregosh gja për Luigjinën se na fik.

Letrës i erdhi fundi. Ka dalë filmi Kivitok, do shkoj ta shoh se më ka pasë pëlqye dikur, kur ishe në maturë. Të fala prindërve.

Të puth fort,
Sadija

[16.II.1965]

E dashur Sadije,

Po të shkruaj nga Durrësi. Këtu fryn një erë e tmerrshme dhe bie një shi i ftohtë që të than. Unë erdha dje dhe do të rri nja tri ditë. Mendoj të kthehem të enjten. Kur po iknja mora letrën tënde dhe e lexova udhës, bile e kam në xhep. Në hotel "Vollga" është ftohtë; po të merr gjumi mirë se fryn erë dhe deti buçet, si mijëra pazarë. Natën kam menduar për ty, duke pirë cigare dhe më vjen keq që s'mund të vij dot të shtunën. Kam shpresë mos marr ndonjë shërbim të gjatë nga Kukësi dhe të bëj një stacion në Shkodër.

Në ndërmarrje të botimit më thanë se honoraret e librit nuk m'i japin tani "pasi i prish". Më datën 14 qershor, "afër dasmës". Ç'fishekë!

Asnjërën nga Elenat nuk kam parë dhe nuk e di nëse janë në Tiranë apo në qytetet e tyre të lindjes.

Të kam marrë një herë në telefon në orën pesë pasdite, po në zyrën tuaj asnjeri nuk përgjigjej.

Nga që më ka marrë malli për ty dua të vish të shtunën papritur.

Revistës "Ylli" i dhashë 8 vjersha[1] dhe do t'i botojë në një faqe të gjitha. Kam shkruar tre tregime të shkurtër[2], të cilët ia kam premtuar "Dritës". Njërin e kisha në mënd dhe e mbarova sot në Durrës. Më duket se janë interesantë. Janë fare të shkurtër dhe gjysmë fillozofikë.

Nga Durrësi të puth shumë;
buzët m'i ka kripur deti.

Yti, Dritëro

---

[1] *Tetë vjershat* dorëzuar për botim tek revista "Ylli" në shkurt 1965-ës, për të cilat flitet këtu, janë: "Kënga e tokës"; "Te varri i gjyshit"; "Forca"; "Me Don Kishotin"; "Eureka e Arkimedit"; "Duke u menduar" dhe "Për kujtim".

[2] *Tre tregimet e shkurtër* dorëzuar në gazetën "Drita" u botuan më 4 prill 1965 dhe janë: "Përpara bukurisë"; "Mullixhiu (Kujtime të Xha Ilos, mullixhiut të fshatit tonë)" dhe "Sonata e tetë".

[17.II.1965]

I dashtuni im,

Për një ditë mora tri letra. U gëzova shumë dhe gjithë ditën kishe një gëzim të mbrendshëm. Sot në Shkodër po bjen borë me shi. Asht nji borë me flokë të mëdha dhe duket kaq e bukur, sa nuk e merr me mend. Eci nëpër borë, shkoj në shkollë. Nuk kam të ftohtë, nuk dridhem. Kam lidhë shaminë e pardesysë në kokë, në kambë galloshet e nuk e ndiej hiç të ftohtin. Kam nji dëshirë të madhe të hecë nëpër bardhësi. Ah sa mirë, sikur të ishe edhe ti! Do delnim, do shëtisnim nëpër borë, por ty do të lageshin kambët se nuk ke galloshe. Unë jam ftohë nji çikë, më duket se më ka ra gripi qysh në ditët e dëborës. Sot jam ma mirë. Më duket sikur jam shëndoshë prej çajit të shumtë që kam pi ose jam fry prej gripit, por megjithatë e ndjej vehten shumë mirë. Them edhe katër muej dhe mbarova. Bile mbramë bisedova tue qeshë me drejtorin. Edhe ai i shkreti ka pasë hall, prandaj nuk i ve faj.

Mbramë kam spjegue shumë mirë, më doli nji mësim i mirë, sa dola e kënaqun unë dhe nxanësit.

Mirë që ke ble nji peshk lozonjar, se të ishte i ngathtë nuk do më pëlqente. Edhe lulet i ke të mira. Ajo dhomë që rrin ti, ka një ambjent të ngrohtë. Sikur të dalë mirë në këto fotografitë e dëborës do smadhoj nji e do ta çoj që ta vejsh në dhomë pranë tandes. Dritëro, kam ble edhe këpucët e bardha të martesës, veç kam hall se i kanë takat e nalta, por janë shumë elegantissimo. Qerimi më asht mbështetë në gjunj, të dinte se kujt po i shkruej. Shumë herë më lot kambët, prandaj po të shkruej kështu.

Të shtunden shkova në rreth metodik[1] për herë të parë.

[1] *Rreth metodik*: Ishin rrethe që funksiononin pranë shtëpive të kulturës për nxitje krijimtarie.

Kot që shkova, se u mërzita, por e bana për hatër të Verit se ishte vetëm ajo e gjinisë femnore. Ndejtëm deri në orën 6.30 mandej shkuem në shtëpinë time dhe bamë muhabet nja nji orë. U kënaqëm. Letrën po ta vazhdoj në shkollë, kam pushim këtë orë. Kemi qeshë me këto profesorët si asnjiherë sa tashti po më dhemb zemra.

Dritëro, ti hajde nga marsi në Shkodër. Këtë letër ta kam shkrue shumë bukur, nga shkrimi sigurisht.

Nejse, të puth shumë.
Sadija

Po t'i shtoj edhe dy rradhë para se ta postoj. Të due si asnjiherë. Sa fishekë janë profesorët! S'kam qeshë si sot ndonjiherë, sa ju ngjita edhe këtyne tjerëve gazin pa e dijtë pse. Ka ardhë edhe inxhinjeri i Didit me dhanë mësim tek na, dolëm si kushurij të largët. Kaq e vogël asht Shqipënia sa dalin të gjithë kushurinj. Shet mend nji çikë, por megjithatë nuk duket djalë i keq. Ti mos u ban xheloz, se ma i mirë se ti nuk asht. Me punë jam tue e kalue mirë. Jemi ba nji shoqëni gazmore, po jam unë vetëm vajzë se Ana si grue e martueme rrin në nji qoshe e vetmueme dhe serioze. Edhe kur të martohem, nuk do të bahem si ajo.

Të puth shumë Sadija.
E martë mbrama 16.II.1965

Nesër do ta postoj ose sonte në se i biem nga bulevardi me Mehdinë.[1]

[1] *Mehdia*: vëllai i Sadijes

[19.II.1965]

I dashtuni i im,

Do të thuesh që Sadija më harroi, ka kohë që s'më ka shkrue. Jo, çdo çast mendoj për ty, por them do i shkruej në mbramje në dyshek. Sa hyj në dyshek kam të ftohtë, edhe sonte tue u dridhë po të shkruej, e sheh edhe nga shkrimi. Sonte grueja jote asht ba trimneshë dhe ka ardhë vetëm në shtëpi. Binte dëbora, çdo gja filloi përsëri të mbulohet me petkun e bardhë. Kjo çuditërisht më kujton petkun e asaj dite, kur do të vijsh të më marrësh përgjithënji pranë vehtes. Sa dëshëroj që të jesh edhe ti pranë meje. Të hecim vazhdimisht në borë dhe të lemë edhe ne gjurmat tona në bardhësi. Sa bukur duhet të jetë në pyll tashti në këtë kohë. Po ti, mor i dashtuni im, ç'ban në këtë kohë? Sa mirë sikur edhe ti në këtë çast të mendojshe për mue. Të puth në largësi kudo me një puthje të qetë, të ngadalshme tue fillue nga mjekra, tue të përkledhë flokët, tue të puthë thinjen e bardhë që e ke pranë veshit. Sa mirë që dashunia të mos kthehet asnjiherë në miqësi, por të vazhdojë gjithëmonë kështu. Unë do të due shumë, shumë. Due gjithëmonë të më thuash sa erë të mirë bjen moj nusja e ime e vogël, sa e mirë je, se unë me të vërtetë, e mirë jam, nuk të gënjej, unë e ndjej në thellësi se jam e tillë edhe ti kështu si unë je. Ja kjo ndofta na ka bashkue kaq shumë. Ti do pyesësh ç'baj unë. Mendoj për ty, për të ardhmen andrroj çdo natë para se të fle, më duket se ajo do të jetë e bukur, pa grindje. Andrroj sikur jam pranë teje, sikur ndëgjojmë bashkë muzikën e Bethovenit, piklat e shiut që përplasen mbas dritares, hajmë bashkë në tryezë, shkruejmë bashkë unë ditarin, ndërsa ti novelën, lexojmë bashkë, shëtisim vonë nëpër rrugë. E ç'nuk

andrroj i dashtunEdhe lexoj. Tashti së fundi lexova "Ditë të gjelbërta"[1] dhe "Midis dy netëve"[2].

Ky Gazmend Kongoli asht influencue shumë nga Heminguej. Bile rilexova "Lamtumirë armë" dhe pashë se ka marrë shumë gjana nga ai, por megjithatë më pëlqej pak a shumë.

I dashtuni i im, përsëri në Shkodër pemët u mbuluen me dëborë.

Sonte një nxanës i klasës sime më mori befasisht në foto tue marrë mungesat. Do të jetë një kujtim i bukur sikur të ketë dalë mirë. Spjegoj mësimin me pasion dhe më vjen shumë keq, kur ndonjeni nuk ma ven vesh*in në mësim*.

Мой милый![3] Çfarë ban ti, shkruen apo lexon deri vonë? Do të prishen sytë fare pa gjyslykë. Mue më pëlqen të vejsh gjyslykë, do më dukesh ma i zgjuet, këtë përshtypje kam pasë gjithëmonë. Pse nuk blen një kapele republika, do të shkojë shumë. Unë blej ndonji gja të re dhe gëzohem kur ta vesh, që të mahnis ty, që të më thuesh sa e mirë dukesh me këtë. Nji profesor i jashtëm që jep mësim tek na, më tha: Sadije gjej modelin e mobiljeve që t'i punojmë ne bukur. Më duen të gjithë, megjithëse ndonjiherë i hedh ndonji thumb shoqnor.

Tashti, natën e mirë i shtrenjti im. Kam të ftohtë, po hy në dyshek që të andrroj për ty dhe të të shoh në andërr.

Të puth fort,
Sadija

[1] *"Ditët e gjelbra":* Roman i Fatos Kongolit, 1964
[2] *"Midis netëve":* Dhimitër Xhuvani, 1962
[3] Мой милый: Nga rus., i dashuri im

[21.II.1965]

I dashtuni im,

Po të shkruej përsëri pa të postue letrën. Nuk dola hiç dje nga shtëpia, kam qenë ratë në kuzhinë gjithë ditën pa luejtë nga vendi, bile edhe drekën e hangra jo në tavolinë, por ndejun. Sa inat e kam vehten, njiherë në muej më duket sikur jam grue lehonë. Sa të mirë që e kam nanën, nuk më len hiç me lëvizë. Mbramë nuk kishe gjumë dhe më dhimbte njeni gju. Mendonja po sikur këto dhimbje të ishin të vazhdueshme çfarë do të banja, kur edhe dy ditë mezi i duroj. Baba ka marrë 15 ditëshin dhe gjithë ditën u tallte me mue tue më thanë : mjerë ajo shtëpi që i ke zanë derën, se nuk je për asnji punë. Megjithatë, më pruni molla.

Sot jam ma mirë, ma e freskët. Edhe koha asht mjaft e bukur. Dje ishte nji borë e bukur, pemët dukeshin të mrekullueshme, por u shkri shpejt se doli dielli. Ishe e sëmurë se kishe shumë kënaqësi të dilshe. Erdhi Veri[1] mbasdreke e ndejti nja dy orë. Donte të më mirrte të flenja nga ajo; do të shkoj ndonji natë. Dritëro, çfarë ban i dashtun, mërzitesh, lexon, shkruen? Nji nxanës i imi, Buto Smaja, më tha se të kishte pa në Tiranë. Me shkollë jam tue çue shumë mirë, nuk mërzitem. Jam mësue kaq shumë me nxanësit, sa më vjen keq që do i le. Mor a e ke pa Eleni Havalen[2] , nuk di asgja për të, takoje. A do t'i ketë marrë provimet? Elena e Ismailit[3] do të ketë ardhë nga Elbasani. Mos harro të shkojsh, t'i blejsh ndonji peshqesh bebes së vogël. Uroje edhe nga ana e ime. Me apartament a u rregulluen mirë? Tashti do të jenë me siguri shumë mirë. Po ti i dashtun a mendon ndonji çikë për martesë,

[1] *Veri:* Shoqe e Sadijes.
[2] *Eleni Havale:* Shoqe e Sadijes.
[3] *Elena e Ismailit:* Elena Kadare.

a mallëngjehesh? Edhe katër muej mbetën, të nesërmen do të shkojmë fill në plazh. Nuk do bajmë dy dasma si mendonje ti, po nji.

Duhet ta kujtoj martesën, ti vetë më këshillonje në nji letër, po nuk të mërzis shumë apo jo. Nga kjo anë jam e mirë, megjithëse llafe ndëgjoj kaq shumë nga gratë për martesën.

Këto kanë nji shprehje të tynen:

Qeshë vajzë, qeshë pashë.

U martova, u dreqnova

Po unë s'due t'i besoj. Edhe e martueme do të jem mirë, burri i im i dashtun. Sot asht e dielë. Pres të më bijnë gazetën "Drita". Rilexoj edhe unë si ti, kur nuk kam çfarë të baj, se libra të rinj nuk po dalin.

"Kambanat e Bazelit" - Lui Aragon - rilexova mbramë.

Po ty kur po të del libri me tregime? A i përktheve të gjitha vargjet apo ja ke varë tashti, se nuk ke kohë?

Për lejen krijuese çfarë të thanë në redaksi? Sikur ta marrësh duhet të punojsh? Shko ndokund larg dhe puno në qetësi dhe jo të sillesh me mue nëpër rrugët e Shkodrës. Ti duhet të punojsh ma shumë n'ato dy muej. Unë s'mërzitem edhe aq shumë sikur të më dërgojsh vazhdimisht letra. Më kërcen malli për ty po prapë them edhe 4 muej mbetën dhe do të jem vazhdimisht pranë tij.

Të puth shumë,
Sadija

[22.II.1965]

I dashtuni im,

Letrën e mora sot mbas gjashtë ditëve megjithëse rekomande, por postjeri im kishte qenë në zbor. Tjetër letër nuk më ke dërgue. Edhe mue më ka marrë malli shumë, po duroj me stoicizëm. Ne çdo ditë mbasdreke jemi në shkollë, por mund të kemi qenë në mësim. Edhe unë e kam zor me të marrë, se hyj në mësim, gjithashtu nuk jam e sigurtë a je në shtëpi.

Mos merr shërbim në Kukës se ka shumë dëborë. Kot po rrëzohesh me gjithë maqinë rrugës, prit kur të ngrohet koha. Ç'u ba me lejet krijuese, se me sa lexova në "Drita", më duket se keni pasë mbledhje.

Në botimet e 1965-ës përmendej vetëm vëllimi me poezi[1] e ai me tregime jo. S'ka gja, ma mirë kështu.Poezitë pse i çon në "Yllin", ma mirë në "Dritën", ndërsa tregimet në revistën "Ylli". Po të dërgoj dy fotografi të borës. Nuk më pëlqejnë, duhet të laheshin ma mirë. Flokët të zezë, ndërsa gjithkund bardhësi. Po bajnë punë shpejt e shpejt. Nejse të puth fort me buzë të freskta e të ftohta nga Shkodra.

[1] *Vëllimi me poezi:* Bëhet fjalë për librin "Shtigje malesh dhe trotuare".

Shkodër, [23.II.1965]

I dashtuni i im,

Jam e mbushun me nji dashuni të madhe për ty mbas telefonit. Kur të ndëgjoja zanin, kishe nji dashuni kaq të madhe, por s'mund të flisnja lirisht, se në zyrë ishin disa profesora. Sa kisha dëshirë të të shihja, por megjithatë të përfytyronja. Nuk e di si e kam dhanë atë mësim, se mendjen e kisha nga ti. Kam dëshirë të vijsh në Shkodër, por asht shumë ftohtë, prandaj ma mirë të vijsh në javën e parë të marsit. Me shëndet jam shumë mirë. Qerimi[1] sikur don të më shëndoshë dhe pa u çue mirë-mirë prej gjumi vjen të më fusë ndonji gja të mirë në gojë. Dritëro, ti mos u mërzit se unë ty të due ma shumë se askend në botë. Ti je ma i miri, ma i shtrejti. Çdo natë pothuej kam jetue me ty në andërr, aq sa më duket sikur të adhuroj, sikur je nji idhull për mue. Jam ca budallaqe, por s'do mërzitesh prej meje e di unë. Do të kalojsh nji jetë të kandëshme pranë grues tande të qeshun.

Dritëro, kjo asht fotografija ma e mirë që ka dalë prej dëborës. Në se të pëlqen ty do ta zmadhoj se edhe ti ke një foto që ke dalë në dëborë. Nuk di çfarë të shkruej tjetër; në këto çaste jam e mbushun për ty me dashuni. Për të shtunden ban si ta shikojsh kohën në Tiranë.

Të puth shumë herë,
Sadija

P.S. Nji nxanësi i im, po të dërgon dy vjersha, nëse të pëlqejnë përpipu t'ja botojnë në "Ylli" me pseudonim. Asht shumë i turpshëm prandaj. M'i dha të gjitha t'i lexonja dhe nga ato, më pëlqyen këto se të tjerat ishin mjaft sentimentale. Asht hera e parë

[1] *Qerimi:* Babai i Sadijes.

që boton. Janë botue në "Drita" poezi ma të dobta se të këtij, por ti ban si të shohësh. I thashë edhe mendimin tim, megjithëse me rezervë për poezitë e tjera. Do t'i shohim në "Ylli" si janë poezitë e tueja nëse botohen në këtë numër. Due që të jenë të forta dhe të freskta. Lexova javën tjetër në "Drita" nji poezi të Dhori Qiriazit [1](më duket) dhe të ka imitue shumë: Hatixhe, nana ime. Nëse nuk e ke lexue, lexoje patjetër.

Tashti po pregaditem për gjumë.

Të puth fort,
Sadija

[1] *Dhori Qiriazi:* Poet lirik, ishte pjesë e "Brezit të viteve 1960".

[23.II.1965]

E dashur Sadije,

Humbe fare, as letra dërgon, as telefonon. Në Shkodër është ftohtë e unë kam merak mos më sëmuresh. Po mirë që të telefonova dhe mësova që je me shëndet të plotë.

Këto ditë kam patur shumë punë. Të shumtën e kohës kam qënë në redaksi, bile edhe pasditeve. Në dhomën time në shtëpi ka qënë ftohtë, prandaj jam detyruar të rri në zyrë. Kam shkruar nja tetë tregime të shkurtra. Nuk i kam dhënë për botim në asnjë gazetë apo revistë. Siç e di edhe ti, dhashë një cikël vjersha në "Ylli". M'i parapaguan dhe unë bleva me to një palë pantallona për t'i mbajtur, se të gjitha më janë grisur. Këtë radhë po bëhet një kohë e gjatë që nuk të kam parë. Besomë se mëndjen e kam tek ty.

Dua të mbaroj nja dy artikuj pa të vij në Shkodër, ndryshe nuk më lenë të kthehem në Tiranë të hënën.

Të fala të gjithëve,

Ty të puth fort,
Dritëro

[24.II.1965]

E dashur Sadije,

Përnjëherësh mora dy letra nga ti. Këtë radhë kishe kohë që nuk më kishe shkruar, prandaj u gëzova. Mua më vjen keq që ti, ka ditë në muaj, që vuan dhe sëmuresh. Kur të jesh me mua me siguri që në ato dy ditë do të ta nxjerr mërzinë.

Sot isha nga redaksia e "Dritës" dhe i shpura tre tregime[1] të shkurtër. Më premtuan t'i botojnë në një numur. Janë tregime krejt të ndryshëm nga ato që botohen. Nuk e di nëse lexuesi do t'i honepsë. Mund të dalin në dritë këtë të djelë ose tjetrën. Mua pak nga pak po më bëhet një libër tjetër me tregime. Më vonë do t'i mbledh dhe do t'i botoj. Titullin librit të ardhshëm me prozë mund t'ia vë ose "Tranzit", ose "Tregime të pasagjerit të orëve të vona".

Sikur të të takonja ty më shpesh apo të të kisha pranë do të shkruanja më shumë. Kam besim se kur të vish ti tek unë përngaherë do të realizoj të gjitha ato tema që kam në mënd. Po të mos të kisha gjetur ty kishte rrezik që unë të bëhesha pijanec dhe mos shkruanja fare. Duke menduar për ty kam një lehtësi në shpirt e jam gjithnjë i gjallë e i përtëritur.

Për atë artikullin tim "Paragrafe kundër pështpëritjeve dhe thashethemeve"[2] kam marrë letra nga lexuesit. Më ka dërguar letër edhe një mësuese letërsie, e cila thotë se ka pritur një artikull të tillë dhe më në fund u gjend një që e shkroi.

As Lena Havalja, as Lena Gushi[3] nuk duken fare.

Është mezi i natës e fryn një erë e tmerrshme. Kur fryn

[1] Si në shenjimin 30.

[2] *"Paragrafe kundër pështpëritjeve dhe thashethemeve"*, artikull i Dritëro Agollit botuar në "Zëri i popullit", 6 shkurt 1965.

[3] *Lena Gushi:* Elena Kadare, mbiemri i vajzërisë

erë kështu, unë mendoj për ty që e ke aq larg shkollën dhe punon aq vonë. Në Tiranë do përpiqem që të punosh këtej afër shtëpisë.

Si nuk u shkëpute njëherë e të vinje një të shtunë, xhanëm? Kaq vështirë qënka?

Ashtu është, unë dua që ti të jesh gjithnjë e mirë dhe e bukur. Mos kujto ti që unë jam kundër veshjes së bukur të gruas. Përkundrazi dua që ti të jesh sa më elegante e sa më e veshur këndëshëm. E ti gjithnjë do të jesh e bukur.

Të puth fort,
Dritëro

[1.III.1965]

I dashtuni im,

U çudita kur mora vesht sa vonojnë letrat. P.sh. unë letrën tande e marr mbas nji jave. Letrat nuk duhet të vonojnë ma shumë se tre ditë. Unë jam krejt mirë veçse më vinte keq për ty që ke qenë gjithë ato ditë vetëm, pa pasë kush me ta ndezë zjarrin. Tashti patjetër duhet të ketë ardhë Xhexheja nga Korça. Mahnitem me plakën tande që udhëton në mes të dimnit dhe nuk përton. Të gjithë jeni njisoj ju fisi i juej. Dritëro, a i more fotografitë e dëborës? Ti nuk më shkruen shumë se çfarë ban. Çdo natë mendoj për ty se çfarë je tue ba në ato çaste. Kishe nji parandjenjë se do të vinje këtë të shtunde. Shkova nga Veri të shtunden mbrama për darkë. Bamë vizitë tek Luigjina[1], u kënaqëm megjithëse ndjenja mungesën tande si asnjiherë. Më ka marrë malli shumë. Ndejtëm zgjuet me Verin deri në orën 3 të natës tue sjellë ndër mend kujtimet tona. Të nesërmen ishte nji kohë kaq e bukur, nji ditë pranvere e freskët. Gjynah që nuk ishe ti, se do të shëtisnim. Shkova me Didin[2] dhe nji shok të tij për të pa cirkun. Pra dita, si e sheh, nuk kaloj edhe aq keq. Sot ndryshoi koha krejt, bile filloj të bijë përsëri borë, por pushoj. Sonte kam mësim dy orë, të tretën dhe të katërtën, prandaj po kam kohë që të shkruej letër. I dashtun, mos u mërzit, unë mezi ç'pres që të vijë vera dhe të jemi bashkë. Do të martohemi sa të vijë Xhelali prej Tropoje.

Kemi qenë shumë në merak të Xhelalit[3], se andej ka ra borë nji metër e 20 centimetra borë. Ishte ftohë dhe nëpër atë borë kishte ardhë të bante nji radioskopi në Bajram Curri. Na bani nji telefon se letrat nuk i kanë shkue, mbasi asht pezullue

[1] *Luigjina*: Luigjina dhe Veri, shoqe të Sadijes në Shkodër.
[2] *Didi*: Formë familjare për emrin e Bedriut, vëllait të madh të Sadijes.
[3] *Xhelali*: Vëllai i Sadijes.

qarkullimi. Sa më vjen keq për atë se asht shumë larg. Lutjen që ja drejtuem Tiranës na kthej përgjigjen. Kishte firmue kryetari i degës të kuadrit, një Fahri, s'ja mbaj mend mbiemrin. Na lajmëronin se përgjigjen do ta merrnim mbrenda datës 30 korrik 1965. Shiko Dritëro, se mos mundesh me marrë vesht gja për atë, mundohu t'ja rregullojsh në nji farë mënyre që të mos e lejnë atje. Mos e len mbas dore, për hatër tim bane këtë gja, se mue asht e qartë që do më sjellin në Tiranë, në çfarëdo shkolle nuk ka randësi. Në mundsh përpiqu për Xhelalin shpirt, se më vjen shumë keq për atë.

Ke fillue të shkruejsh? Po me artikuj si i ke punët, a e realizon normën? Për Durrësin nuk lexova asgja, megjithëse paske ndejtë tre ditë. Kur pin mos më trego, se më ik humori. E di ç'do të thotë pije marinarësh.

Të puth shumë,
Sadija

[2.III.1965]

E dashur Sadije,

I mora fotografitë e tua. Gjithnjë je e mirë. Cilën të duash mund ta zmadhosh e unë ta vë në mur. Jam mërzitur fare pa ty; një muaj që nuk të kam parë. Edhe koha si për inat; hedh shi, dëborë. Po këtë të shtunë le të bëjë si të dojë moti, do të vij.

Ato vjershat e atij djalit i mora. I ka të dobëta i ziu, po njerën mund t'ia ndreq.

Për verën e sivjetshme mos kij fare merak, do ta kalojmë mirë.

Parmbrëmë fjeta tek një shok, tek Vitua. Ai është i rrëmbyer nga një roman dashurie me një mësuesen tuaj të fiskulturës. Tezja e tij qan dhe bërtet që i nipi po e turpëron. Më tha mua që ta shpëtonja e t'ia hiqnja vëmendjen nga kjo grua që ajo e quan të ligë. Po unë në rolin e priftit nuk mund të vihem. Varet nga vetë Vitua. Ai e do, po, siç më tha mua, ndonjë premtim nuk i ka dhënë. Historira.

Ti si e kalon kohën? Unë kam qënë shumë i preokupuar me punë e andralla. Kam qënë mjaft i mërzitur. Donja, bile, një natë të bëhesha tapë, po mendova për ty dhe e lashë. E sheh, që ti edhe larg nuk më lejon të bëj ndonjë marrëzi?

Të shtunën duhet të më presësh pasdite. Edhe ftohtë të jetë nuk do të të le të shkosh menjëherë në shtëpi.

Të puth shumë,
Dritëro

[4.III.1965]

E dashur Sadije,

Ti më qorton mua se pak shkruaj për vehte dhe ti nuk e di se si unë e kaloj kohën. Ç'të thuash? Ditët janë pothuaj të gjitha të zakonëshme; në punë, në shtëpi, në punë, në klub ndonjëherë. Ndryshe do të ishte sikur të të kisha ty pranë, do kishte një variacion më të madh dita dhe java. Tani ç'të bësh? Ja, pres të marr ndonjë letër nga ti, pres të vijë ndonjë e shtunë për të të parë ty. Kam menduar të shkruaj një poemë për baballarët tanë[1]. Këtë do ta shkruaj me ton polemik dhe duhet të dalë diçka. Për novelën kam menduar shumë skena e shumë situata, po nuk jam ulur seriozisht. Na mbytën këto punët e përditëshme, të cilat nuk ke se si t'i lesh pa kryer. Dua të ulem sot e të mbaroj një shkrim për detarët e Durrësit, se ishin njerëz të mirë.

Për ty është pak e habitëshme, kam filluar të bëhem shumë xheloz, ndofta si shkak i ca fjalëve që më kanë rënë në vesh (natyrisht thashetheme të gënjeshtra). Po ti mos i verë rëndësi kësaj. Kryesorja është që mua dashuria për ty më është shtuar shumë. Mund të jetë edhe kjo një farë arsye që më ka shtuar xhelozinë. Mos u mërzit që të shkruaj kështu; unë shkruaj ç'mendoj dhe ç'mendoj ta them edhe ty.

Fotografitë e tua më pëlqyen. Ti je e mirë për mua në të gjithë fotografitë. Zmadhoje njerën.

S'mbetet gjë tjetër veçse të të përqafoj e të të puth me shumë mall.

Yti,
Dritëro

[1] Poema "Baballarët" u botua më 1969, në librin "Mesditë", vjersha dhe poema.

[8.III.1965]

I dashtun,

Sa e trishtueme jam sot. Tashti duhet të kesh arritë në Tiranë, do të jesh tue hangër dhe ndofta të shkon mendja edhe tek unë. Jam e mërzitun, në këtë çast donja të ishe me ty. Janë shumë 4 muej. Nji vesh i ketrit më kishte mbetë në xhep të pardesysë. Asht nji ketër i mirë, besnik që nuk të gënjen. Ai më ka pa gjithëmonë mue kur jam kthye prej shkolle, veçse asht i heshtun dhe nuk ka gojë që t'u përgjigjet pyetjeve tueja. Duket nji çikë si serioz, se ka nji palë mustaqe të ashpra si burrat xhelozë, po nuk asht i tillë. Ai të don ty dhe mbramë ma tha. Unë e kuptoj atë. Kur ti bahesh xheloz shikoje atë se të ikë xhelozija. Tashti sa erdhi Veri, shkoj me përcjellë Muhametin. E pata zili për disa çaste. I kishte ble nji palë këpucë dhe çorape. Kot t'i shkrueva, por i kishe në mend, se m'i tha njitash. Këto gjana s'kanë randësi i dashtun, nuk kanë të bajnë me dashuninë, bile e ndjej vehten diçka ma të pamvarun.

Tashti më duhet që të pregaditem për shkollë.

Të puth fort e fort,
Sadija

Ora 10:30 paradreke [10.III.1965]

I dashtun,

Të faleminderit për urimin e 8 Marsit, më kishe urue si një burrë i dashtun. Tashti po ndëgjoj një kangë të bukur italjane dhe dora më shpejton nga ritmi i shpejtë i muzikës. E çuditshme, sa e ndjej muzikën, ndryshoj krejt. Bahem ma e butë, më zhduken nervat. Më ka marrë malli që të dëgjoj tek ti muzikën e Bethovenit.

I dashtun, po punon shumë, lodhesh? Deri tashti jam në rregull, se kontroll nuk kemi pasë. Mërzitem dhe më vjen inat që nxanësit nuk pregaditen, dje i shqepa me dysha. Si shihet do të mbes shumë, asht gjynah t'i kalojsh nul. Përsëri fillova hartimet, kështu do të vazhdoj me korigjime deri sa të vijsh ti i dashtun në Shkodër. Edhe mueji mars zene se iku, mos u mërzit. Sadija s'mund të ndryshojë mendjen mbas 9 muejve, xhanëm asgjaje nuk i dihet fundi në jetë, por tashti për tashti ty të due dhe s'ka asnji që të zejë sadopak vendin tand. Të thashë se do bahem serioze në shkollë. Të hanën ishe aq shumë, sa rashë në sy të gjithëve, ma tepër kam ndejë vetëm në klasë ose me shërbyesen. Dje isha ma e qeshun, e kam zor të ndryshoj tipin, po diçka do ta ndryshoj se edhe mue nuk më pëlqen tipi im, tjerët e marrin për të keq siç të thanë ty, gazetarit, shoku i yt.

Dikur kur ishe në Tiranë, në vitin e dytë e të tretë, kur më ngacmonte ndonji rrugës kishe nji dëshirë të madhe t'i binja shpullë dhe edhe tashti e kam këtë dëshirë t'i binja atij bufit. Mirë që nuk e kam këtë simestër në shkollë se do e shanja në sy të gjithëve në drejtorì, tue mos qenë e sigurtë a e ka thanë apo jo. Ti më njeh ma mirë se të gjithë, s'ke pse të bahesh xheloz. Më kujtohet e shtundja kur erdhe dhe u çuditshe me hovin tend të asaj nate.

I dashtun, nuk di çfarë të shkruej, ti ishe në Shkodër dhe s'kam çka të tregoj. Me dy letrat tueja, morëm edhe dy letra nga Xhelali që i kishte shkrue para nji mueji; asht mërzitë shumë i shkreti. Mos harro porositë e mija, edhe kostumin qepe, se pranvera erdhi, deri për dasëm do qepësh edhe nji tjetër, kur të marrësh lekët nga libri.

Në Shkodër fryen erë e ftohtë, si duket "plakat" duen të çfaqin revoltën e tyne ndaj stinës së re, ndaj freskisë së vajzave të reja, duen t'i shëmtojnë edhe disa ditë me ngjyrën e verdhë ("plakat" janë ditët e ftohta të marsit, megjithëse kanë edhe disa ditë që të vijnë).

Për fotografinë a bane gja, a e smadhove. Mos harro të më bajsh edhe mue një kopje. Gjithashtu, mos harro për ato tri fotografitë që të kam dhanë.

Meqenëse trunin e ke të kurdisur, mos harro ta çkurdisësh, se do të mbesë gjithëmonë i çkurdisun, do të zëmrohet me ty dhe s'do të ndëgjojë të kurdiset ma vonë kur ti nuk kujdesesh për atë. Kur të vi unë do të kesh të reja të tjera që do të kurdisin trunin tand pjellor. Ulu dhe shkruej i dashtun tashti, sa ke kohë të lirë, se ma vonë nuk do të le unë kohë të lirë.

Të puth shumë,
Sadija

[13.III.1965]

E dashur Sadije,

Ç'thua moj! Për hir të një llafazani ti duhet të bëhesh e egër dhe e pashoqërueshme? Ajo që je duhet të jesh gjithnjë. Nuk të kam thënë kurrë që të ndryshosh. Në letrën që sapo e mora ti shkruanje se të hënën ke ndenjur vetëm me shërbyesen dhe në klasë vetëm. Na ruajtë zoti nga një sjellje e tillë!

Fotografinë e shpura në laboratorin tonë. Më thanë se mund të zmadhohet. Nesër a pasnesër e marr. Do të të bëj edhe një kopje ty.

Këtë letër po ta shkruaj në redaksi. E kam lënë përgjysëm një artikull e po merrem me ty. Dua të mendoj vetëm për ty sot, po më presin mendimet këta fishekët këtej nëpër zyrat.

E dashur, më ka marrë malli prapë për ty. Si t'ia bëj kësaj rrugës, që është e gjatë! Sa t'i marr honoraret e librit dua të të bëj ty një peshqesh. Do ta zgjedh vetë sipas gustos sime të trashë.

Më janë zemëruar ata të redaksisë së "Dritës" e "Nëndorit" që i kam kritikuar në artikullin tim "Duke kërkuar të bukurën"[1]. E quajnë vrejtjen time të padrejtë dhe pregatiten të më "japin një përgjigje të merituar".

Shqyrtimet për transferimet, e kam fjalën për Xhelalin, do t'i marrin aty nga prilli. Atëherë më thanë në ministri t'ua kujtoj.

Kam marrë një libër me tregime të Folknerit dhe po e lexoj. Dua edhe unë të shkruaj diçka të gjatë e serioze, po nuk më lenë andrallat e gazetës. Jam ngaherë me nerva të ngrehura, megjithëse unë nuk shquhem për nervozizëm.

[1] *"Duke kërkuar të bukurën"*: Artikull i botuar në "Zëri i popullit", 11 mars 1965.

Ti je mirë, besoj. Pse mos jesh mirë? Ti ke një njeri që të do kaq shumë, apo jo?

Të puth fort,
Dritëro

[14.III.1965]

I dashtuni im,

Si po e kalon këtë të dielë, mërzitesh apo shkon me shokë nëpër kafene?

Unë jam në shtëpi. Mbramë hyna në kinema dhe u kënaqa me nji film të botës së peshqve. Ishin 4 udhëtarë francezë që bajnë për 3 vjet një xhiro rreth botës. Më pëlqente guximi i tyne që edhe me peshkaqenin luftojnë. Ishte kaq interesant, Dritëro. Në shumë vende të qytetit tonë nuk kishte dritë, vetëm qendra kishte, mbasi po baheshin prova për tensionin e naltë. Me qiri hangrëm darkën me Didin, të gjithë ishin fjetë. Sikur të ishe ti në Shkodër do rrinim deri vonë dhe nuk e merrte kush vesht, se kudo errësinë dhe vetëm hana ndriçonte. Ishte kaq bukur, por vetëm nji çikë fresk.

Dritëro, harrova të them mbramë në telefon a mund të më gjesh 1400 lekë valutë se due të ble nji kostum banjoje unë e Lili.

Gjithashtu, më porosit një çantë të bardhë të madhe në Tiranë, thueji ose Elenës së Ismailit ose Elenës Havale se ato e dijnë ku porositen. Më lajmëro për të dyja këto.

Mundohu të vijsh me Viton që ta njohim me L. Tregoja dhe fotografitë. Do t'i pëlqejë pa tjetër se asht vajzë e mirë dhe më duket se do të kombinojnë bashkë. Unë u gëzova shumë mbramë kur më the se janë nda, megjithëse kjo nuk asht nji gja e mirë të kënaqesh me fatkeqësinë e tjetrit.

Po të tregoj tashti historinë e artikullit tand para se të përfundoj letrën. Unë nuk e kishe lexue artikullin në shtëpi. Nisem për shkollë dhe më takon i shoqi Anës dhe më thotë: mos dërgo jastekë paje se s'do t'i pranojë Dritëroi dhe iku. Në shkollë Mahmuti me drejtorin më treguen artikullin. I kishte pëlqye shumë të dyve dhe me të vërtetë kishe kapë

një temë të randësishme. Tue diskutue me Mahmutin dolën prej stufës nji grumbull shkëndijash dhe m'u dogjën çorapet; kështu e pësuen të gjorat. Më fali Mehdia 500 lekë dhe bleva të nesërmen nji palë të reja, po kanë nji ngjyrë mizerje. Ma mirë me ato se pa gja krejt. Bashkë me artikullin tand u banë histori në shkollë edhe çorapet e mija, se më vinte shumë inat. Kjo nuk ka randësi.

Të puth shumë,
Sadija

[4.IV.1965]

I dashtuni im,

Tashti e ndjej thellë këtë fjalë. Më ka marrë malli shumë për ty, do dëshëronja që të isha pranë teje dhe të korigjonja hartimet. Shanset për të ardhë në Tiranë me 11 janë të mëdha. Do të vijmë me Didin të dielën dhe do të kthehemi të hanën mbasdreke. Do t'i humbi 3 orë, por do i marr leje dy drejtorave. Ti do jesh i zhytun në punë. Çdo ditë e lexoj gazetën me shpresë se mos shoh të paktën emnin tand, se mos flas me ty nëpërmjet gazetës. I dashtun, unë e ndjej fajtore vehten ndaj teje, nuk sillem ashtu si e ndjej. Kjo rrjedh ndofta nga që e di se ti ma plotëson çdo dëshirë, por tash e mbrapa nuk do të sillem ashtu. Ky dreq stilografi më asht prishë dhe memzi që shkruej.

Të lashë pak ty i dashtun, se u mora me marinarët për të cilët flitje me shumë simpati. Gjithmonë shkruen mirë dhe nuk të mërzit.

Pse nuk shkruen edhe shënime kritike, nuk je i keq kur shkruen, prandaj merru me ato.

Dritëro, ç'na thue ndonji gja të re nga Tirana? A takove ndonjenën nga Elenat? Sikur të takojsh kapitenin e anijes thueji ma mirë për nji kostum banje se këtu në Shkodër nuk po gjej, mundësisht të zi me një kordon të bardhë përqark, thueji, gomet dhe jo najlon, po fundi çfarëdo, se po afrojnë ditët, ndërsa unë nuk kam kostum banjo.

Nuk po më lejnë ta shkruej rehat këtë letër këto fëmijtë e motrave. Sa nervoz bahem kur fillojnë të qajnë apo të bajnë zhurmë, nuk i duroj.

Mirë që tek ti asht qetësi.

Po të dërgoj nji fotografi të klasës sime të natës. Do të mallëngjehesh shumë kur ta shohësh.

Për Xhelalin mos harro. Viton dje e pashë në kabinë të një kamioni. Lilit të gjorë i pëlqeu shumë.

Po e përfundoj letrën, se po shkoj ta ndihmoj nanën, që asht tue la teshat[1] poshtë.

Të puth,
Sadija

[1] *Teshat*: Veshjet, rrobat.

[8.IV.1965]

E dashur Sadije,

Një javë s'ka kaluar që atëherë që isha tek ti, po kam shumë mall për ty. Xhexheja më foli për udhëtimin e saj në Shkodër, më tregoi për ty e për të gjitha. Nuk i dhashë dot ndonjë letër, sepse nuk ma preu mendja që të vinte drejt e në shtëpi, megjithëse më tha. Sot dua të shkruaj ndonjë nga ato shkrimet që kam në plan lidhur me udhëtimin tim të famshëm.

Isha nga Ismaili për të uruar për çupkën[1]. I shpura edhe një lodër, po në vënd që të lozë çupka me atë, do të lozë e ëma se është për të mëdhenj, siç duket.

Unë të pres të vish të djelën, sipas letrave të tua dhe çka i kishe thënë Xhexhesë. Me ty unë nuk jam zëmëruar fare, po atë ditë që u nisa nga Shkodra, më dhëmte shumë koka.

Çantën do ta porosit më datën 14 prill dhe pas 5-6 ditëve do ta marr. Do të shkoj me Elenën për ta porositur. Kur të vete në Durrës do të takoj heronjtë e mij, detarët dhe do t'u lutem të më sjellin për ty një kostum banje. Besoj se kaq gjë do ta bëjnë. Unë i kisha lavdëruar.

Kostumin tim së shpejti e marr dhe ti një ditë do të më shohësh me të në Shkodër (sikur kjo ka rëndësi!!!).

Ti do të rregullohesh këtu në Tiranë me punë. Po përpiqem të jesh në një shkollë pranë shtëpisë, që në mëngjes mos ngrihesh shpejt, se je e vogël dhe duhet të rritesh (ti e di që gjumi i rrit të vegjlit).

Tani të puth fort,
Dritëro

[1] *Çupkën*: Vajza e madhe e Ismail Kadaresë, Gresa.

[15.IV.1965]

I dashtuni miku im,

Sot jam pak e sëmurë dhe s'kam shkue as paradreke në shkollë, as mbasdreke. I lajmënova me Mehdinë. Mirë që kam nanën kaq të kujdesëshme dhe sikur ma largon pak me shërbimet që më ban vazhdimisht. Sot kishe pak ethe, se me mbuloi me dy jorgana dhe shikë uji[1] dhe kisha të ftohtë. Piva konjak dhe ai sikur më ngrohu e më ka hedhë në gjumë 3-4 orë. Tashti jam ma mirë, mos u ban merak, gjana që kalojnë janë këto. Nana ma ka merakun kur të vi në Tiranë dhe kur të lindi. "Ti kaq e s'duron, po ma vonë ishalla bahesh ma e fortë".

Dritëro, gjithë këto kohë kam qenë kaq e mërzitun, nuk di as unë. Po e shuej radion, se asht nji muzikë, që të shton trishtimin.

Ti do të çuditesh se ke kaq kohë që s'ke marrë letër. Të kam shkrue, por nuk t'i kam postue nga që nuk donja të të mërzitnja ty. Kam jetue një javë të tanë me gëzimin se do të vinja në Tiranë, se do të flenja në nji dhomë, ku do t'na ndante vetëm nji mur. Sa andrra thurrshe nji javë dhe këto u fikën për nji orë kur mora vesht se nuk ka biljeta. Unë kam nji dreq koke që nuk i lutem askujt të më plotësojnë dëshirën, as ty i dashtun nuk do të lutesha shumë për nji gja, por do t'u zëmrojshe. Kështu jam zëmrue me Didin dhe nuk i flas, megjithëse ai vjen çdo natë të më marrë në shkollë. Tashti më vjen zor prej tij, ai dy-tre herë më ka folë, bile e kishe kështillue që të mos takonte as ty në Tiranë.

I dashtun, kur do të vijsh në Shkodër. Më ka marrë malli shumë. Gjej ndonji rast tjetër. Libri[2] të ka dalë shumë simpatik, po ato dy të fundit ma mirë të mos i kishe shtue, se janë ma tepër reportazhe me numra e shifra.

[1] *Shikë*: Borsë me ujë të nxehtë, fjalë dialektore.

[2] *Libri*: Bëhet fjalë për vëllimin me tregime "Zhurmat e erërave të dikurshme", i cili në Plenumin e XV të KQ të PPSH u kritikua rreptë dhe iu ndalua qarkullimi.

Të shohim tashma kritikat, i presim me gota konjaku. Piva me Verin nji gotë konjaku, ishte tek unë. Mirë që kam shoqëninë dhe ma largon mërzinë, herë vjen Veri, herë Luigjina me Lilin.

Luigjina më thotë që vajzën ta quej me emnin e saj dhe se ka me qenë e bukur. Ç'budallallëqe bisedojmë. Ishe nji ditë paradreke nga ajo për vizitë. Gjeta dy pleq, po bisedonin për histori, periudhën e Skënderbeut. Nuk u korita si vajzë e re me diplomë. Më shpëtoj historia që spjegoj dhe fillova të baj muhabet me ato, se Luigjina nuk ishte.

Veç të më shihnje tue ba muhabet me to, do të qeshnje. Ata dinin gjuhë të hueja dhe i kisha zili. Njeni prej tyne mësonte Luigjinën italisht. Të kishe kohë të lirë kisha shkue edhe unë me mësue, po sa të mbaroj këto orët paradreke do të filloj edhe unë me sulm, të ta kaloj ty në frëngjisht.

Viton a e ke takue, a keni ba muhabet. Ajo Lili asht shumë e bukur, e shoh çdo herë dhe më duket kaq e mirë. Do ta ndihmoj në letërsi, se ka me dhanë provim. I kanë mbetë vetëm provimet e maturës pa dhanë.

Dritëro, po blej kostumin e banjos në valutë, kështu që nëse i thue mikut tand thueji kostum të ndamë, të bukur amá.

Më duket se të paska dalë libri në Shkodër. Po më thotë kjo motra e vogël, po nuk i besoj kësaj se e ka pa në shtëpi dhe më gënjen. Elenës i kam shkrue letër. Çfarë dhurate i ke çue, mor fishek?

Në Shkodër bie shi i mërzitshëm. Ti kur do të vijsh?

Të puth fort,
Sadija

P.S. *Harrova të pyes për Xhelalin, a ke folë? Mos e len në harresë, ma mbaro këtë lutje, se nuk do të mërzis ma.*

Të puth,
Sadija

Shkodër [20.IV.1965]

I dashtun,

Gjithë këtë kohë e kam mendjen tek ti. Më ka dalë gjumi qysh në orën 5.10 të mëngjesit nga një vetëtimë e tmerrshme dhe bubullimë që tronditi gjithë shtëpinë. Menjiherë më shkoi mendja tek ti. Me se do të niset? Me motoçikletë asht gomarllëk ta mendoj, se s'ke luejtë mënç. Nga vetëtima neve na u dogj radjoja, megjithëse nuk e kishim të ndezun.

Gjithë këtë tersllëk shiu e ka prue ai Thimi i pllakave, po ti mos i thuej se na zëmrohet burri i botës. Kot nuk të thashë që kur të arrinje, të më baje nji telegram, sa të më hiqje merakun. Ty pa të porositë nuk të shkon mendja për asgja. Por duhet të kesh arritë mirë se nuk kam asnji parandjenjë të keqe në zemër.

Unë sot s'kam dalë hiç, korrigjova disa detyra e hartime dhe tashti po merrem me ty. Sa të due mor fishek, sa nuk di me ta tregue. Ma mirë që takohemi në krye dy-tri javëve se kështu të paktën i kuptojmë ndjenjat tona. Ti më qorton që s'të kam shkrue letra, po as ti s'më ke shkrue ma shumë, barazi jemi. Ti më pritnje se po vi në Tiranë, edhe unë mendonja se po takohem me ty.

Po tashti e kemi të qartë të dy se për tri javë nuk takohemi kështu që t'i shkruejmë njeni-tjetrit pa justifikime të kota.

Janë letrat e fundit e kupton, s'do kemi nevojë ma për letra se do të merremi vesht tue qenë pranë dhe jo nëpërmjet postjerit shkodran e tiranas. Veç ndonjiherë kur të grindemi do të pajtohemi me anë letrash.

Sot jemi më 20 prill, edhe 2 muej e dy javë kanë mbetë që të jemi të ndamë. Edhe 3 herë nga dy-tre ditë do të takohemi kështu, mandej ... e di vetë ti.

Mendo për dasëm, mos mendo shumë me ardhë, dasëm pa mish dhe lekë nuk ka. Ti je fishek, s'mendon fare. Do të

bashkohen të gjitha bashkë dhe s'do të dijsh nga ta fillojsh. Pa pashaportizim s'ka emnim pune, prandaj më dërgo fjalë sa ma shpejt çfarë duhen si dokumenta për lutje, mos i len mbas dore. Prilli po mbaron, pra dhe për Xhelalin mos harro, gjej kohë të lirë, se nuk të bahet kjameti. E di se punë do të kesh shumë, por ç'të bajsh. Sot nji vjetë për 1 Maj do më shohësh tue parakalue edhe mue me nxanësit[1], do më tundësh dorën, mor fishek, do të shkruejsh ma me entuziazëm.

Mjaft porosi të kam dhanë, mbes me shpresë se do m'i kryejsh, o "portret i njeriut të madh"[2]. A ta mban të shkojsh esëll me ble ato që donje t'i merrnje mbramë në atë dyqanin që pamë.

Je një çikë i paturpshëm.

Të fala kush të pyesi për mue.

Të puth fort, jo si tek gjyshja.

Sadija yte.

[1] *Tue parakalue*: Në paradën tradicionale të 1 Majit.

[2] *"Portret i një njeriu të madh"*: Si në titullin e njërit prej tregimeve të librit "Zhurma e erërave të dikurshme".

[23.IV.65]

E dashur Sadije,

Atë ditë as unë nuk e di se si kemi ikur. Aq ftohtë ishte, aq erë frynte, sa për pak u thamë mbi motor. Unë provova të ngrohesha, duke përdorur disa lëngra "djallëzorë", po ishte e kotë se duhej pirë një shishe e tërë për të bërë efekt. E megjithatë erdhëm mirë. Pastaj mua më ngrohte fryma jote. Nuk u pendova që ika atë ditë në të ftohtë, se ndenja edhe një ditë pranë teje.

Ia dhashë Elenës paret për çantë dhe i thashë ta porositë. Së shpejti duhet të bëhet dhe do të ta sjell. Në ministri do shkoj të hënën dhe kam shpresa se do të mbaroj punë (e kam fjalën për Xhelalin).

Letrën tënde e mora sot dhe u gëzova shumë. Prapë më ka marrë malli, po kam një parandjenjë që ti mund të vijsh për 1 Maj në Tiranë.

Gjyshes të fala,

Ty të puth shumë, shumë,
Dritëro

[29.IV.1965]

E dashura Sadija ime,

Kam bërë një udhëtim shumë të bukur. Udhës kemi qëndruar e kemi pirë kafe e cigare. Mua më vinin mëntë tek ti e thosha me vehte: "E gjora, mos sëmuret dhe mos i hipë temperatura në mbrëmje". Me të vërtetë mund të të hipë temperatura. Ti qëndrove shumë në erë me mua. Do të kem shumë merak gjersa mos marr lajm nga ti që je mirë.

Në Fushë-Krujë shkuam në teqe. Ishte një vend i bukur. Unë dola në fotografi me një dervish me mjekër të gjatë. Patjetër do të ta dërgoj kur ta shtampos. (Donja të hanja drekë me dervishët, po kuzhinieri-dervish ishte pis e kishte thonj me baltë).

Sa erdha në shtëpi fjeta dhe u ngrita vetëm në orën shtatë.

E takova Lenën e Ismailit nga klubi e më pyeti shumë për ty. Ajo mendonte se ti do të vinje për 1 Maj, por unë i thashë që mendime të tilla janë të kota.

Tregimet po m'i shajnë shumë[1]. Po unë jam mjaft gjakftohtë, aq gjakftohtë nuk është edhe një zhapi!

Vezët Luigjina nuk i ka sjellë gjer tani. Duhet të ketë patur drojtje. Mua do të më pëlqenin, se jam një vezëngrënës i çquar.

Mos u mërzit, unë do të vij shpesh tek ti e do të të puth shumë jo si këtë radhë.

Edhe një herë të puth fort,
Dritëro

[1] *Tregimet*: Bëhet fjalë për vëllimin "Zhurma e erërave të dikurshme".

E dashur Sadije,

Jam bërë shumë merak për ty. Nuk di se si je me shëndet. Kur isha unë atje ti ishe pa qef. Unë nuk kam qënë aq mirë. Mërzia më ka dërmuar pa masë. Kam patur mall të madh për ty. Edhe 1 Majin e bëra pa ty, edhe vitin e ri gjithashtu pa ty. Mirë që mbetën edhe dy muaj gjersa të vish përgjithnjë tek unë.

E dashur Sadije, unë nesër a pasnesër nisem me shërbim ose në Gjirokastër ose në Tepelenë. Kam frikë se vallë do të vij më 16 maj në Shkodër, ndërsa malli më ka marrë shumë.

M'i dërgo ato shkresat që të porosita kur isha në Shkodër.

Po të çoj një fotografi me mikun tim Dervish Alinë në teqe të Fushë-Krujës.

Të gjithëve të fala,

Ty të puth shumë,
Dritëro

[5.V.1965]

E dashur Sadije,

Biletën e kam me vehte. Nesër nisem për në Gjirokastër. Kthehem në Tiranë pas 10 ditëve. Bëra mirë që po ik, që të harrohen disa skandale që kam kryer pas nja dy pijesh homerike më 30 prill e 1 Maj. E di që do të të bjerë humori, po me që me të vërtetë kam pirë, nuk dua të ta fsheh, e dashur. Burri yt kështu e ka ndonjëherë: rri, rri dhe i jep një dërmë tronditëse trurit të vet të sëmurë! Po mos u dëshpëro, kur të të kem ty pranë nuk do kem nevojë për këto "tronditje". Kam qënë shumë i dëshpëruar dhe kam patur shumë nevojë për ty. Krejt i vetmuar kam qënë. Kushedi sa tavolina kam goditur me grusht. Pastaj unë të kam dërguar tri letra, kurse ti asnjë. Merak të madh kam patur: U shërua kjo e bekuar, apo jo, kam pyetur vehten. Si e pashë që ti nuk përgjigjeshe të mora në telefon. Atëherë u qetësova.

E dashur, ky udhëtim do të jetë i gjatë: Gjirokastër, Memaliaj, Tepelenë. Po ty gjithnjë do të të kem me vehte. Pirje homerike nuk do të bëj, të jesh e sigurtë.

Kur të vij në Tiranë, me siguri do të gjej letrat e tua të dashura.

Të fala të gjithëve edhe nënës edhe Qerimit.

Të puth shumë shumë para se të hyp në autobus.

Dritëro

Memaliaj, [11.V.1965]

E dashur Sadije,

Ka shumë kohë që nuk të kam parë. Gjatë kësaj kohe kam udhëtuar, jam zënë me njerëz, kam qënë i mërzitur. Ehu, ç'ka ndodhur! Po ta shkruaj këtë letër nga një klub i Memaliajt, që ti jo vetëm që nuk e ke parë, po as që e ke marrë me mend ndonjëherë. Edhe letër për të të shkruar ty nuk do të kisha, sikur mos më kish dhënë një librar-antikuar në Gjirokastër para dy-tri orëve se të nisesha për në Memaliaj.

Mua më duket sikur ka një vit që nuk të kam parë. Edhe fytyra jote më duket tjetër. Më shumë mbaj mënd ato ditët e korrikut të 1964-ës, kur u nisa për në Korçë; të mbaj mend edhe ty kur të lashë vetëm. Ç'barbar kam qënë! Apo jo?

E dashur, mos i verë re budallallëqet e mija. Mos e verë re edhe atë pak që të shkruaj. Nuk mbeti shumë për të shkruar. Edhe një muaj e gjysëm ka mbetur gjer atëherë, kur unë nuk do të kem nevojë për të të shkruar ty.

Sot u nisa nga Gjirokastra në Memaliaj. Më përcuall ca shokë të ngushtë. Vetë ata ma prenë biletën. U bënë gati më të qarë kur më nisën. Më thanë që të kthehem prapë. Nuk e di do kthehem apo jo në Gjirokastër (natyrisht nga andej do të vij në Tiranë). Bëra një takim (si shkrimtar) me oficerët e Gjirokastrës. Sa njerëz të mirë! U mblodhën të gjithë e dëgjonin fjalë për letërsinë. Fola sinqerisht, po më mirë duhet të pregatitesha. Ata bënë shumë pyetje. Mendova se mos bënin ndonjë pyetje intime (për ty). Të tilla pyetje parashikoj në takimin me nxënësit e gjimnazit dhe pedagogjikes së Gjirokastrës. Janë shumë çapkënë.

Nuk e di kur do vij në Shkodër. Dua të vij sa më shpejt. Edhe dasmën nuk e di si do ta bëjmë. Dy vënde për në verë kam siguruar: në Vlorë e Pogradec. Në Durrës kam shumë

shpresa. Më mirë në Durrës se harxhime nuk do të ketë, po të jetë fletë-kampi[1]. Ti mos u mërzit. Të gjitha vijnë në vijë. Unë, me gjithë marrëzirat e mija që kam bërë, jam i fortë dhe i dashuruar me ty si një gjimnazist (sa herë ta kam thënë! Боже мой![2]).

Kur të takohemi do të të them shumë aventura qesharake.

Të puth shumë, shumë,

Yti,
Dritëro

[1] *Fletë-kampi*: Kështu quhej dokumenti që i jepej një punonjësi nga institucioni apo ndërmarrja për të kaluar pushimet verore në ndërtesa shtetërore, që quheshin kampe të punëtorëve, të pionierëve, të oficerëve, kundrejt një pagese të pjesshme.

[2] Боже мой*!:* Nga rus., O Zot!

[19.V.1965]

E dashur Sadije,

Unë prapë jam i lumtur. Ne me të vërtetë e duam kaq shumë njëri-tjetrin. Ne nuk e kuptojmë, po të gjitha këto çqetësime janë vetëm nga dashuria e madhe. Nuk ka dashuri të mirë pa çqetësime e zemërime. Këto e bëjnë të bukur dashurinë. Unë nuk nisem kurrë nga frikë për të mos të humbur ty, po nga dhëmbja e tmerrshme se të dua si djalli. Ti ndofta nuk e kupton shumë e nuk e ndjen shumë, se unë jam një surrat pekmes që nuk e çfaq aq fort. Sikur mos të të marr ty unë, do të mos martohem gjer të vdes, sikur ta di se do të shkoj në pleqëri në azilen e pleqve! Po ti nga unë s'ke ku të shkosh sikur kushedi ç'të bëhet.

Pas kaq kohe mua prapë më erdhi humori. Ne muarëm nga një kafe në Vollga me Didin. Mua nuk m'u durua, e lexova letrën dhe e preva fare frymën. Ai ndofta do të jetë çuditur. Unë isha krejt i dhënë pas teje, krejt i emocionuar, nuk shihnja as njeri dhe as tavolinë. Zgjata dorën në filxhan dhe në vend që ta zinja në vegël e futa gishtin brenda në kafe. Sa më ke frikësuar ti mua! Unë e njoh karakterin e sedrën tënde. E thosha me vehte: kjo po tha, edhe mund ta bëjë … Dreqi!

Unë jam dobësuar fare, po do përpiqem prapë të shëndoshem. Kam humbur pesë qile.

Nuk ka në botë më të mirë se ty, ti mua gjithnjë më trondit. Sa herë që më venë mëntë tek ti, unë pushtohem nga një dridhje e pakuptueshme e nga një mall i madh. E atëherë të gjitha preokupacionet e andrallat i braktis. Prandaj letra jote e rreptë bëri një efekt të padëgjuar e të paparë tek unë. Mua më vinte inat edhe me vehten: pse Sadija nuk e ka vënë re e nuk e ka ndjerë që unë atë e dua më shumë se jetën.

Unë do vij e të gjitha keqkuptimet do mbeten pas, të gjitha do t'i mbulojnë të puthurat. Unë do të të puth në hundë, në sy, në buzë, në qafë. Nuk do le vënd pa të puthur. E mos ma përsërit edhe njëherë që pak të dua, mos ma përsërit se fyen më parë vehten pastaj të dashurin e burrin tënd. Si mos të të dua unë ty! Ç'flet ti!

Të puth si asnjëherë tjetër,
Dritëro

[25.V.1965]

E dashur Sadije,

Me të vërtetë kam bërë shumë mirë që kam erdhur tek ti. Jam kaq mirë tani! E kuptoj që qënka shumë vështirë dhe hidhur të rrish i dëshpëruar me një njeri që e do pamasë. Sa mirë e ndjej vehten kur jam me ty. Nuk çmallem duke të vështruar. "Ç'më shikon, ç'më shikon", thua ti.

Me të ardhur u mora me shkresat e pashaportizimit tënd. Më ka mbetur pa e plotësuar vetëm njerën. Nesër do t'i çoj në komitetin ekzekutiv[1]. Dua t'i mbaroj sa më shpejt, që të merrem me preokupacionet e tjera të dasmës e të pushimeve.

Në shtëpi gjeta Nazimenë[2] me fëmijët. Ajo më pyeti për ty e tha si s'të ka parë asnjëherë. Do ta shohësh, i thashë së shpejti.

Mbrëmë nuk shkova asgjëkundi. Kam lexuar e kam fjetur. Tërë natën të kam parë ty në ëndërr, të kam parë mirë-mirë.

Te Luigjina do të shkoj nesër para dite. Do të shkonja sot, po jam dezhurn.

Ka shumë mundësi të vij prapë të shtunën. Kam një dëshirë të madhe të jem përsëri pranë teje.

Mua tani më shumë më preokupon plazhi se sa dasma. Po përpiqem me çdo mënyrë që 21 ditë ne të dy të shkojmë në plazh. Edhe sikur fletë-kampi mos gjejmë, do shkojmë në hotel. Hoteli për 12 ditë me ushqim e fjetje për dy veta kushton 8.000 lekë (me abonim). Për 21 ditë nuk e dij. Të gjitha do t'i rregulloj. Vetëm me 4 korrik duhet patjetër të bëhet dasma, pasi leja ime fillon më 1 korrik e mbaron më 30. Kupton?

Tani të puth shumë, shumë,
Dritëro

[1] *Komiteti ekzekutiv*: Institucioni më i lartë i qeverisjes vendore dikur.
[2] *Nazimeja*: Motra e Dritëroit.

I dashtun Dritëro,

Dy letra të kam shkrue dhe nuk t'i kam postue nga pakujdesia. Tashti i lexova dhe më duken gjana të vjetrueme, prandaj nuk t'i postova. Përsëri kam fillue të vi në formë, se s'kishe as gjumë, as oreks. Gjithë këto nga shqetësime të vogla që kam pasë dhe m'i cingridhnin nervat. Kam qenë shumë nervoze, por shyqyr që kaloj, jo si në njiherë në muej. Këto dreq zakonesh duhet t'i respektoj pak a shumë në Shkodër dhe kjo më mërzit. Ti, as Xhexheja të mos mendoni për petk nusërije, se do gjej vetë në Shkodër, sido që të jetë. E kanë për turp të mos vishem se vetëm vajzat e shkueme nga mosha dhe gratë e vea nuk vishen, prandaj s'duhet t'ja prishi qejfin. Zakoni e lyp ta bijë burri, po meqë ti je kundër zakoneve shkodrane nuk due që të bezdisë.

Mor i shkretë, sa zakone ke lanë ti mbas dore, sa do të tmerroheshe t'i plotësonje. Ndofta do të mbeteshe pa u martue fare, sikur t'i respektojshe këto.

Po t'i them tashti që asht fundi vetëm sa për kuriozitet dhe jo për gja tjetër. Burri duhet t'i pregadisë grues dhunti, si thuhet këndej nga ne. Në dhunti bajnë pjesë këto gjana: zakonisht ato që janë me gjendje të mirë si të quejnë ty, tri palë këpucë, nji palë sandale, nji pardesy, një pallto, nji kostum stofi, tre fustane stofi, tre fustane të mira vere, triko, unazë, sahat.

Merre me mend mor i gjori ti; s'do të martoheshe kurrë se s'do të ishje në gjendje me e pregaditë për pesë vjetë e ma shumë. Ty s'të rrijnë lekë në xhep dhe jo të blejsh këto sende. Qerimi nuk e din se ti nuk bjen asgja, kështu që nana (kësaj i kam tregue) do i thotë që ma ke lanë "dhuntinë"[1] në Tiranë. Duhet ta dijsh se për këtë jam grindë sa herë në shtëpi

[1] *Dhunti*: Kështu quheshin dhuratat dhe shenjat e domosdoshme që burri duhej t'i sillte gruas kur kurorëzoheshin.

me nanën ose me motrat që ma përmendnin. Tashti jam e gëzueme që ato s'kanë muejtë të më përulin sa unë të thoshnja ty zakonin e dhuntisë. Kështu e ndjej vehten të lidhun me ty vetëm nga dashunia dhe jo nga rrobat. Kryenaltësia s'më lejonte që të thoshnja asnji fjalë.

Më 4 korrik martohet edhe vajza e tezes. Kam shumë inat se asaj i shkon dhunti dhe kushurinjtë do i shesin nanës mend. Ajo e ka plagë këtë dhe do të vuejë. Për këtë më vjen keq. Edhe ai gazetari F. Dibra i bjen dhunti dhe sa herë nana ma ka sjellë si shembull. Po unë i thoshnja: ku ai e ku Dritëroj.

Tashti jam e qetë, s'kam ma shqetësime. Ah, sikur të ishim martue vjet, s'do të preokupohesha as unë, as këto të shtëpisë. Sa harxhime kanë pasë i dashtun, mirë që mbaroj.

Xhelali besoj që vjen me 23 qershor, kështu që jemi në rregull. Për plazh e dasëm mendo si të duesh, nuk due të hy edhe andej në andralla.

Nëse nuk ke të holla mos ban dasëm, edhe në plazh nuk shkojmë sa të hyjmë në borxhe, që s'më pëlqejnë. Mehdia kur të shkojë ushtar, do ta mbaj unë. Këtë barrë do t'ja heq shtëpisë. Ti s'ke arsye që të më ndalojsh, se për nji vjetë që ndejta unë, shtëpinë nuk e ndihmova po përkundrazi. Nana thotë e kishim për detyrë. Nejse edhe kjo letër doli e mërzitëshme si ato të tjerat, por do ta postoj se qyshkur s'të kam dërguar letër.

Me Ismailin e Dalanin[1] a u pajtove?

Të puth fort e fort,

Sadija

Kur do të vijsh? Vetëm dy letra kam marrë, sigurisht ke punë. Malli më ka marrë.

S.

[1] Ismail Kadare dhe Dalan Shapllo.

[28.V.1965]

E dashur Sadije,

Tani nuk na mbetën për të shkruar edhe shumë letra, e dashur. Më në fund, ai vit, që dukej aq i gjatë, mbaroi. Për pak ditë ti vjen tek unë për të mos ikur kurrë. E megjithëse ne të dy e njohim mirë njëri-tjetrin dhe pak a shumë e dijmë, si do të shkojë jeta jonë, prapë së prapi diçka e panjohur, interesante dhe e bukur do të na hapet para syve. Unë eci tani nëpër dhomë i menduar, duke pirë cigare, e them me vehte: edhe një muaj e këtu do të ndjehet fryma e dashur e një njeriu tjetër të mirë e të bukur! Nuk e merr me mënd ti se si të pres të vish! Sa dua unë që ti të jesh e lumtur, që të mos vuash nga ftohtësia shpirtërore. Edhe unë dua të jem i lumtur. Unë e di që ti mua do më bësh të lumtur (Bile kot them se do më bësh, ti më ke bërë).

Sot mora një letër nga ti. Gjithnjë i dua letrat e tua. Gëzohem si çilimi, krejt si çilimi. Edhe ti e ke vënë re që unë kur jam pranë teje gëzohem si çilimi. Apo jo?

Shkova në spital. Kish rënë një epidemi gripi dhe nuk më lanë të hynja. Ia dhashë letrën dhe ca qershi një shokut tonë që ishte shtruar në pavionin nr. 4, për t'ia shpënë. E prita Luigjinën të delte, nuk dolli. Siç duket do ketë qënë në gjumë dhe ai shoku nuk ka dashur ta zgjojë. Ika pastaj.

Ti më kishe telefonuar njëherë, po unë kisha një takim me lexuesit në pallatin e kulturës "Ali Kelmendi", ku diskutohej libri im. Kam ndenjur atje tri orë. Kishte shumë diskutime të zjarrta dhe mund të zgjatej një ditë të tërë diskutimi. Pavarësisht nga vlerësimi - i drejtë apo i padrejtë - mua m'u bë qejfi shumë se pati mjaft polemikë. Më bëri përshtypje se një shofer sa po kish ardhur nga udhëtimi, hyri në sallë, ashtu siç ishte i lodhur nga udha; hyri dhe diskutoj. Tregimi "Kur

dashuronja një grua" u bombardua tmerrësisht. Mendimet për këtë tregim as përputheshin fare me njëri-tjetrin. Ndryshe thosh njëri, ndryshe tjetri.

Sa dëshironja të vinja nesër të shtunën tek ti! Nuk e kam vendosur, po ka të ngjarë të mos vij, e dashur.

Si t'u bë këmba? Mos vrapo, si e çkalluar. Të isha atje, do të të puthnja që të të shërohej shpejt.

Për fletë-kampi nëntëdhjetënëntë për qind do të gjej. Vëndin nuk e di se ku do të jetë: mundet në Durrës, mundet në Pogradec. Më mirë në Durrës.

E di sa më ka marrë malli? Tani sepse më merr më shumë malli se më parë. Pas asaj grindjes së vogël jam bërë i tillë. Të dua shumë, shumë.

Të puth fort, fort,
Dritëro

[1.VI.1965]

I dashtun Dritëro,

Të shkrova një letër tjetër po nuk di në cilin libër e kam shti, prandaj u detyrova të shkruej edhe sot. Prej teje kam marrë vetëm nji, megjithëse u banë dhjetë ditë. Si duket ke pasë shumë punë. Qysh se ke ikë ti, unë jam tue vuejtë nga pagjumësia. Bie në 12 ose 1 të mbramjes dhe më del gjumi shumë herët. Mbasdrekeve nuk fle hiç, mbasi nuk kam kohë. E ndjej vehten të lodhun dhe të vrame. Shpesh herë më dhemb edhe koka, si duket e ka fajin kjo kohë e keqe që po ban. Jam dobësue nji çikë, nuk e kuptoj se çfarë kam kështu. Po do të kalojë besoj, ti mos u ban merak. Dje më mori Luigjina për drekë. Ti nuk shkove asnjëherë andej nga spitali, për t'i ba nji vizitë. Megjithëse doli nga spitali nuk asht shërue. Ato kishin ble venë dhe piva një gotë shumë shpejt. Nji gjysmë gote e piva përnjiherësh mbas buke dhe si duket më ra në kokë. Në fillim nuk e ndjeva, po kur shkova në shkollë nuk ishe në gjendje me kujtue asgja, as emnat e nxanësve. Si ishe dje, veç të më shihje. Po kulmi ishte kjo, se kishte ardhë nji kontroll prej disa vetësh. As ditarin nuk e kishe ba. Më doli menjiherë pija nga frika, nuk i rashë në sy hiç inspektorëve. Unë s'do të pi kurrë, jam betue qysh dje. Si idiote jam ba. Po më ndihmoi zoti e shpëtova mirë pa ndonji vrejtje.

I dashtun, për plazh mirë ke mendue, do të shkojmë 12 ditë në hotel turizmi dhe nëse na teprojnë lektë do të shëtisim në qytete të ndryshme. Do të shkojmë edhe në Hoçisht tek Leni Havale, dhe nëse don edhe ti, shkojmë në Menkulas. I thashë Xhexhesë në telefon me më gjetë një petk[1] të bukur për martesë. Në opera janë të bukura, ato i japin me qira. Pyet ti,

[1] *Petk / pekt*: Fustani i bardhë i nusërisë. Forma "pekt" është lokale.

se shumicën i njeh. Nëse nuk gjeni më lajmëroni, se këndej e kanë shumë për turp që të mos vishem nuse. Në Shkodër vetëm vajzat e shkueme nga mosha dhe të vejat nuk vishen me pekt të bardhë, prandaj prindët e mi nuk e imagjinojnë që unë të mos vishem. Më lajmëro pa tjetër, pra, se duhet ta gjej unë çfarëdo këtu. Edhe mue më pëlqen të vishem, se njiherë në jetë ndodh kjo, nuk përsëritet. Çdo ditë më vijnë shoqe dhe s'më lejnë rehat të pregaditem.

Tashti do të shkoj në një dyqan mode të baj provë nji fustan. Jam tue i qepë të gjitha që kam dhe i provoj. Sa qejf asht kur ke shumë.

Kur do të vijsh?

Të puth shumë,
Sadija

Festa e fëmijve sot, uromë.

[2.VI.1965]

E dashur Sadije,

Po të shkruaj dy radhë se kam mall shumë për ty sot në mëngjes. Koha tani po kalon me vrap. Katër korriku po vjen; fleta e kampit po sigurohet. Mos bësh ndonjë punë e ta shtysh dasmën për 15 korrik, se të gjitha planet prishen. Dokumentet i shpura në komitet ekzekutiv e për tri javë ti pashaportizohesh këtu.

Takova Lena Havalen. E kishte marrë provimin. Para provimit, kur e takova, dridhej si shufër.

Duhet ta takoj edhe Lenën tjetër për ta pyetur për çantën tënde. Si shumë e vonoi.

Do të vij në Shkodër së shpejti. Mund të vij me shërbim. Këto janë takimet tona të fundit, në këtë mënyrë, në Shkodër. Mos u mërzit. Të dua shumë.

Të puth fort,
Dritëro

[14.VI.1965]

E dashur Sadije,

Para se të nisem për në Korçë po të shkruaj dy radhë. Jam i mbushur me mall për ty. Këto dy-tri javë më duken të gjata. Po mendoj me vehte se do të kalojnë shpejt, pasi unë jam në lëvizje. Kur të kthehem nga Korça nuk do ketë mbetur as një javë!

Sot kur po shkonja nga MAPO[1]-ja pashë në vitrinë kapela grash. Ishin italiane. M'u duknë shumë të bukura e mora një për ty. Ka ngjyrë të ëmbël të verdhë, po një të verdhë që të çlodh sytë. Një grua më tha se ajo ngjyrë shkon me kostum banje të kaltër. Tamam për kostumin tënd! Kur të vish ta shohësh do të të pëlqejë (kapelë kashte).

Gjer në Korçë është rrugë e gjatë. Gjithë rrugës do të mendoj për ty. Do të të marr me vehte në atë qytet të jugut.

Të puth fort,
Dritëro

[1] *MAPO*: Fjalë për fjalë, "magazinë popullore", njësi tregtare e madhe.

Shkodër, [16.VI.1965]

I dashtun Dritëro,

Ka kohë që s'kam marrë letër prej teje, as unë nuk të kam dërgue. Jam në nji gjendje të papërcaktueshme shpirtërore, nuk mund ta shpjegoj. Ora ka shkue 12 e natës dhe s'kam gjumë hiç. Kam kapë të shkruej tezat e provimeve të dy klasave ekonomike. Due që të kem pranë, që të më qetësojsh. Sa e ndiej nevojën tande i dashtun. Letra të paktën, pse nuk më shkruan? Marr fotografinë tande, letrat tueja. Lexoj vazhdimisht, por megjithatë nuk jam e qetë. Edhe dy javë mbetën, si e mendoj atë ditë. Qerimi, nana, të gjithë janë ba shumë të dashtun. Kjo gja më prek tmerrësisht. Nuk asht gja e paktë të largohesh nga shtëpia, nga të afërmit e tu dhe të vijsh si mik. Tek ne ka ra ambjenti i dasmës. Mbramë kemi ndejtë me Myskën deri në 3.30 të natës tue la shtëpinë. Përsëri sot jam zgjue në 6, pra 2 orë e gjysëm gjumë. Ma e keqja se nuk kam pushue gjithë ditën e sonte nuk më merr gjumi. Kam fillue të dobësohem, mbasi ha çdo gja pa oreks. Ti do të vijsh me 26 apo 27. Mbas nji jave vjen të më marrësh përgjithnji. E ndjej qysh tashti se do të qaj shumë atë ditë. Jam në formë, megjithëse jam dobësue. Sikur më shkon ma shumë kështu.

I dashtun çfarë bane për plazhin? Ti veç një letër më ke shkrue. Sigurisht që do të kesh edhe ti shumë punë. Dashtë pa dashtë këtu tek ne po bahet dasmë e madhe. Do të vijë për vizitë gjithë personeli, nxanësit. O Zot, unë nuse, nuk e imagjinoj. Ti a po ban pregaditje apo i len për në ditët e fundit.

Dritëro, ban mirë të marrësh atë ditë një veturë angazhe[1]. Më duket se kushton 1.500 lekë, pse të koritesh (turpnohesh)

[1] *Veturë angazhé*: Quhej taksia që porositej me të gjitha vendet, pa udhëtarë të tjerë.

për këto. Duhet të vi e veshun me të bardha, se, simbas fjalëve të të gjithëve, nuk jam grue e ve. Njeriu njiherë martohet, prandaj duhet të vishet kështu - asht mendimi i të tjerëve. Shtëpisë nuk ja kemi zanë në gojë, mos dysho për këtë se gjithmonë të shkon mendja për këto të mijtë. Sa fjalë ndëgjoj nga të tjerët, sa më randohet koka!

Këtë sakrificë të vogël do ta bajmë, si thue? Ti s'ma ke prishë asnjiherë, kështu që edhe ksaj rradhe do më falësh. Po megjithatë nuk të kam kërkue shumë apo jo? Sa mirë që po të shkruej letër se sikur po lehtësohem. Më duket se po flas me ty.

Nuk po të shkruej ma tepër se shkoj shumë vonë.

Të puth fort e fort,
Sadija yte.

[24.VI.1965]

E dashur Sadije,

Sa u ktheva nga Korça. S'më besohet që kanë mbetur edhe 10 ditë gjer në dasmë. Unë këtej kam bërë të gjitha përpjekjet që të kalojmë mirë verën. Mua më dhanë një herë një fletë kampi për në Pogradec, po duhet të niseshim më datën 24 qershor, dmth sot. Natyrisht që ishte një gjë që s'bëhej. Atëherë shokët e mi ndërhynë dhe ne do të shkojmë në Durrës më 9 korrik në shtëpinë e pushimit ose të Kryeministrisë, ose të oficerave. Ti duhet të marrësh një vërtetim nga qendra jote e punës që je në punë. Bëje gati se vij e marr të shtunën.

Unë do vij të të marr me maqinë angazhe e vishu si të duash e si të jetë më mirë. Ti kujton se unë nuk kam qejf që ti të vishesh me të bardha? Këtë rradhë më ka marrë malli shumë për ty. Po ti e ke patur fajin pasi nuk donje të të vinja unë në Shkodër me që kishin mbetur kaq pak ditë nga martesa! Gjepura! Të shtunën do vij e ti do më presësh.

Mbarove shkollën? Xhelali a erdhi?

Unë jam i bindur se ty plazhi do të të pëlqejë. Në njëzet e dy ditë apo një muaj do të bëhesh korb e zezë. Vetëm duhet të ruash lëkurën e hundës se mos mbetesh me lëkurë të ngrënë në hundë, dhe ti e di sa rëndësi ka hunda, sidomos për seksin e bukur! O hundë e bekuar!

Kam shkruar një cikël me vjersha për fëmijë dhe nesër botohet në "Mësuesi". Vjersha të tilla ti kurrë nuk ke lexuar. Për herë të parë shkruaj për fëmijë, siç duket, ti së shpejti do na skalitësh ndonjë Buratino[1]!

Tani në prag të dasmës ti nuk shkruan. Nuk vete në postë,

[1] *Buratino*: Personazhi kryesor i librit "Çelësi i artë" ose "Aventurat e Buratinos" të Tolstoit.

siç mendoj unë. Kushedi sa e hutuar dhe e emocionuar je! Edhe unë i emocionuar jam, po me që jam aq i afërt me ty dhe të njoh aq mirë, nuk më duket e çuditshme dita e dasmës.

Të dua shumë, shumë,

Të puth fort,

Yti, Dritëro

Letërkëmbim dhe *letërsi pasioni*

Po ndofta dashuria mbahej gjallë,
Se zjarrin e mbanin letrat në udhëtim;
Me biçikletë a mushkë apo me kalë,
Në vapë e shi, dëborë e thëllim.

Dritëro Agolli,
Letrat


Të kesh në duar një letërkëmbim dashurie, i cili të mirëbesohet para botimit, siç m'u mirëbesua mua ky koleksion i letrave të dashurisë të Dritëro Agollit për Sadijen dhe i letrave të Sadijes për Dritëroin, është një prej privilegjeve më të lakmuara.

I botuar me një titull domethënës, që ka dalë nga teksti i njërës prej letrave të Dritëro Agollit*, Dashuri në moshën e Krishtit;* nën kujdesin e admirueshëm të Sadijes, Elonës dhe Artanit; një vit pas ndarjes nga kjo jetë; Dritëro Agolli sërish do të na çudisë me mrekullinë e fjalës së tij dhe do të na thotë me një nënqeshje krenare: Sa pak më keni njohur, dhe pastaj do të na shfaqet fisnikërisht me atë pjesë tejet delikate të qenies dhe *brendabotës* së tij *(endokozmos),* që teorikisht dhe praktikisht konsiderohet *shenjtërisht e paprekshme.*

Duke i ruajtur këto letra për mbi një gjysmë shekulli; duke i përzgjedhur e renditur në një dosje më vete në arkivin e pasur të familjes, Dritëro Agolli, në një mënyrë të heshtur, e ka dhënë vetë pëlqimin për botimin e letërkëmbimit të tij të dashurisë.

Dashuri në moshën e Krishtit nuk është një pëmbledhje rastësore letrash vetjake, që u drejtohet së pari kurreshtarëve dhe më pas kryesisht jetëshkruesve të sotëm e të ardhshëm të Dritëro Agollit si burim të dhënash biografike. Lexuesi do të gjejë këtu

njeriun e pasioneve të fuqishme, që himn ka gëzimin e jetës, kurse vdekjen e lajkaton herë pas here me vjersha; njeriun që ia rrëmben ditës çdo çast po aq sa dhe dëshpërohet deri në dhimbje; njeriun me një larmi gjendjesh e përjetimesh që asnjë karakter letrar nuk mund t'i afrohet e t'ia kalojë. Ky pasion nuk u shua deri sa ishte në këtë jetë. *Letra në zarf* e datës 3 janar të vitit 2015, që, sikurse shihet edhe nga shenjimi i Dritëro Agollit, iu dërgua ashtu si në hershmëri Sadijes në orën katër e dhjetë minuta të mëngjesit, është një dëshmi deri në kufijtë e së pabesueshmes e dëshirës për të jetuar furishëm shpirtërisht. Kjo *letër-zarf*, e rrallë dhe e çuditshme, si vetë autori, është si një rikonfirmim solemn prej sovrani i gjithçkaje të thellë të shprehur në letrat e *dashurisë në moshën e Krishtit*:



***Letra-zarf* e Dritëro Agollit për Sadijen, një *letër e hapur*, shkruar më 3 janar 2015, me tekst në faqet e jashtme të tij.**

Ne të dy, unë dhe Sadija, jemi njerëz që zihemi me njëri-tjetrin: zihemi me gjuhë dhe puthemi me katër buzë; dy buzë ka ajo dhe dy unë. A shkëputet kjo katërshe mishi?

Se sa pasionante ka qenë kjo dashuri, këtë lexuesi mund ta gjejë lehtësisht edhe pas një gjysmë shekulli në shkrimin introduktues të këtij libri, të Sadije Agollit, që, me fuqinë e emocionit dhe shkallmimin e kufijve ndalues, mbetet shkalla më e lartë e shpalljes publike të dashurisë në historinë e letrave shqipe prej një gruaje, një shkrim që kurrë më parë nuk i është

rrëfyer lexuesit shqiptar dhe që nga pikëpamja e ngjashmërisë së situatave shpirtërore të sjell ndërmend Clelia Conti-n e romanit *Manastiri i Parmës* të Stendhal-it. Përngjasimin e përforcon vetë kapërcimi mbi tabu, përmbi *të rrezikshmen*, në rrëfimet tejet intime të dashurisë. Stendhal-i ua kushton veprën *the happy few ... people*, atyre pak njerëzve të lumtur që arrijnë t'i përjetojnë së brendshmi pasionet e dashurisë *që zien brenda romanit*; atyre fare pak njerëzve me fat, që arrijnë të komunikojnë me romanin si letërsi *e pasionit*.

Ky libër, me sublimimin e ndjenjës, brezit të ri, që gjithnjë e më shumë priret nga përkohshmëria, mund t'i duket *punë shkrimtarësh.* Një pjesë tjetër të lexuesit do ta bëjë ziliqar, pse vetë në jetë nuk e pati këtë fuqi shpirtërore. Megjithëse Dritëro Agolli njihet si një prej njerëzve më popullorë, thuajse pa të panjohura, shumica e lexuesve do të mësojë të reja mahnitëse për përmasën familjare të njeriut që rrojti përditë me qytetin. Lexuesi do të mësojë gjithashtu se *Shuberti harbut, Nietszche i çmendur, Dostojevski diabolik, Sabato që urren pleqërinë, Mozarti përbindësh,* nuk janë përligjje për një mendim gabimisht të ngulitur, por përgënjeshtrim i justifikimit se të gjithë njerëzit e mëdhenj kanë trille çmendurake dhe bëjnë marrëzira që mund të kuptohen vetëm brenda rendit të tyre. I dashuruari i jashtëzakonshëm Dritëro Agolli, në letrat e tij na shfaqet edhe me cene, me ato cene të vockla, fare të vockla të tokësorëve të lindur për mëkat, që Dante Alighieri ua ka caktuar vendin në një kënd të *Ferrit* ku përtej-jeta ngjan shumë më e këndshme se monotonia pa fillim e skaj e *Parajsës.* Por nuk na le rrëfimi i Sadijes që, përtej së zakonshmes, të mos shohim gjithaq Dritëroin zemërak, heraherës edhe inatçor, në mos arrogant, plot trille deri në kapriciot e fëmijëve (kur jeta e solli që duhej të ishte nën kujdesin e mjekëve, bashkë me të duhej të shtrohej në spital edhe Sadija), ngulmues deri në kryeneçësi në tryezat e dollisë dhe të gëzimeve.

Më fatlumët nga të gjithë do të jenë studiuesit. Ata të letërsisë, në radhë të parë, të cilët do të gjejnë të dhëna me shumë rëndësi

për një histori gjenetike të veprave të shkruara prej tij në vitet 1960, për amendimin kohë pas kohe të titujve të tyre, për pritjen nga botuesit dhe kritika, për gjykimet që autorit i janë thënë gojarisht, për vuajtjet e përhershme prej ndjenjës së autorësisë së penguar. *Tregimet po m'i shajnë shumë*, i shkruan Dritëro Agolli Sadijes në një letër të 29 prillit të vitit 1965. Dhe është fjala për vëllimin me tregime *Zhurma e erërave të dikurshme,* që, siç dihet, për fatin e keq të letërsisë shqipe, do të kishte qenë zhdukur pa gjurmë nëse nuk do të ishte ribotuar në Prishtinë, me titullin *Njeriu i mirë*, në vitin 1973, natyrisht pa pëlqimin e autoriteteve të Tiranës, nën kujdesin e studiuesve simpatizantë të tij. *Po unë jam mjaft gjakftohtë, aq gjakftohtë nuk është edhe një zhapi!* - shkruan më tej ai, dhe vetëm nga këto pak fjalë mund të kuptojmë mjedisin e akullt që iu krijua shkrimtarit për shkak të këtij libri, që u kritikua rëndë edhe në Plenumin XV të vitit 1965; vetëpërmbajtjen e dhimbshme duke parë veprën e vet të arkivohej.

Historia e gazetarisë në Shqipëri, që është pjesë e historisë së kulturës, në këtë libër do të gjejë burime cilësore parësore për modelin e reporterit shqiptar, që sot është në zhdukje e sipër. Gjuhëtarët do të kenë mundësi të verifikojnë gjendjen e normës së shqipes letrare para njësimit. Stilistët do të kishin punë sidomos me përdorimin e fjalëve në kuptime krejt konvencionale, thuajse të sekretuara, që nuk gjenden në asnjë fjalor të shqipes. Mbiquajtjet *fishek* dhe *fisheke*, shumë-shumë larg kuptimeve të burimit; po aq larg sa dhe me shprehjet uniforme të të dashuruarve të sotëm për njëri-tjetrin (*karamele e sheqerkë, shpirt e zemër*: fjala *shpirt,* në gjithë letërkëmbimin, është përdorur vetëm njëherë, nga Sadija), janë vetëm dy prej përdorimeve stilistikore origjinale, që përmbajnë, bashkë me shkallën e intimitetit, edhe një qortim sekret për shkujdesje, harresa e mosmbajtje premtimesh, pak a shumë si kuptimi i fjalës *qyq* sot përdorur në të njëjtin regjistër ligjërimi. Por na pëlqen të supozojmë e të besojmë se këto fjalë, fishek e fisheke, në kontekstin e përdorur, gati me marrëveshje, mund të jenë

dhe bartëse të ndonjë kumti të fshehtë erotik midis dy të dashuruarve *once upon a time*. Po aq interesante janë nga kjo pikëpamje shprehjet përafruese të përdorura në vend të emrave të prindërve dhe të afërmve. *Ai flet si me Xhexhenë* është bërë tashmë idiomë popullore prej mënyrës së përdorimit stilistikor nga Dritëro Agolli. Ata që studiuojnë etikën, psikologjinë dhe moralin do të gëzohen pa masë duke u marrë qoftë dhe vetëm me një pyetje, me atë për *magjinë* e shpërndërrimit magjik të vesit klasik në virtyt modern. Etnologët mund të mbështeten tek ky libër për të rindërtuar rendet etnojuridikë dhe tradicionalë të Shqipërisë në periudhën e urbanizimit të parë. Antropologët do të gjenden përballë pyetjesh të vështira, sepse intimiteti dhe bota e brendshme janë nyja verifikuese të identitetit dhe të cilësive etnotipike. Dhe kështu, studiuesit, cilëtdo qofshin, pavarësisht fushës nga vijnë, pasi kanë përftuar kënaqësinë estetike me leximin e parë prej këtij letërkëmbimi; pasi janë drithëruar, pasi kanë qeshur, pasi janë habitur, pasi kanë menduar e rimenduar, i lënë mënjanë ndjeshmëritë, abstragojnë dhe vetëveçohen në thelbet, siç ndodhi dhe me këtë parashtesë, nisur si shenjim hyrës e mbyllur si sprovë për një studim mbi intimen në letërsinë shqipe, mbi kushtëzimet midis epistolarit dhe letërsisë, mbi karakterin e letërkëmbimit si letërsi pasioni.

I. Letërkëmbyes si shkrimtar dhe letërkëmbyes si i dashuruar

Dy dekada më parë, ndërsa lexoja romanin *Arka e djallit* të Dritëro Agollit, kisha vërejtur se një pjesë e madhe e veprës ishte shkruar në formën e *letërsisë së fshehtë*. Në sëndukun e rrëfimtarit ruhej *romani brenda romanit*, që ishte pagëzuar me titullin *Shakaja e ndaluar*, nj*ë titull që na sjell në mendje një shaka tjetër të njohur, romanin Shakaja të Milan Kundera-s.* Në atë kohë, si *romani i ndaluar*, ashtu dhe 15 letrat sekrete të Bamkë Çomagës,

heteronim i vetë shkrimtarit, rrëfime të rrezikshme vetëm për mikun e tij mirëbesues Hyskë Borobojka; vjershërimet në stilin e poezisë lirike popullore dhe aforizmat, i kisha kuptuar si prani e teknikave të modernitetit, një prej parimeve të të cilit është prishja e kufijve tradicionalë midis llojeve e nënllojeve, ndërthurja e tyre brenda së njëjtës vepër, ndërrimi i regjistrave dhe i vetave të rrëfimit me anë të përfshirjes së ditarëve, letërkëmbimit, teksteve të cituar me protokoll si në letërsinë shkencore prej *autorit tjetër*, që në fakt është gjithnjë i njëjti. Në një studim të atyre viteve këtë dukuri të letërsisë moderniste në romanin *Arka e djallit* e kisha përkufizuar si *delegim autorësie* dhe si *intertekstualitet i pamirëfilltë*, që jepte mundësi për të krijuar një *hierarki ligjërimi*, përmes së cilës shkrimtari përcaktonte në mënyrë të padukshme qëndrimet e veta emocionale ndaj karaktereve dhe ngjarjeve, duke vendosur afëri apo largësi ndaj tyre, ashtu siç ishte n*ë* t*ë fshehtën botë të krijuesit të tyre. Dhe kjo ishte një hierarki e shprehur jo vetëm me gjendje emocionale,* por edhe gjuh*ësisht,* përmes vetës gramatikore.

Këto pamje të *modernitetit të fshehur* në romanin Arka e djallit në të njëjtën kohë dëshmojnë se Dritëro Agolli, në letërsi dhe në letërkëmbim, ishte vënë në kërkim të një *vetje tjetër*, që i lejonte më shumë liri dhe *sprovim letrar*. Ka ndodhur jo rrallë që në studime është mbitheksuar prania ideologjike, duke tërhequr kështu vëmendjen tek *gozhdët* dhe duke harruar se më i rëndësishëm është *kryqi* dhe *i kryqëzuari*. Të mbitheksosh përbërësen ideologjike në një vepër letrare që është krijuar nën *kanunin* e realizmit socialist është gjëja më e thjeshtë, por njëherësh dhe një akt padrejtësie, nëse me këtë mund të përligjësh harrimin e gjithçkaje tjetër në veprën letrare. Letrat e ndaluara *dhe letërsia me autorësi të tjetrit*, a nuk janë *pamje tjetërsoj* të veprimtarisë së shkrimtarit? Sot është gjerësisht në përdorim shprehja terminologjike *letërsi sirtari. Romani në sënduk* i Dritëro Agollit dhe letrat e tij të padërguara për Hyskë

Borobojkën, letrat e *djallit të fshehur në arkë*, për t'u lexuar pas vdekjes, janë konceptualisht të njëjtat.

Në tetor të vitit të kaluar, kur Sadije Agolli dhe Elona patën mirësinë të më besonin një kopje të *letërkëmbimit të dashurisë*, letrave të Dritëro Agollit për Sadijen dhe të Sadijes për Dritëroin, shkruar në vitet 1964-1965, për herë të parë më shkoi ndërmend se prania e brendashkruar e gjithë nënllojeve të tjera në romanin *Arka e djallit*, prej sekreteve të sëndukut deri tek të shprehurit përmes thënieve të Mevlanas, Xhelal-ed-din Rumiut, mund të shpjegohej jo vetëm me njohjet teorike dhe përvojat letrare moderniste të autorit, por edhe me një arsye tjetër, brenda dhe jashtë letërsisë. Shumë të dhëna, që marrin shkallë pas shkalle karakter sistemor, na bëjnë të ditur se Dritëro Agolli ishte tejet i ndjeshëm ndaj mungesave dhe paplotnive që kishte trashëguar letërsia shqipe, një letërsi relativisht e vonët, me kufizime tematike e sistematike; asimetrike, shproporcionale dhe e pavetëmjaftueshme. Një prej këtyre mungesave ka të bëjë me traditën tejet modeste, që shkon deri në kufijtë e varfërisë, të epistolarit intim. Kësaj çështjeje do të jemi të detyruar t'i rikthehemi në vijim, për vetë implikimet e saj jo vetëm me letërsinë, por dhe me identitetin e njeriut shqiptar, sepse mungesa e epistolarit intim, ashtu si mungesa relative e detit dhe e kulturës detare, tek studiuesi vijnë në formën e pyetjeve edhe më të ndërlikuara se pyetjet që lidhen thjesht me çështje tematologjike dhe gjinore në letërsi. Intimiteti në letërsi është njëherësh edhe çështje antropologjike, çështje kompleksesh dhe psikozash etnike, çështje me interes në një rrafsh të gjerë diturish.

Duke i vështruar në pranësì letërkëmbimin e Bamkë Çomagës me Hyskë Borobojkën në romanin *Arka e djallit*; letërkëmbimin e vërtetë të dy miqve që shfaqen në veprën letrare me këto heteronime, pra, letrat e Dritëro Agollit dhe të Gaqo Veshit këmbyer mes tyre në vitet 1967-1968 dhe botuar më 2001 me titullin *Tre qeshin, një inatoset*; me letërkëmbimin e dashurisë që po botohet në këtë libër, mund të argumentojmë se Dritëro

Agolli ka qenë i vetëdijshëm për traditën e munguar të letërsisë intime në Shqipëri, ishte i ndjeshëm ndaj kësaj mungese dhe i vuri vetes për qëllim e ia doli me shumë sukses, në mënyrë të drejtpërdrejtë e të tërthortë, ta bënte të pavërejtshme atë, duke e thyer përgjithnjë kufirin e hapjes së njeriut shqiptar ndaj botës. Romani *Arka e djallit* na ofron paralelizma e prirje të stilistikës dhe ligjërimeve që të çojnë pikërisht në thelbin e *vetërrëfimit* si në një letërkëmbim të vërtetë. A nuk është romani sekret i Bamkës ndryrë në sënduk, *djallëzia e veprës së ndaluar*, një formë letërshkrimi që, ashtu si një letër e vërtetë, i drejtohet me zemër në dorë një miku duke pasur në mendje edhe një adresant të ardhshëm, të cilit do t'i zbulohet nga Hyskë Borobojka kur ai të vendosë ta bëjë këtë? Dhe a nuk është pikërisht *shkelja në zonën e ndaluar*, *prekja e tabusë*, ajo që e bën intime një letërsi? Më së fundi, a nuk ishin si letrat e *Arkës së djallit*, ashtu dhe letërkëmbimi i dashurisë, ruajtur diku në një kënd të fshehtë, në pritje të një kohe të ardhme? Rrëfimet e ndaluara të Bamkës dhe 15 letrat e tij për Cute Babulen përngjasojnë aq shumë, për nga shkalla e të rrezikuarit të vetes me hapje ndaj të tjerëve, me *rrëfimet e zemrës* të letrave të dashurisë, edhe këto, për nga thelbi i tyre, të ndaluara për *lexuesin tjetër*. Në një vend ku vetëvrasja dënohej me kushtetutë si krim politik, a mund të kishte shkallë më të lartë intimiteti se në këtë letër të Bamkës shkruar për Hyskë Borobojkën:

> *Sonte në mbrëmje do të vdes. T'i bëni telegram Hyskës në Tiranë që të vijë të marrë sënduqkën. Ata defterët e trashë me kapakë të zinj t'i mbajë për vete, ato pesëmbëdhjetë letrat që janë të mbyllura në pesëmbëdhjetë zarfe jeshile t'ia japë Cute Babules (Arka e djallit, f. 31).*

Në librin *Vjen njeriu i çuditshëm* Dritëro Agolli ka përfshirë edhe disa shqipërime të zgjedhura, zakonisht prej poetësh me të cilët edhe vetidentifikohej në shije letrare dhe orientimin social.


A mund të shpjegohet jashtë ndjenjës së vetëdijshme të autorit për mungesën e intimitetit në letërsinë shqipe zgjedhja e poezisë *Letër motrës sime* prej trashëgimit të larmishëm të poetit grek Janis Ricos? Siç shprehej vetë Dritëro Agolli, *në çdo shqipërim, veçanërisht të lirë, futet edhe shpirti i shqipëruesit*. Nuk ishte aspak rastësore, ishte një përzgjedhje, që nxitej pikërisht nga ndjesia e mungesës së këtij intimiteti, e mungesës së letërsisë së kësaj nëngjinie të ndjerë, pa të cilën letrat e një populli janë shumë larg së shprehuri të shpirtit të një kombi:

Motra ime
Më dukej sikur e bënte çdo gjë dashuria,
Me dukej se unë për ty mund të gjeja
Edhe ujë me shpirt;
Më dukej se nga qielli mund ta këputja diellin
Dhe ta lidhja me përparësen tënde.
Tani ta dëgjoj thirrjen:
"Vëllai im,
Dua të pi!
Ç'e bëre ujin me shpirt
Që etjen time të shuaj?
Kam ftohtë,
Vëllai im!
Ç'e bëre diellin
Që duart e mia t'i ngrohë?"


Është për t'u shtuar edhe një fakt tjetër. Përmes këtij libri, përmes letrave të *dashurisë në moshën e Krishtit*, lexuesi po njihet vetëm me një pjesëzë fare të vogël të epistolarit të Dritëro Agollit. Nga Sadija dhe Elona kam mësuar se në arkivin e familjes ruhen shumë e shumë letra të tjera, sepse Dritëro Agolli ka pasur korrespondencë me miq pa fund, miq të përhershëm e miq me të cilët e lidhnin ngjarje e punë të përbashkëta. Shumë letra të tij me siguri ruhen në arkivat e atyre miqve të cilëve ai u shkruante më së shpeshti përgjatë rrugëtimit në jetën krijuese dhe si veprimtar publik. Midis atyre miqve që kanë pasur fatin të

presin letra miqësore nga Dritëro Agolli janë edhe Petro Marko, Dhimitër Shuteriqi, Niko Nikolla, Fatmir Gjata, Dalan Shapllo, Koço Kosta, Et'hem Ruka dhe shumë të tjerë. Në letërkëmbimin e Dritëro Agollit mund të gjenden cilësime shumë domethënëse edhe për ata miq që kishin marrë goditje fatale ose zyrtarisht duhej të qëndronin larg. Në një prej letrave flitet për *të gjorin Minush Jero*, *dramaturgun e njohur*, që *ka mbetur mësues në Vlorë*. Herë të tjera përmendet me shumë ndjenja afërie poeti Dhori Qiriazi, që, për shkaqe biografike, duhej të qëndronte gati-gati në anonimat në Kolonjë, megjithëse qe njëri prej protagonistëve të *Brezit 1960*. Në shumë letra përmenden Ismail Kadare e Dalan Shapllo, vepra e shqetësime të tyre. Me siguri në një të ardhme këtij koleksioni do t'i shtohen letra të tjera ende të pabotuara. Për të gjitha këto të dhëna dhe për mjaft fakte të tjera jetësore që plotësojnë kuptimin e letrave të Dritëroit për Sadijen dhe anasjelltas, fjalët e thjeshta të mirënjohjes nuk mjaftojnë.

Letrat kanë qenë një nënlloj i përditshëm krijimtarie për Dritëro Agollin. Ishte një zakon i përditshëm, një ngasje për të kapërcyer përtej *kanunit zyrtar* të letërsisë, për t'iu shfaqur lexuesit, qoftë dhe një lexuesi të vetëm, pa mburoja, pa disiplinë, pa zhguall ideologjik. Letërkëmbimi ishte mënyrë jetese për të. Kur ai shprehej: *Nuk ka si dorëshkrimi* - në romanin *Arka e djallit* - sigurisht e kishte fjalën jo për dorëshkrimin që çohet në redaksi për botim, por për dorëshkrimin që ruhet si një sizmogram shpirtëror. Nuk do të vonojë dhe lexuesi do të ketë mundësi të njihet pjesë-pjesë me çfarë u shkroi miqve e të njohurve *in privato* Dritëro Agolli: prej letrave që bartin shqetësime vetjake e qytetare, deri tek pusullkat me humor e qesëndi shkruar në tryeza gëzimesh a në udhëtime larg vendit. Për rëndësinë që ato kanë, siç ka ndodhur me letërkëmbimin e njerëzve të mëdhenj, e këtu po përmendim vetëm atë të kompozitorit hungarez Franz Liszt, që, me mbi 800 adresantë gjatë gjithë jetës, konsiderohet një rekord në historinë botërore të epistolarit, mund të përfytyrohet që dikur të jenë pjesë e trashëgimisë së një qendre akademike-universitare apo e një instituti të ngritur posaçërisht.



Letërkëmbimi midis Bamkë Çomagës dhe Hyskë Borobojkës botuar më 2001



Në rrugën e gjatë

U lodh dhe plaku Dritëro, u lodh!..
Me briskun në Astra-n mirë e bukur rruhet
Dhe pa duhan dhe pret këtej e po ndodh,
Se loja politike muk i lihet.

Sa keq që s'e besoi të madhin zot,
Sa keq që para tij muk dë të shkuqet,
Se goti mund t'ia mbushte hejbet plot,
Madje më varr t'i kishte plot sunduqet!

Eh, s'ke ç'të bësh!.. I rrillë n gdhend ky drog
Dhe le të shkojë atje ku shkuan miqtë,
Atje ku prehin kockat shokët pleq...

Po varri kurrizdalin muk e ndreq,
Në varr i mbledh të mirët dhe të ligtë,
Rakinë e gjen dhe vallen prapë e leq.

28 janar 1998

Në rrugën e gjatë, poezi, dorëshkrim

II. Pak fjalë për *intimitetin e munguar* në letërsinë shqipe

Në romanin e tij *Kush e solli Doruntinën* shkrimtari I. Kadare ka përfytyruar një letërkëmbim intim midis *nënës* dhe *kontit*, letërkëmbim në të cilin shprehen në mirëbesim shqetësime dhe këmbehen mendime për çështje shumë vetjake, duke përfshirë atë të mbikujdesit të dyshimtë të Konstandinit për motrën e vetme të nëntë vëllezërve, me emrin Doruntinë. Ky përfytyrim, edhe pse krejt figurativ, duket shumë i bukur për t'u besuar. Në të vërtetë, në përvojën e botimeve shqiptare thuajse nuk ekziston ndonjë traditë e letrave intime, aq më pak një traditë e letrave të dashurisë.

Dy prej letërkëmbyesve më të mëdhenj të historisë së letërsisë shqipe: Jeronim de Rada dhe Mit'hat Frashëri, i pari në korrespondencën me Dora d'Istria-n dhe i dyti në letrat për kushërirën Eminë, mund të konsiderohen si më përfaqësuesit e prirjes historikisht të kufizuar të hapjes ndaj dikujt tjetër për brenda-botën, që grekët e vjetër e quanin *endokozmos*. Nuk gjen në letrat e autorëve shqiptarë, qoftë të letërsisë, qoftë të diturive; qoftë të Rilindjes, qoftë të mëvonshëm; duke përfshirë

dhe bashkëkohësit, përshkrime të gjendjeve të brendshme, fjalë dhimbjeje a trishtimi, për sëmundje dhe dobësi, për përjetime romantike a sentimentale, ca më pak për lidhje dashurie.

Aq mungesore është intimja në letërsinë shqipe, sa edhe sot, në epokën e lakuriqësisë dhe të shndërrimit të mitit të stërlashtë sanskrit të Shivës për globin e përfytyruar si një sy i stërmadh galaktik, tashmë kthyer në një makth, në një realitet të frikshëm, në të cilin njeriu asnjëherë nuk është i sigurt se është vetëm me veten dhe pa të tjerë, i pashikueshëm prej botës, nuk janë kapërcyer keqkuptimet terminologjike edhe për kategori të tilla si erotikja dhe lirika e dashurisë.

Në romanin tjetër të I. Kadaresë, *Muzgu i perëndive të stepës*, autori rrëfyes thërret në ndihmë Pushkinin për të shkruar një letër dashurie të shpërndërruar në një parodi cinike. Vetë Pushkini ia kishte ofruar bujarisht Kadaresë këtë mundësi. Në ditarin që poeti rus pati mbajtur si kronikë për jetën vetjake, siç është vërejtur nga studiuesit, shfaqet një dukuri gjuhësore dhe letrare me shumë interes për të dalluar kufijtë midis *shkrimeve për të tjerët*, *për botim*, dhe *shkrimeve për veten*. Kjo dukuri njihet si *përdorim i dy regjistrave gjuhësorë* për të komunikuar në nivele të ndryshme, varësisht prej qëllimit të shkrimeve dhe adresantit. Pushkini ka një regjistër kulture gjuhësore për artin dhe një tjetër regjistër kulture gjuhësore për ditarin intim. Vajza e dashur e shkrimtarit, në rastin e parë, në poezi, është një engjëll; ndërsa në *shenjimet pa lexues* vajza e dashur shfaqet deri në pamjen e lakuriqësisë fizike e fiziologjike. Edhe poeti vetë nuk është më ai *i larti*, por njeriu që i kujton vetes gjithçka, duke mos kursyer edhe hollësitë erotike. Mund të merret me mend se në ç'mospajtim gjuhësor e letrar janë shumësi formal gramatikor i respektit (**ju**), që i takon regjistrit të parë; me kumtin fodull mashkullor, që i takon regjistrit të dytë, në pohimin e tij aq të përfolur: *Atë ditë që, me ndihmën e Zotit,* ***ju*** *shtiva në dorë*.

Në historinë e shkrimeve shqip mund të kenë ndikuar si faktorë kufizues të traditës së letërkëmbimit intim shumë shkaqe: para së gjithash analfabetizmi. Nuk mund të shkruhej

një letër dashurie a një letër për bashkëshortin në mërgim duke ia diktuar fjalët përkëdhelëse një *noteri* apo *kadiu*. Letrat e dashurisë shkruhen për dy veta, çdo i tretë është i tepërt, ashtu si në dashurinë vetë. *U bëmë tre vetë, pak si tepër në një familje*, pohonte Lady Diana në një intervistë të hershme, kur iu drejtua pyetja se pse e kërkonte me doemos ndarjen nga Princi Charles, megjithëse e dinte shumë mirë se për të lejuar divorcin në një nga familjet më konservatore në botë, në familjen mbretërore britanike, do të duhej të bëhej një referendum.

Pikërisht mungesa e funksionit të letërkëmbimit intim duhet të ketë qenë arsyeja pse Kostë Çekrezi, në librin e tij të njohur *Letra, shkresa, fjalëtore* (Boston, 1917), ribotuar së fundmi nga studioja letrare *Naimi* me titullin *Udhërrëfyes për komunikim*, parashikoi modele të gjithfarshme letrash dhe shkresash, thuajse për të gjitha nivelet e letërkëmbimit, zyrtare e private, drejtuar mbretit dhe gjykatësit, avokatit dhe zyrës së funeralit, por nuk parashikoi edhe modele letrash dashurie. Sigurisht, më parë se analfabetizmi i vonshëm i kohërave pas *shekullit të dritave* (*le siècle des lumières*), ka ndikuar *rendi etnojuridik tradicional*, që njihte familjen, por jo edhe dashurinë; që sekretonte me kodin e vet të rreptë gjithçka që ndodhte brenda saj - *erzi kanunor*: *dy gisht ballë për dy gisht nder*. Për dashurinë mund të këndohej vetëm në dasma. Mund të këndohej edhe për të flijuarit në emër të saj.

Nëse për intimen në letërsinë shqipe mund të mjaftoheshim me përcaktimin si *dukuri e munguar*, erotizmi do të mund të quhej një *dukuri jashtë portave të saj*. Ndryshe prej letërsisë popullore, ajo me karakter krijues-autorial, për shumë arsye, na shfaqet si një *letërsi me erz*, si një *letërsi namusqare*, madje *deri në kufijt e puritanizmit*. Në letërsinë popullore ekzistojnë cikle të pavarur, me karakter të mirëfilltë inkurajues erotik, që dallojnë së largu prej letërsisë së sublimimit të dashurisë, e cila gjendet qysh tek De Rada e Naimi, deri tek bashkëkohësit. Fare pranë erotizmit gjendet Çajupi, me poezinë *Nyja tri* (por poezia *Kënga e kandarit* është thjesht një apokrif); në një mënyrë tjetër,

vetëpërqeshëse, edhe Fan Noli (*Plak topall dhe ashik*) dhe në mënyrë të tërthortë Migjeni (*A don qymyr, zotni?*). Sa i takon traditës popullore, *kangët e kuerit*, qerthulli i këngëve që motrat ia kushtojnë vëllait-dhëndërr në çastin e *bashkimit të par*ë me nusen janë jo vetëm me licensioze, të çliruara prej pengimeve të leksikut gjuhësisht të rezervuar, por, mbi të gjitha, me funksionin e drejtpërdrejtë të përndezjes erotike. Këtu po citojmë vetëm disa vargje të njohura popullore që shoqërojnë ritin e bashkimit të parë në çift në viset veriore:

O dhandër, mor uk,
Kape mos u tut;
O dhandër, mor qen,
Kape mos u tremb.

Dritëro Agolli e njihte më mirë se çdokush erotizmin e poezisë popullore. Në hyrjen e shkurtër të përmbledhjes me 101 këngë popullore të titulluar *Shpirti i gjyshërve*: krijime, rikrijime dhe përzgjedhje nga bartësit popullorë, ai shprehej: *Duke lexuar në këtë fletorkë do të shikoni se çfarë i kanë punuar gjyshërit dashurisë! I kanë kënduar me plot gojën dhe e kanë nxjerrë lakuriq në lëndinë dhe prapa dritares, pa perde! Ne poetët shpesh e kemi kursyer dashurinë dhe ndonjëherë kemi pasur turp ta tregojmë të plotë në vargje. Ndërsa gjyshërit ndaj dashurisë kanë qenë jo vetëm liberalë të mëdhenj, në sensin e një emancipimi mahnitës, por kanë qenë edhe tepër delikatë pa u trembur edhe nga paturpësia. Delikatë ishin edhe kur dëshironin të thoshin me këngë ndonjë gjë të turpshme. Kjo ishte një paturpësi delikate, si*:

Fukaraja s'kërkon gjë:
Të fle një natë me të,
Kokën pres e s'i bëj gjë!
T'i shkopsit kopsat e gjirit,
T'i shoh gurë e xhevahirit ...

Këtu s'ka asnjë fjalë të turpshme dhe të shëmtuar. Ka vetëm kopsa, gjinj, gurë xhevahiri ... Epo, nga mos u heqësh kapelën në shenjë nderimi këtyre gjyshërve tanë të mëdhenj!

Erotizmi nuk arriti të depërtonte në letërsinë autoriale në atë formë që gjendet në poezinë popullore. Frika prej qortimeve për nxitje të degjenerimit dhe shthurjes, që qëndronte gjithnjë prapa çdo tentimi të tillë, ishte vetëm një prej shkaqeve. Por kemi të drejtë të besojmë se, në rastin e Dritëro Agollit, kumte erotike ka jo vetëm në letrat e tij, por edhe në poezi. Përkundër ruajtjes së përgjithshme prej telasheve të erotizmit në letërsi, në një kohë që dashuria duhej të ishte doemos *e virtytshme*, Dritëro Agolli, me një shkujdesje të habitshme, siç e takojmë në poezinë *Kitara prej mishi* (shumë ngjashmërisht me fjalët e Sadijes në letrën e shkruar më 20 mars 1965: *Do të të puth jo si te gjyshja*), apo si na befason edhe me *letrën-zarf* të viteve të fundme të jetës, ka fjalë e shenja që këndellin e përndezin jo dashurinë me zemër e mend, por një dashuri tjetër, që mban shenjën e Erosit antik:

Dhe këmbët e gruas i prek me gishtërinj si kitarë,
I prek nga fillimi në fund me pasion muzikor;
Kësaj kitare i bie çdo natë me epshin e marrë,
Dhe tinguj të mishtë ajo nxjerr me dëshirë e me zor.

(*Kitara prej mishi*)

Sot vajzat i zbuluan dhe kërthizat,
Një fllad i ngrohtë puplat u lëmon.

(*Në fillim të majit*)

Kur je vetëm një shikues,
Gjunjët s'marrin hov,
Nga fustani provokues
Mbetesh një gallof.

(*Fustani provokues*)

Është rasti këtu për të kujtuar se *letërsia me namuz* nuk ka ndonjë kushtëzim përjashtimor me realizmin socialist dhe *kanunet* e tij. Përkthyesi i mirënjohur i Biblës shqip, që kishte në këtë nismë dhe pëlqimin e Selisë së Shenjtë, Dom Simon Filipaj, vargun e njohur të *Canticum Canticorum - Kënga e Këngëve*, që është quajtur himn i dashurisë dhe i erotizmit, duke përfshirë incestin; pra, vargun *Unë prek gjoksin tënd*, ndryshe prej Mitrush Kutelit (tek *E madhe është gjëma e mëkatit*) dhe gjithë traditës tjetër të mëparshme, madje dhe prej traditës laike arbëreshe (përmendim këngën *Motra ime nuse*, që këndohet edhe sot), e shqipëron: *Unë prek parzmin tënd*.

Edhe Lef Nosi, që, siç pranohet prej shumëve, përtej traditës shqiptare, në vitet 1930 pati një lidhje të veçantë dashurie me *Engleskën* e tij, antropologen britanike M. Haslluk: njeriu që me të drejtë njihet si parathemeluesi i arkivave të Shqipërisë, koleksionist i rrallë, me një fond - ashtu të mpakur siç u varfërua prej ndarjeve të qëllimshme - prej mbi 12 mijë fletë, nuk la gjurmë të ndonjë letërkëmbimit vërtet intim.

Në ato që njihen si *letra të njerëzve shqiptarë*, si epistolari shqip, flitet kryesisht për çështje atdhetare, për kryengritje, për lëvizje të mëdha shoqërore, për misione e ideale. I vetmi që ka shkruar për gjendje të brendshme: dobësi, vuajtje, sëmundje, simpati e përbuzje, për njerëzit e afërm dhe familjen, është Migjeni, njeriu që e çliroi letërsinë shqipe nga *romantizmi i shenjtë* dhe e ktheu atë tek e kishte vendin - në qytet. Në fakt, në historinë e letërsisë shqipe ka ndodhur një asimetri nga më të pabesueshmet në pikëpamje të rendit të dukurive, krahasuar me zhvillimet europiane, që njihen si zhvillime që kanë përgatitur njëri-tjetrin përmes përurimit të poetikave: sentimentalizmi, që në letërsinë frënge parapriu romantizmin e gjysmës së parë të shekullit XIX, në Shqipëri u shfaq vetëm një shekull më vonë, pikërisht në vitet 1930, kur më së fundi ishin dukur edhe disa shenja të qarta të *modernitetit të parë*, me simbolizmin, ekzistencializmin,

psikanalizën, deri-diku edhe surrealizmin.

Në gjysmën e dytë të qindvjetëshit të shkuar jo vetëm nuk mund të përjashtohet, por duhet pranuar si faktor parësor për veprimin e vet pengues prej së jashtmi edhe druajtja e frika nga kontrolli shtetëror i korrespondencës dhe, për një pjesë, edhe kufizimi i saj, në kuptimin juridik të fjalës. *Familja jonë*, shkruan Liri Lubonja në një artikull polemik të kohëve të fundme, *e copëtuar në burgje dhe internim, u qëndroi gjithë atyre të këqijave të 18 viteve të ferrit edhe në sajë të dashurisë familjare. Unë kam në shtëpi vandakun e letrave të korrespondencës familjare midis nesh. Todi dhe Fatosi, njëri në Burrel, tjetri në Spaç, kishin të drejtën të shkruanin dy letra në muaj dhe ata rregullisht një letër na e dërgonin ne dhe një letër njëri-tjetrit.* Shumë herë ditarët dhe letrat u shndërruan në prova hetimi e dënimi për shkruesit e tyre.

Shumë është folur për komplekset shqiptare. Më së shpeshti është përmendur *kryemëvetësia* (*krenìa*, fjalë që ka hyrë dhe në serbisht, në formën *kreniše*), bindja pa kushte e shqiptarëve ndaj të parit të tyre, jo më pak edhe kuptimi i tyre tragjik për jetën. Edith Durham pati rastin të bisedonte me një malësor shqiptar në grahmat e fundit të jetës dhe e pyeti se përse do të kishte dashur të jetonte ende, çfarë dëshire i kishte mbetur pa mbaruar. Dhe ai iu përgjigj: *Po ik me kokën pas nga kjo jetë sepse nuk kam vrarë askënd. Gjyshi ka vrarë, babai ka vrarë, kurse unë jo*. Ndërsa G. G. Byron nuk e quante mëkot Shqipërinë *nënë e rreptë burrash të ashpër*. Dhe më tej:

Të rreptë bijt' e Shqipes! Por vetitë
Nuk u mungojnë; veç t'ishin ca më t'arrira!
Armiku ua pa shpinën ndonjëherë?

Fierce are Albania's children, yet they lack
Not virtues, were those virtues more mature.
Where is the foe that ever saw their back?

Në këto vargje, që janë recituar prej sa e sa brezash si madhështues të virtytit shqiptar, në të vërtetë ka një qortim të madh për botën e tyre: shqiptarët janë burra të rreptë, por, sidoqoftë, krejt pa cilësi të vyera nuk janë, veçse duhej t'i kishin më të pjekura, *më të arrira*. Ndoshta gjuha shqipe është e vetmja që me fjalën *trim* kupton edhe *njeriun e luftës*, *heroin*, edhe djaloshin e dashuruar, si në poezinë e njohur popullore arbëreshe me titull *Trimi dhe vasha*. Dhe me të drejtë G. G. Byron nuk kursehet në qortime edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj shqiptarëve *trima* e *besnikë*, por pa anën tjetër të historisë, pa histori të ndjenjave, pa histori të dashurisë. Në të njëjtë këngë të poemës së tij të njohur *Child Harold Pilgrimages* ai shkruan se *këtu, në vendin e bijve të shqipes, zëra grash nuk dëgjon kurrë, e ndaluar është t'i shohësh kur lëvizin*:

LXI.

Here woman's voice is never heard: apart
And scarce permitted, guarded, veil'd, to move,
She yields to one her person and her heart,
Tamed to her cage, nor feels a wish to rove;
For, not unhappy in her master's love,
And joyful in a mother's gentlest cares,
Blest cares! all other feelings far above!
Herself more sweetly rears the babe she bears,
Who never quits the breast, no meaner passion shares.

Këtu zëri i gruas nuk dëgjohet kurrë,
Dhe rrallë leje i jepet, ruhet dhe mbulohet kur lëviz.
Ajo ia dorëzon vetëm njërit veten dhe zemrën e saj,
E zbutur në kafazin e vet, nuk ndjen as dëshirë të shtegtojë;
Pasi nuk është e palumtur në dashurinë e të zotit,
Dhe shkrihet në përkëdheljet më të dashura si nënë.
Përkëdheli të bekuara! Të gjitha ndjenjat e tjera janë larg kësaj!
Ajo vetë aq ëmbël rrit beben që mban,
Që nuk ia lë kurrë gjoksin, dhe s'ka të ulëta pasione.

Kjo çështje, që në fund të fundit merr formën e pyetjes se *ç'vend zë intimiteti në jetën e shqiptarëve*, ose është trajtuar anash, ose nuk është trajtuar ndonjëherë në studimet antropologjike të deritashme, të cilat me sa duket edhe për një kohë të gjatë do të merren me identitetin si çështje bashkësie, jo dhe me identitetin e qytetarit, të njeriut si qenie e përmbushur me fuqi mendore, shpirtërore e fizike.

Një gjë është krejt e qartë: me njeriun shqiptar nuk u vërtetua kurrë një vuajtje si ajo e djaloshit Verter, djaloshit të dashuruar dhe të sfilitur nga ndjenja e papërmbushur si në romanin e W. Goethe-s, që, i botuar për herë të parë me fashikuj, çdo të diel, pikërisht në ditën e Zotit, megjithatë, çonte në vetëvrasje dhjetëra të rinj gjermanë bashkëndjenjas me të - *gjermanë të ftohtë*, sigurisht! - prej humbjes së dashurisë.

III. Dritëro Agolli *orthos logos* dhe *author logos*

Kur mora në duar dorëshkrimin e letrave të Dritëro Agollit shkruar për Sadijen në vitet 1964-1965, në atë kohë sapo të dashuruar e pak më pas edhe *i promessi sposi*, po të përdornim për cilësim titullin e romanit të njohur të A. Manzoni-t, e para gjë që më shkoi ndërmend ishte të kujtoja se cili mund të ishte shembulli i mëhershëm i këtij letërkëmbimi. Po kërkoja atë shembull që nuk e kisha gjetur dhe nuk do ta gjeja edhe me kërkime arkivistike të posaçme. Kisha lexuar me qindra e qindra letra të ushtarëve italianë shkruar grave të tyre kur ora e luftës i zuri në Shqipëri: ato letra mbetën në këtë anë të Adriatikut, pa mbërritur kurrë në duart e njerëzve që i prisnin, sepse nuk kishin optimizëm fitimtar, siç e kërkonte slogani i njohur fashist: *Credere, ubidere, vincere!* Ishte vetë censura fashiste ajo që ua ndaloi rrugën për tek marrësit: Instituti *Luce* ndërkaq i kishte njoftuar ndryshe bashkatdhetarët. Thuajse i vetmi rast që më përsëritej në mendje si një pararendje e mundshme ishin letrat e Safet Butkës kur ishte i internuar në kampin e përqëndrimit të

Ventotenes, që nisnin rregullisht me fjalët hyrëse *E dashur gruaja ime*, *Gruaja ime Xhexhe, E dashur grua, E dashur Xhexhe, Shumë e dashur gruaja ime, Gruaja ime e dashur Xhexhe, Fort e dashura gruaja ime, Fort e dashur Xhexhe.* Mund të përafroja disi me to, natyrisht për intimitetin dhe jo për dashurinë, edhe disa letra të Musine Kokalarit për të afërmit në vitet e dëbimit të tyre larg njëri-tjetrit.

Letërkëmbimi i Dritëro Agollit me Sadijen dhe letrat e Sadijes për të, së paku deri më sot, janë *i vetmi koleksion që njohim në llojin e vet* dhe mund të quhet me rëndësi të dyfishtë: për të njohur autorin nga kjo anë e fshehtë dhe tejet delikate njerëzore dhe për të shpëtuar traditën e shkrimeve shqipe nga një mungesë e madhe nëngjinore: nga mungesa e letrave intime. Nuk kemi siguri nëse Dritëro Agolli ka marrë mësime arkivistike, si lëndë universitare, por një gjë e dimë të sigurt: ai e njihte më së miri cilësinë kryesore të letërkëmbimit, si *dokumenti më i besueshëm ndër gjithë llojet e dokumenteve*, sepse letra që del nga duart e autorit nuk mund të kthehet më tek ai dhe të rivizitohet për t'iu përaruar shijeve e mendimeve të reja, që vijnë bashkë me ndryshimin e rendeve shoqërorë apo të gjendjeve shpirtërore.

Letra është një shprehje e çastit. Sikur ne t'i shkruanim letrat e t'i mbanim pa i dërguar qoftë edhe një ditë, natyrisht po të ishim në gjëndje shpirtërore normale, të tretën ditë do t'i grisnim e do të thoshim me vehte: ç'marrëzi kemi shkruar!

Kështu i shkruan Dritëro Agolli Sadijes në një prej letrave të tij. Dhe kushedi sa herë e gjejmë të shprehur pendimin e tij për letrat që i ka shkruar, ndonjëherë edhe për një letër të dërguar vetëm një ditë më parë. Por tashmë ajo është nisur dhe askush mund ta kthejë pas, ta përshtasë sipas mendimit të ditës a gjendjes së re shpirtërore të autorit, të ndalojë në mes të rrugës kumtin e nisur. Sepse letërkëmbimi është *lloji më i pamodifikueshëm i shkrimeve*. Madje as letra e *Tonit nga Mirdita* dërguar nga burgu vitin e shkuar bashkëshkortes 42-vjeçare, me fjalët e kursyera: *E dashur grua unë do të të vras*, që ndoshta prokuroria

e Tiranës e ka përdorur si provë rënduese për fajësinë e tij, nuk mund të ndryshohet më. Është një letër që përcjell një ndjenjë hakmarrëse tipike ballkanase. Në një poezi tradicionale greke, që është përfshirë në antologjinë me titull *Vajtime popullore kretase*, përgatitur e botuar nga Nikos Angelos, kemi gjetur edhe këto vargje:

Mos u shqetëso
i dashuri im:
Ai që do të marrë gjak për ty,
është tashmë në barkun tim.

Çdo gjë që mund të ribotohet: një tregim, një poezi, një studim, autori mund ta rishohë në mënyrë kritike sa herë të dojë: mund të mbishkruajë e të anëshkruajë, por jo dhe një letër. Sepse letra është i vetmi nënlloj i publicistikës që nuk njeh variante.


Letërkëmbimi intim i Dritëro Agollit me Sadijen, në fillim vajza e tij e dashur, pak më vonë e fejuara dhe në fund shoqja e jetës, u përket viteve 1964-1965. Kjo është koha kur ata, tashmë të dashuruar, gjendeshin larg njëri-tjetrit. Letërkëmbimi përmban 44 letra të Dritëro Agollit dhe 20 të Sadijes. Letrat e Dritëro Agollit janë 20 të vitit 1964 dhe 24 të vitit 1965. Në ato vite letërkëmbimi ishte e vetmja formë komunikimi mes njerëzve dhe zyrave. Një mundësi tjetër, mjaft më e ndërlikuar dhe krejt e dyshimtë, që përmendet edhe në këto letra, ishte *telefoni me lajm-thirrje*, një shprehje që brezave të rinj sot do t'u dukej pa kuptim, sepse ka dalë me kohë prej fjalorëve të shqipes.

Mund të ketë pasur dhe letra të tjera dashurie, por të ruajtura janë vetëm këto. Në vitet e fundme të jetës, ndryshe prej një prirjeje sunduese të kohës, për të pajtuar të shkuarën me të sotmen, Dritëro Agolli vendosi ta certifikojë rrjedhën e jetës përmes dëshmive. Përgatiti albumet me foto, duke shenjuar edhe emrat e atyre me të cilët e kishte bashkuar ngjarja a çasti në celuloid. Sistemoi dorëshkrimet, skedat, shenjimet. Ruajti dhe nuk ruajti, *koleksionoi*

dhe seleksionoi. Ky proces na vjen në ndihmë për t'iu përgjigjur pyetjes që kemi drejtuar që në krye: ç'është ky letërkëmbim, çfarë përmban ai: letra apo letërsi? Përgjigjja është e ndërlikuar. Por një gjë mund të thuhet me siguri: edhe letra, edhe letërsi; edhe intimitet të dashuruarish, edhe *letërsi pasioni*.

Jashtë dyshimit, epistolari i Dritëro Agollit, si çdo epistolar, para së gjithash është një *trashëgimi funksionale*, *qëllimore*. Këto letra, pavarësisht nëse autori kishte në mendje edhe një lexues të ardhshëm, janë shkruar për të kumtuar ndjenja njerëzore. Në një prej letrave të Sadijes, pikërisht në atë të muajit qershor të vitit 1965, kur po i vinte fundi të jetuarit larg njëri-tjetrit, sepse vetëm dy javë kishin mbetur deri në ditën e dasmës, gjejmë një detaj shenjues për të kuptuar më mirë ndërthurjen midis letrave të dashurisë si një nevojë të shprehuri dhe letrave si art që zbut zemrat njerëzore: *Janë letrat e fundit, e kupton, s'do kemi nevojë ma për letra se do të merremi vesht tue qenë pranë dhe jo nëpërmjet postjerit shkodran e tiranas. Veç ndonjiherë kur të grindemi do të pajtohemi me anë letrash*. E megjithatë, qëllimi nuk e përjashton artin dhe arti nuk është i papajtueshëm me qëllimin. Epistolari i këtij koleksioni nuk mund të ndahet prej epistolarit brenda letërsisë, prej letërsisë në formë epistolari. Përgatitja për botim e këtij libri ishte prova më e rëndësishme për këtë. Në procesin e kalimit prej *së pabotuarës* (*ανεκδοτικος*) tek *e botuara* (*εκδοτικος*) gjithçka ndodhi krejt normalisht.

Në bisedat e herëpashershme me mamin, Sadijen, këto kohë, kemi krijuar bindjen se Dritëroi me vetëdije ka përzgjedhur çfarë ai mendonte se mund të kishte vlerë botimi, më pati shkruar Elona, Lonka, siç e thërriste me përkëdhelje i ati, në kohën që kujdeseshim për këtë botim. *Një pjesë ndoshta jo të vogël të letërkëmbimit ai ose e ka hequr, ose e ka fshehur diku. Fashikulli që përmban këto letra ishte në sirtarin e dosjeve me shenjime apo shkrime të pabotuara. Ishte shumë e kollajshme të dallohej mes morisë së dosjeve të tjera, pasi mbi kapakun e saj ai kishte shkruar me dorën e vet:*



Ballina e dosjes së fashikullit të letrave, me shkrimin e dorës të Dritëro Agollit

- Letërkëmbimi i Dritëroit dhe Sadijes nga 1964
- Letra të lexuesve
- Letra të njerëzve të njohur
- Disa shënime dhe një vjershë e pabotuar e viteve të shkollës.

Por është e çuditshme se si ai asnjëherë, në asnjë bisedë mes nesh, nuk e përmendi këtë dosje. Unë mbaj mend që, kur isha 15 a 16 vjeç, kisha shfletuar një dosje mjaft më të plotë dhe në një farë mënyre u mërzita pak kur pashë aq pak letra.

Duhet ta quajmë fat për letërsinë shqipe që Sadija i ka ruajtur *letrat e të dashtunit Dritëro* (në Shkodër madje edhe do t'ia riformonin emrin, në atë trajtë që gegërishtja e kërkonte sipas rendit të saj para se të ndodhte rotacizmi: *Dritno*). Jo vetëm për atë plotësim nënllojesh që ky letërkëmbim i bën historisë së letërsisë shqipe. Por mbi të gjitha për mundësinë që na japin këto letra për ta njohur së brendshmi botën e tij. Këto letra janë dërguar pak a shumë në kufijtë kohorë kur Dritëro Agolli shkruante poemën *Dashuri dhe ferrobeton* (botuar në gazetën javore *Drita*, 1962), ku lartësohej dashuria me vajzën e epokës industriale, thuajse e largët ndaj atyre kërkesave që në të gjitha kohërat janë njohur si përkatësi e *gjinisë së dobët*; dhe poezinë entuziaste *Mundja e Lekë Dukagjinit* (1967), një sfidë ndaj rendit etnojuridik tradicional. Por a e kemi njohur Dritëro Agollin e vërtetë përmes këtyre poezive?

Proza ime ka ngritur krye kundër entuziazmit, megjithëse edhe në poezi unë jam ruajtur nga entuziazmi. Do të thosha se kam pasur më shumë agresivitet poetik sesa entuziazëm. Brezi ynë në poezi njëfarë agresiviteti e ka pasur të huazuar nga futurizmi përmes Majakovskit. Me këtë agresivitet ne shpesh arrinim deri në

portat e post-futurizmit. Në prozën tonë ky agresivitet u zëvendësua me ironinë dhe me humorin e zi, që janë karakteristika të prozës moderne.

Kështu e përshkruan Dritëro Agolli raportin e letërsisë së vet me një prej kanuneve më të rreptë të realizmit socialist: optimizmin. Por kësaj çështjeje do t'i rikthehemi edhe një herë në vijim. Ne këtu, në trajtimin e raportit midis dëshmisë shkrimore, siç janë letërkëmbimet, dhe dëshmisë letrare, artit të fjalës së bukur, do t'i referohemi konceptit aristotelian për atë që ai e quante *orthos logos* (gr. *ορθώς λόγος*) apo *kata ton orthon logon* (*κατά τον ορθών λόγων*), me kuptimin *arsye e drejtë*, *mendim i drejtë*, sipas së vërtetës, që na lejon të bëjmë dallimin në statusin kategorial midis letërsisë së *dëshmisë* dhe asaj të *krijimtarisë*, midis *shkrimeve* dhe *letërsisë*, duke përshirë krahasimin e tyre për të vërejtur si qëndrojnë ndaj njëratjetrës në dallim e ngjashmëri.

Do t'i lejojmë vetes madje të bëjmë një *zgjedhje tendencioze*, sepse lexuesi i sotëm, sidomos lexuesi paragjykues, që e njeh të shkuarën kryesisht prej refuzimit, beson vetëm duke i parë të vërtetat përmes kontrasteve. Është një zgjedhje tendencioze sepse kufijtë kohorë të letërkëmbimit të dashurisë të Dritëro Agollit nuk përkojnë vetëm me dy poezitë e zgjedhura për krahasim. Për më tepër, ato përkojnë me një pamje tjetër të lirikës së tij të dashurisë, që mund të cilësohet si një stinë poezie lirike plot finesë. Ne nuk mund të nxjerrim nga mendja se pikërisht në vitet 1960-1965 Dritëro Agolli shkruante poezitë e mrekullueshme lirike me vlerë antologjike, si lirika *Kjo grua që bie erë çokollatë* ose poezia *E bukur*, që mund të quhet karakterin e një shpalljeje të kuptimit për të bukurën si kategori estetike, ku gjejmë dyvargëshin *E bukur, tokësore, e thjeshtë, lozonjare / E tillë për mua je ti*; për t'u mjaftuar hë për hë me vargjet nga poezia *Malli*, nga e cila, sa për kujtesë, zgjodhëm:

Hëna brirët lan në lumë, uji yllin e spërkat,
Unë sillem nëpër shelgje sonte natën fillikat.

Ndërsa nga poezia *Për kujtim* (shkruar më 1963), për të njëjtin qëllim, mund t'i kujtohen lexuesit të sotëm vargjet e mëposhtme:

Unë tregoj histori të bukur,
Ti bëhesh si foshnje kureshtare,
Shikon me faqe të skuqura,
Dhe hesht e humb fare.

Ndryshe prej kësaj pamjeje të lirikës së tij, dy poezitë që do të krahasohen me letërkëmbimin: *Dashuri dhe ferrobeton* dhe *Mundja e Lekë Dukagjinit*, të cilave do t'u referohemi në vijim, për efekt kontrastues, duke rrezikuar madje edhe prekjen e atij kufiri që njihet me idiomën e anglishtes *to use or to abuse*, janë një ndërthurje e lirikës me epizmin historik që kërkonte koha.

Dritëro Agolli na e ka dhënë vetë shpjegimin pse këto dy pamje të lirikës së tij kanë specifikat e tyre: sepse *koha kërkonte më shumë këngën e lirisë*.

Kemi zgjedhur jo pa tendencë ta bëjmë krahasimin të denjë për bindje jo për lexuesin mendjekthjellët, por para së gjithash për mendjet kontestatore. Nuk është këtu qëllimi as të vlerësohet, as të rivlerësohet poezia lirike e Dritëro Agollit, recitative apo vetjake qoftë. Në një të ardhme epoka do të identifikohet me vargjet e tyre. Çështja është jo të modernizojmë poezinë e tij, por ta lexojmë atë në kontekstin më të besueshëm, në kontekstin e gjithë çka shkroi pena e tij. Sa për të mundësuar lehtësimin e dilemës sonë, le të na lejohet që këtu të bëjmë një paraqitje paralele të një fragmenti nga poema *Dashuri dhe ferrobeton* me një prej letrave të tij të dashurisë të këtij koleksioni që kemi përmendur (vitet 1964-1965), dhe lexuesi vetë le të mendojë e të vendosë lirisht, ndihmuar prej konceptit aristotelian, se cili nga tekstet është *orthos logos*:

Dashuri dhe ferrobeton (1962)

Këtu nuk merren me kotësira erotike,
Që bien erë parfum të modës së vjetër.
Këtu ka front
Dhe fronti ka frymë epike:
Beton,
motorë,
tela,
tunele,
gurë të egër.
Këtu nuk ka biseda të vakëta:
"Më lejoni të njihemi!"
"Pardon!"
"Diku ju kam parë!"
"Pupu, ç'ju shkon kjo jakë, kjo kravatë!"
"Oh, ç'novelë dashurie!
Kam qarë!"
Këtu gërhet,
gërvisht,
gërmon kompresori
Dhe vinçi kovën me beton e hedh në digë.

Letër dashurie Sadijes (1964)

Nuk e di se ç'ka ndodhur me mua. Në moshën e Krishtit unë të bëhem kaq i papërmbajtur në çfaqjen e ndjenjave të mia? Mjafton të qëndroj pakëz në vetmi e të jepem i tëri pas teje. Kurse kur jam me shokët nuk e kam mendjen në muhabetin e përgjithshëm. Më thonë se paskam ndryshuar kaq shumë sa s'njihem. Unë nuk kam qejf të ndryshoj natyrën time, prandaj ngushëlloj veten, duke menduar se shokët, meqë dinë historinë time me ty, gabojnë në gjykimet e tyre. Po ç'është e vërteta

unë u jap të drejtë atyre, se diçka ka ndodhur. Në mesditë të jetës dashuria qënka e çuditshme. Dua që në këtë çast të jem me ty. Ti të rrish karshi meje, të flasësh, të qeshësh. E di ti se më pëlqen qeshja jote? Ti qesh fare, fare. E sheh si është natyra e njeriut e dyfishtë? Unë në tregime e në vjersha jam shumë i përmbajtur, apo jo? Edhe në shkrimet e dashurisë bile jam i përmbajtur. Po kur nis të të shkruaj ty, e humb gjakftohtësinë. Adio, gjakftohtësi, armë e shkrimeve të mia!

Dritëro Agolli është nga të rrallët shkrimtarë shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX që kurrë nuk e shkriu veten tek *ne*-ja kolektive. Përkundër kërkesave të kanunit të realizmit socialist, ai i qëndroi besnik *un*-it, madje deri në kufijtë e sfidës, në kufijtë e rrezikut për t'u qortuar për egocentrizëm. Por ne kemi njohur vetëm shfaqjen publike të *un*-it të Dritëro Agollit. Nuk e kemi njohur ende edhe shfaqjen intime të këtij *un*-i. Këtë do të na e mundësojë libri i letërkëmbimit *Dashuri në moshën e Krishtit*, titulli i të cilit është nxjerrë pikërisht nga letra e cituar më sipër: *Nuk e di se ç'ka ndodhur me mua. Në moshën e Krishtit unë të bëhem kaq i papërmbajtur në çfaqjen e ndjenjave të mia?* Dritëro Agolli gjithnjë është çmuar për një letërsi të sinqertë, por në këtë libër do të gjejmë një Dritëro edhe më të vërtetë, më të drejtpërdrejtë, më dëshmues për botën e tij të brendshme, më *orthos logos*, sipas konceptit aristotelian. Kjo na mundëson të verifikojmë edhe çështje deri-diku me karakter teorik, që kanë të bëjnë me censurën, autocensurën dhe me atë përbërëse të pashmangshme të procesit krijues në shoqëritë totalitare, që George Orwell do ta quante *The Prevention of Literature*, më saktë, *censura parandaluese, profilaktike*. Dhe, më së fundmi, do të na ndihmojë të gjejmë një përgjigje edhe për pyetjen se deri në ç'skaj shkon liria e Dritëro Agollit, si njeriu i letrave dhe i

letërsisë. Por sërish le t'ia lemë lexuesit në dorë të gjykojë se në cilin tekst ai vetë gjen Dritëro Agollin *orthos logos*:

Mundja e Lekë Dukagjinit (1967)

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin
E fjalë këmbeva në malet me fletë,
Po Lekë Dukagjini ishte trim e bir trimi
Dhe s'mundej dot lehtë...
Po Lekë Dukagjini nuk ishte Leka i Lecit,
Që bën njëqind lëshime në punë;
Lekë Dukagjini i rrepti i të rreptit
Ma tundte para syve kanunë
Dhe gjëmën lëshonte si shkëmbi kur bie në përrua:
O mbaje gruan kështë si them unë,
O lëre gruan, se s'je për grua!

Grua, për ty u zura me Lekë Dukagjinin,
Se donte lëshime nga unë.
Pritë në male njëri-tjetrit i zinim,
Ai mburrte kanunë, unë shaja kanunë.
"Eh, gjysh, ti je hedhur për gratë në flakë,
Po pse në kanun i ke sharë?
Eh, gjysh, ti gruan tënde s'e ke dashtë pak,
Pse mua që e dua më quan të marrë?"

Një ditë kanunin ia mora nga dora
Dhe copë ia bëra mes malesh të lartë.
Iu drodh ajo mjekër e bardhë dëborë
Pas çetinës së lashtë...
Dhe unë thirra:
E munda Lekë Dakagjinë!

(Natyrisht e munda kanunë;
I heq kapelën për trimërinë;
Ka qenë trim si furtunë...)
Ti, grua, më pyete e sytë të ndrinin,
Më pyete ngadalë mënjanë:
"Vërtetë e munde Lekë Dukagjinin?"
Dhe unë të thash: e munda, po sytë ç'më panë!

Letra dashurie Sadijes (1964)

... Sot nisem në Rrëshen me urgjencë. Dje më telefonoi Ramizi për të gjetur ca valutë, por nuk munda dot të kërkoj sepse më duhej me doemos të nisesha. Kur të kthehem përsëri në Tiranë medoemos do të gjej aq sa ti kërkon, veçse kam frikë se mos i deshe shumë shpejt.

... Po të dërgoj me Jani Toçkën 2500 lekë valutë. 500 pas tri-katër ditësh. Më fal që i vonova, po nuk kam eksperiencë në punë të tilla, se nuk jam marrë kurrë me to.

... Këtë radhë në Shkodër të kam dëshpëruar. Edhe me ato paret të kam dëshpëruar! Jo se ato në vetëvete kanë ndonjë rëndësi të madhe, po se kanë të bëjnë me kujdesin tim për ty. E di që duhet të jem më i kujdesshëm. Po unë kam bërë gjithnjë një jetë bohemi e nuk i kam vënë rëndësi kujdesit dhe etiketës.

... Këto ditë i kam shkuar të zbehta, bile fare të murrme. Kam dëgjuar shumë thashe-theme e shpifje të liga, jam zënë e gati sa s'jam rrahur.

... Ti më thua që unë të bëj një kostum. Më duket se s'ka ndonjë rëndësi. Dramaturgu dhe poeti i dëgjuar francez Korneli nuk i jepte asnjë rëndësi veshjes dhe delte jashtë si të mundte. Kur një miku i tij desh ta kritikonte për këtë, ai iu përgjegj: "Mos vallë kështu jam më pak Kornel?" Me këtë nuk dua të justifikoj veten. Sidoqoftë po të duash ti edhe kostumin mund ta bëj. Unë nuk dua që ty të të bëjnë me nerva. Bile mendoj që edhe ato dreq shënja (shënja quhen?) t'i dërgoj. Veç ty mos të të mërzitin.

Ndërlikimin njerëzor, këtë luks shpirtëror që nuk mund ta gjejmë me lehtësi tek shkrimtari, cilido qoftë, tek Dritëro Agolli na e lehtëson ta vërejmë në gjithë regjistrin e ndryshimeve të tij letërkëmbimi që gjendet në këtë libër. Nëse do të na kërkohej të shihnim brenda *un*-it të tij përmes letrave, aty, edhe po të mundoheshim, nuk do të gjenim asgjë brohoritëse, të

ngjashme me madhështimin letrar të epokës. Në të kundërtën, letërkëmbimi është i mbushur me trishtim njerëzor, me zymtësi, me pikëpyetje të mëdha për jetën, madje edhe me dëshpërim, *mëkatin e palejueshëm të letërsisë optimiste socialiste*. Letërsia e Dritëro Agollit është një dëshmi e katërciptë se poezisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX nuk i kanë munguar motivet metafizike: vdekja, trishtimi, vetmia, humbja e perspektivës, pesimizmi shpirtëror, sikundër është pohuar. Ajo letërsi mund të ketë shumë pikëpyetje, por së paku nga ky qortim e ka shpëtuar letërsia e Dritëro Agollit. Nuk ka një poet tjetër shqiptar që të ketë shkruar kaq shumë për vdekjen, dhe kjo nuk ka ndonjë lidhje me moshën. Ishte viti 1964 - atëherë vetëm 33 vjeç - kur ai shkroi poezinë *Mund të mendojmë*, ku gjendet dhe kjo strofë:

Nuk jemi të përjetshëm, po zbardhemi,
Dhe vitet po na shkojnë një nga një,
Nesër nga kjo botë do të ndahemi,
Do na përcjellin me lot e pa zë.

Mund të thuhet gjithashtu se nuk ka një letërkëmbyes tjetër të krahasueshëm me Dritëro Agollin, që të jetë shpërfaqur aq hapur dhe rrezikshëm në përjetimet e tij të brendshme. Një përjashtim mund të bëjnë vetërrëfimet e Fan Nolit në autobiografinë e tij, pjesë e librit kushtuar 50-vjetorit të meshës së parë në gjuhën shqipe, ku, ndër të tjera, përmenden edhe çastet e dobësisë së tij: përveç inatit për shkollën, edhe faktin që në vitin 1935, kur parandjeu se vdekja po i vinte rrotull, nuk ngurroi të kërkonte ndihmë edhe nga kryerivali i tij Ahmet Zogu - t'i jepeshin pagat e prapambetura si deputet i përjetshëm, siç ishte vendosur në vitin 1923 - për të përballuar shpenzimet e spitalit.

Dritëro Agolli, megjithëse nuk i ngjau aspak brezit të vet krijues sa i takon shpirtit të pranishëm në poezi, gjendjeve metafizike brenda saj, e dinte mirë se çfarë i kishte munguar lirikës

shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX: *Brezi i ri i poetëve tendencën sociale dhe vështrimin e historizmit duket sikur e ka dobësuar. Më shumë ai shpreh dilemat shpirtërore, kërkimin e pafat të dashurisë, natyrën dhe stinët e vitit. Tani për tani unë mendoj se kjo është pozitive, pasi poezisë sonë në përgjithësi i ka munguar fryma intime e dalë nga labirinthet e shpirtit. Le të plotësohet poezia jonë edhe me këtë frymë. Me një fjalë, si pa kuptuar, mungesa disi e shpirtit në poezi, ka sjellë temën intime prej poetëve të rinj. Kjo ka ardhur edhe nga mërzitja ndaj poezisë me përmbajtje tepër sociale*, ka pohuar ai në një shenjim tjetër.

Letrat e Dritëro Agollit janë dëshmuese për Njerinë, që udhëton i menduar, që gdhihet e ngryset, që trishtohet e gëzohet, për Njerinë që ka dalë jashtë *zonës bardhë-e-zi*. Sepse trishtimi e dëshpërimi, zymtësia e lëngimi i brendshëm, janë po aq të ligjshëm brenda njeriut sa dhe besimi në një utopi dhe inkurajimi prej një ideali:

Piva duhan dhe vura Sonatën e 8-të të Beet'hovenit. Ajo të pëlqen edhe ty. Më shumë ndjehet, kur je vetë e kur ke në shpirt pak trishtim.

Tërë rrugës kam qënë i dëshpëruar dhe asgjë nuk mund të më zbaviste. Në Milot nga hutimi humba ombrellën. Nuk ka gjë, shkoi dhe ajo të kërkojë të tjerat.

Kam qënë shumë i dëshpëruar dhe kam pasur shumë nevojë për ty. Krejt i vetmuar kam qënë. Kushedi sa tavolina kam goditur me grusht.

Në letërkëmbimin midis Dritëro Agollit dhe Sadijes, parë në rrafshin njohës, në rrafsh antropologjik, studiuesit do të gjejnë të dhëna parësore dhe krejt të besueshme për *anën tjetër* të asaj dekade që dikur njihej me emrin *periudha e revolucionarizimit të*

gjithanshëm të jetës së vendit. Prej afro tri dekadash kjo periudhë është quajtur si rrafshuesja e individualiteteve, e uniformizimit fizik e shpirtëror të njerëzve, e shndërrimit të tyre në anonimë, të shenjuar në figurën e *vullnetarit, ushtarit, montatorit, fillrojtësit, mekanikut, mjelëses*. Por letrat që Dritëro Agolli dhe Sadija kanë këmbyer mes tyre janë një dëshmi se individi, jo cilido individ, por ai që kishte fuqi shpirtërore e pavarësi karakteri brenda vetes, e ruante me kryeneçësi, madje me fanatizëm, thelbin e vet, të kushtëzuar nga tradita, nga familja, nga kultura vetjake, nga bindjet dhe deri diku edhe nga indiferenca ideologjike.

Letërkëmbimi i Dritëro Agollit me Sadijen nuk është si ai i rastit të G. Flaubert-it, letrat e të cilit përbëjnë ndoshta arritjen më të lartë estetike të këtij nënlloji të shkrimeve. Jo për arsye njohjeje a jetëshkrimore, por për shkak të leximeve si letërsi, korrespondenca e G. Flaubert-it ka njohur dhjetëra botime (Yvan Leclerc, *Les éditions de la correspondance de Flaubert*, Paris 2001). Letrat e Dritëroit për Sadijen dhe ato të Sadijes për Dritëroin janë para së gjithash dëshmi jete, ku, me ngjarjet vetjake të të dyve, ndërthuren marrëdhëniet me krijimtarinë dhe pamje të një rëndësie parësore të asaj që njihet si *etnografia brenda shtëpisë*. Antropologët me siguri do të gjejnë në këto letra lëndë të pazëvendësueshme jetësore për të krahasuar gjurmën bektashiane të formimit të Dritëro Agollit me shenjat e dukshme të të njëjtit rend tradicional-fetar me të cilin lexuesi është takuar fillimisht tek romani *Njeriu me top* dhe pastaj më vonë edhe tek romani *Arka e djallit*. Po aq me rëndësi referenciale do të jenë për ta dhe letrat e Sadijes, në të cilat rendi dhe rregullat e besimtarëve muhamedanë të Shkodrës na bëjnë të mendojmë në mënyrë kritike për një qëndrim gati-gati eufematik ndaj *Kanunit*, që në kohën e sotme nga disa studiues po paraqitet si një *traditë përjashtimisht e krishterë* dhe për një rend me *karakter republikan*.

Studiuesi, qoftë ai i letërsisë, qoftë etnologu apo antropologu, janë *lexuesi i tepërt* i këtij letërkëmbimi. Kjo mund ta pengojë

atë që të ruajë baraspeshën ndërmjet Dritëro Agollit narrator dhe Dritëroit të dashuruar, ashtu sikurse mund ta prishë këtë baraspeshë edhe në rastin e letrave të Sadijes, në një drejtim të kundërt. Kjo ka një shpjegim edhe prej së jashtmi: personaliteti i letërshkruesit e sugjestionon studiuesin të mbivlerësojë njërën anë, njërën përbërëse (narratorin) apo tjetrën (kumtuesin, dëshmuesin), gjegjësisht shkrimtarin dhe letërshkruesin, Dritëroin dhe Sadijen. Por nuk na lë të gabojmë pikërisht *etnografia brenda shtëpisë*, aty ku edhe shkrimtari është pjesë e fakteve jetësore, e fakteve që nuk ndahen dot prej jetëshkrimit të tij. Vetëm raporti mes shkrimtarit dhe *plakut*, babait, me të cilin ishte bashkuar e njësuar në poemën *për babanë dhe për veten* dhe të cilit në letra ndonjëherë i merr borsalinën e herë tjetër i ndjen së thelli pamundësinë për të gëzuar jetën; apo raporti me Xhexhenë, së cilës i kishte dedikuar poezinë *Nëna ime, e bukura Hatixhe*; do të ishin një argument i mjaftueshëm për vështrime të thelluara sociologjike dhe kulturologjike. Shumë janë marrë studiuesit me rishtarinë dhe me statusin e nuses së ardhur rishtas prej familjes prindërore në familjen e re, sidomos si *status i së huajës* në shtëpinë e burrit. Rasti i letërkëmbimit të Sadijes me shkrimtarin dhe të dhënat që na jepen përmes tij për nusen e re në shtëpinë e prindërve të shokut të jetës është më i besueshëm se çdo e dhënë prej ekspeditash etnologjike.

Ndonëse letrat e Sadijes nuk janë ruajtur të gjitha, në dialogun e saj me Dritëroin e vet ajo ka shumë personalitet dhe dinjitet, ka shumë *vetje*. Le të na lejohet t'i paraqesim sërish për lexim paralel dy letërkëmbyesit, të cilët, përmes kumteve të veta, *puthen por nuk përputhen*, duhen dhe qortohen, këmbëngulin dhe bëjnë lëshime, por gjithnjë duke mbetur ata vetë, krejt të dallueshëm si individë:

Dritëro Agolli, Sadijes

I. *Lexova një libër nga Dostojevski dhe më ka lënë pa gjumë me tipat dhe figurat e tij të tmerrshme. Një burrë tërë natën mendon para qivurit të gruas së tij, që ka vrarë vehten. Cilat kanë qënë arsyet që gruaja e tij vrau veten? Rreth kësaj shkruhet tregimi. Ka një moment të hatashëm. Burrin e ka ftuar një njeri në duel (përpara se ky të martohej). Ai refuzon, nuk pranon të bëjë duel. Të gjithë e quajnë frikacak. Pas shumë situatash gruaja e çdashuron atë. Ai është shtrirë e fle. Ajo merr revolen dhe ia vë në tëmbth tytën e hekurt. Ai hap sytë, e shikon me gjakftohtësi tytën dhe i mbyll prapë. Gruaja tronditet. Për herë të parë kupton se ky nuk është frikacak. Po si është e mundur që refuzoi duelin? Të refuzosh duelin - tha ai - kërkon më shumë burrëri!*

Sadija, Dritëro Agollit

I. *Po t'i them tashti që është fundi vetëm sa për kuriozitet dhe jo për gja tjetër: Burri duhet t'i pregadisë grues dhunti, si thohet këndej nga ne. Në dhunti bajnë pjesë këto gjana: zakonisht ato që janë me gjendje të mirë si të quejnë ty, tri palë këpucë, një palë sandale, një pardesy, një pallto, nji kostum stofi, tre fustane stofi, tre fustane të mira vere, triko, unazë, sahat. Merre me mend mor i gjori ti; s'do të martoheshe kurrë se s'do të ishje në gjendje me e pregaditë për pesë vjetë e ma shumë. Ty s'të rrijnë lekë në xhep dhe jo të blejsh këto sende. Qerimi nuk e din se ti nuk bjen asgja, kështu që nana (kësaj i kam tregue) do i thotë që ma ke lanë "dhuntinë" në Tiranë. Më 4 korrik martohet edhe vajza e tezes. Kam shumë inat se asaj i shkon dhunti dhe kushrinjtë do i shesin nanës mend. Edhe ai gazetari ... i bjen dhunti dhe sa herë nana ma ka sjellë si shembull. Po unë i thoshnja ku ai e ku Dritëroj.*

Dritëro Agolli, Sadijes

II. *Kam lexuar shumë. Dy-tri ditë përpara fillova të lexoj novelat e Prosper Merimesë, disa prej të cilave i kisha lexuar shumë vjet më parë. Në rininë studenteske ai mua nuk më pëlqente fare. Mund të them se sot më ka mahnitur. Ti do të ndjenje një kënaqësi të çuditëshme sikur të lexonje, p.sh., një novelë të gjatë të tij "Gabimi i dyfishtë", apo "Vazua etruske", "Purgatori i shpirtit", "Venera e Ilit", "Rrugica e zonjës Lukrecia", "Abati Oben", "Dhoma e kaltër" etj. Kur lexova "Gabimin e dyfishtë" ndenja deri më katër pas mesnate. Unë nuk tronditem shumë nga veprat letrare dhe jam mjaft gjakftohtë, po Merimeja më tronditi.*

Sadija, Dritëro Agollit

II. *Dritëro, po blej kostumin e banjos në valutë, kështu që nëse i thue mikut tand thueji kostum të ndame të bukur amá. Pse nuk shkruen, edhe shënime kritike nuk je i keq kur shkruen, prandaj merrem me ato. Dritëro ç'na thue ndonji gjatë re nga Tirana? A takove ndonjenën nga Elenat? Sikur të takojsh kapitenin e anijes thueji ma mirë për një kostum banje se këtu në Shkodër nuk po gjej, mundësisht të zi me një kordon të bardhë përqark thueji, gomet dhe jo najlon, po fundi çfaredo se po afrojnë ditët, ndërsa unë nuk kam kostum banjo.*

Dritëro Agolli, Sadijes

III. *Të premten u ktheva nga udhëtimi. Isha në Durrës, Lushnjë e Berat. Tërë udhës kam menduar për ty. Për të shkruar për gazetën nuk gjeta ndonjë gjë, po mbresat m'u shtuan. Kam dëshirë të shkruaj një tregim për një ngjarje që dëgjova. Takova një njeri, që kish ikur me ciganët (kurbatët). Ky ishte një vagabond interesant dhe ishte bërë pothuajse përgjegjës i ciganëve nomadë. Kish edhe një cigankë që i vërtitej. Ngjarje si e Karmenit të Merimesë, apo si "Ciganët" e Pushkinit, po*

natyrisht pa gjakderdhje. Që ta shkruash këtë duhet të njohësh ca zakone cigane. S'do ment se unë do ta shkruaj në plan humoristik.

Sadija, Dritëro Agollit

III. *Mendo për dasëm, mos mendo shumë me ardhë, dasëm pa mish dhe lek nuk ka. Ti je fishek, s'mendon fare. Do të bashkohen të gjitha bashkë dhe s'do të dijsh nga ta fillojsh. Pa pashaportizim s'ka emnim pune, prandaj më dërgo fjalë sa ma shpejt çfarë duhen si dokumenta për lutje, mos i len mbas dore ... Mjaft porosi të kam dhanë, mbes me shpresë se do mi kryejsh, o portret i njeriut të madh. A ta mban të shkojsh esëll me ble ato që donje t'i merrnje mbramë në atë dyqanin që pamë. Je një çikë i paturpshëm.*

Dritëro Agolli, Sadijes


IV. *Sot isha nga redaksia e "Dritës" dhe i shpura tre tregime të shkurtër. Më premtuan t'i botojnë në një numur. Janë tregime krejt të ndryshëm nga ato që botohen. Nuk e di nëse lexuesi do t'i honepsë. Mund të dalin në dritë këtë të djelë ose tjetrën. Mua pak nga pak po më bëhet një libër tjetër me tregime. Më vonë do t'i mbledh dhe do t'i botoj. Titullin librit të ardhshëm me prozë mund t'ia vë ose "Tranzit", ose "Tregime të pasagjerit të orëve të vona".*

Sadija, Dritëro Agollit


IV. *I dashtun, çfarë bane për plazhin. Ti veç një letër më ke shkrue. Sigurisht që do të kesh edhe ti shumë punë. Dashtë pa dashtë këtu tek ne po bahet dasmë e madhe. Do të vijë për vizitë gjithë personeli, nxanësit. O Zot, unë nuse, nuk e imagjinoj. Ti a po ban pregaditje apo i len për në ditët e fundit. Dritëro ban mirë të marrësh atë ditë një veturë angazhe. Më duket se kushton 1.500 lekë, pse të koritesh (turpnohesh) për këto. Duhet të vi e veshun me të bardha, se simbas fjalëve*


të të gjithëve nuk jam grue e ve. Njeriu njëherë martohet, prandaj duhet të vishet kështu - asht mendimi i të tjerëve. Shtëpisë nuk ja kemi zanë në gojë, mos dysho për këtë se gjithëmonë të shkon mendja për këto të mijtë. Sa fjalë ndëgjoj nga të tjerët, sa më randohet koka! Këtë sakrificë të vogël do ta bajmë, si thue?

Letra e Dritëro Agollit për Sadijen, që mban datën 5 maj 1965, është më domethënësja për shumicën e pyetjeve të nyjëtuara në këtë parashtrim. Këtë letër kemi pasur mundësi ta njohim në dorëshkrim, falë mirësisë së familjes: Sadijes, Elonës dhe Artanit. Është me fat studiuesi të cilit i bie në dorë një letër e tillë, që përmban tekst e mbitekst, ku gjenden edhe kumti i dërguesit, edhe gjurmët e leximit të parë prej marrësit, në formën e pikëpyetjeve, nënvizimeve dhe madje edhe të mendimeve të mbishkruara apo anëshkruara në letër. Në fakt, këtu kemi të shkrira në një letrën e Dritëro Agollit dhe një përgjigje të padërguar të Sadijes. E rrallë në historinë e letërkëmbimit, ajo na bën të mundur të verifikojmë jo vetëm receptimin e parë të përmbajtjes së saj, jo vetëm individualitetin e të dyve, por edhe deri ku çon në mospërputhje *pavarësia e karaktereve*.



Prej shenjimeve me shkrim dore të Sadijes në këtë letër, që, në shkencën e komunikimit, janë përftimet e pritësit të parë, lexuesit i bëhet krejt e qartë se ku ndryshon raporti i tij me tekstin e saj krahasuar me statusin e privilegjuar të marrësit të letrës. Si në një sizmogram, shenjimet e Sadijes shprehin gjendjet emocionale të njeriut që





gjendet i përfshirë së brendshmi në situatë. Kurse lexuesi i sotëm e përfton atë kryesisht si letërsi pasioni. Po aq sa puthen, por nuk përputhen Dritëro Agolli e Sadija në letër, po aq përtakohen e nuk takohen leximi i sotëm me leximin e pritësit të parë. E kjo është magjia e një epistolari të tillë, epistolari i shkrimtarit në dashuri.

Shkruar nga Dritëro Agolli	**Lexuar nga Sadija**
1. *E di që do të të bjerë humori, po meqë me të vërtetë kam pirë, nuk dua të ta fsheh e dashur.*	**1.** Në fund të fjalisë janë shtuar dy pikëpyetje, shenjë mospranimi e pakënaqësie.
2. *Burri yt kështu e ka ndonjëherë: rri rri dhe i jep një dërmë tronditëse trurit të vet të sëmurë.*	**2.** Vijëzim anësor për tërheqje vëmendjeje, mospajtim dhe qortim.
3. *Kam qenë shumë i dëshpëruar dhe kam patur shumë nevojë për ty. Krejt i vetmuar kam qenë.*	**3.** Anëshkrim: *O Zot, sa keq!* Mund të kuptohet edhe si bashkëndjesi, edhe si ironi.

4. *Kushedi sa tavolina kam goditur me grusht.*	**4.** Anëshkrim djathas me qesëndi: *Sa i fortë*.
5. *Merak të madh kam patur: "u shërua kjo e bekuar apo jo"?*	**5.** Vijëzim anësor, për mbitheksim, por nuk përjashtohet dhe sensi ironik.
6. *Si e pashë që ti nuk përgjigjeshe të mora në telefon. Atëherë u qetësova.*	**6.** Shenjim brenda tekstit të letrës, me ironi të dukshme dhe refuzim: *Sa qetësi!*
7. *E dashur, ky udhëtim do të jetë shumë i gjatë ... Po ty gjithnjë do të të kem me vehte*.	**7.** Mbitekst: *S'më intereson besimi*, shenjë mospajtimi dhe pakënaqësie.
8. *Kur të vij në Tiranë, me siguri do të gjej letrat e tua të dashura.*	**8.** Shenjim brenda tekstit, në vijim të fjalisë së cituar, me qesëndisje: *Çfarë mrekullije?!*
9. *Të fala të gjithëve, edhe nënës, edhe Qerimit.*	**9.** Anëshkrim: *Të faleminderit*. Shprehje ironie.
10. *Të puth shumë shumë para se të hyp në autobus.*	**10.** Vijëzim anash, për mirë.

Do të mjaftonte kjo letër për të kuptuar ndërlikimin e shumëfishtë të kësaj stine dashurie në largësi. Aty shquhet tipari i fortë i Sadijes si ruajtëse e traditave familjare, ngulmuese deri në kufirin e një konservatoreje për të mos iu shmangur rendit të trashëguar në marrëdhëniet në familje. Por në anën tjetër pikërisht Sadija është bashkëbiseduesja e parë e Dritëroit të dashuruar për problemet me botuesit dhe me redaksitë, për refuzimet dhe qortimet e tyre ndaj veprave që kërkonte të botonte në atë kohë. Dhe nuk është bashkëbiseduese vetëm si e dashura e shkrimtarit, por edhe si njohëse e letërsisë, si lexuese me shije, që herë pas here na shfaqet edhe me libra të ndaluar në duar dhe ca

më shumë si nxitëse për krijimtari, si bashkëbiseduesja për planet krijuese të tij, si kritikja dhe lexuesja e parë.

Sadija në këtë libër është protagoniste po aq sa ç'ishte dhe në jetë. Si letërkthyese, ajo është edhe bashkautore e librit. Si introduktuese e tij, ajo është njëherësh e dashuruara e përjetshme, pasionante fund e krye në një ndjenjë që e ka zotëruar dhe që u ka dhënë sjelljeve të saj të gjitha ngjyrat e shpërthimeve emocionale. Lexuesi pa dyshim do t'i jetë mirënjohës asaj për këtë libër, i cili nuk do të ekzistonte pa ruajtjen e kujdesshme të letrave në vitet kur janë shkruar e më vonë, në ato vite e dekada kur letrat i përkisnin vetëm asaj dhe ndoshta ideja e botimit ishte e frikshme. Nuk është fjala vetëm për pasurimin e letërsisë shqipe me një koleksion të shkëlqyer të letërkëmbimit intim, por edhe për mundësitë e rralla që ai ofron për të takuar problematika të ndërlikuara njerëzore, sfonde socialë, gjendje kulturore dhe raporte gati-gati të harruara fetare e krahinore.

Ndoshta në një të ardhme studiuesit nuk do të mund të merren me karakteret e letërsisë së Dritëro Agollit, në prozë e në poezi, pa një krahasim edhe me karakteret që përmban letërkëmbimi i tij me Sadijen. Dhe kjo është edhe më e vërtetë për ata që do të duan të studiojnë jetëshkrimin e shkrimtarit, të jetës së tij në familje. Kur lexuesi, në një nga letrat e Dritëro Agollit, gjen pohimin *Në mesditë të jetës dashuria qenka e çuditshme* - atëherë ai ishte vetëm 33 vjeç - nuk mund t'i shmanget pyetjes: vërtet ai mendonte se e kishte jetuar gjysmën e jetës? Menduar kështu, vetëm kjo fjali ka më shumë mbushje kuptimore se të gjitha shprehjet e përsëritura të trishtimit, dëshpërimit, zymtësisë së letrave të tij. Apo ndoshta me këto fjalë Dritëro Agolli thjesht po shërbehej me elegancë me versionin shqip të vargut të parë të tercinës së parë të *Ferrit* të Dante Alighieri-t: *Nel mezzo del cammin di nostra vita*. Nëse anojmë nga përgjigjja e parë, jemi duke lexuar *orthos logos*-in aristotelian. Por nëse midis dy pohimeve pranojmë një lidhje tekstore, të vargut të Dantes dhe të pohimit të Dritëro Agollit, atëherë duhet të pranojmë se ja ku kemi sërish një *author logos*.

IV. Letra dhe letërsi, dëshmues dhe krijues

E pashmangshme është pyetja se çfarë përfaqëson ky letërkëmbim vështruar përmes opozicionit *les letters - les belles lettres*. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje nuk mjafton individualiteti i dy letërkëmbyesve. Në njërën anë janë letrat e Dritëro Agollit, me fjalën e zgjedhur, parantezat, humorin, trillimet, përbetimet, paraqitjen e situatave, rrëfimtarin, reporterin, lartësimin e virtytit dhe hapjet e befta për mëkate të lejueshme, madje dhe për apologjinë e tyre. Në këto letra ka gjithashtu shumë të dhëna për vepra të botuara e të pabotuara, për gjykimet e tyre nga shtëpitë botuese dhe kritika, për ndryshimet që shkrimtari u ka bërë në proces e sipër. Por nuk është kjo arsyeja parësore për të hapur çështje të karakterit terminologjik e mbase dhe epistemologjik: *letra apo letërsi*, *epistolar apo letërsi pasioni*, *dëshmi apo narracion*, kumt dhe trill, *orthos logos* dhe *author logos*. Në anën tjetër janë letrat e së dashurës, Sadijes, të mbushura me këshilla se si të sillet me familjen e saj prindërore, si të ruajë paratë për të blerë *shênjat*, pse duhet që dhëndri të sigurojë fustanin e bardhë dhe të gjejë vendin e pushimeve, pse pija është diçka mëkatnore dhe si duhet të lejohen të sajët që, kur të jenë mysafirë në familjen e tyre të re, të bëjnë faljen në orën e caktuar. Dy letërkëmbyes mjaft të ndryshëm: njëri që përdor fjalën për të hetuar brenda njeriut dhe tjetri që mbi të gjitha ka përpara përmbushjen e traditës: vajza e fejuar duhet të dalë nga shtëpia e prindërve me të gjitha tagret që i takojnë, asgjëmangut riteve, asgjëmangut nderimeve që u janë bërë prej dhëndurëve të tjerë në atë familje. Dy letërkëmbyes të ndryshëm edhe në një aspekt tjetër. I pari, shkrimtari, megjithëse rrëfen ndodhi e gjendje nga më të ndryshmet, pagën nuk e përmend kurrë, por vazhdimisht mallkon botuesit që nuk po ia japin honoraret.

Prej tyre varet se kur do të blejë *lekë valutë* për të blerë veshje të zgjedhura për nusen e ardhshme; prej tyre varet dhe kur do të rezervohet dhoma e pushimeve pas dasmës, prej tyre varet kur do të porositet fustani i bardhë dhe kostumi i dhëndrit. Kurse e dyta, e dashura, e fejuara, siç dhe kemi mundur ta vërejmë, me atë sedër që i kërkon nderimi i traditës, mbi të gjitha nderimi i asaj tradite që ka njohur familja e saj prindërore, vazhdimisht e porosit që të mos harrojë detyrimet e tij si dhëndër për *shënjat*, *shënjat e mallkuara* ose *shënjat e bekuara*, siç i quan shkrimtari, varësisht prej situatës.

Parashtrimi ynë është një ftesë drejtuar lexuesit që të hyjë me denjësi në një botë të rezervuar, e cila deri me sot kishte mbetur e mbyllur dhe e fshehtë për ne, shpesh e keqkuptuar dhe edhe më shpesh e penguar në komunikim, jo rrallë e paragjykuar përsa u përket çështeve intime në letërkëmbim dhe dimensioneve të tjera *shtesë* të një *letre-opus*, shkruar herë pa vramendjen e kthimit në dokument publik dhe herë me qëllime diskrete, kinse si personale, por për të lënë një gjurmë të gatshme për botim, siç është dhe rasti i këtij epistolari, që na jep mundësi për të njohur më mirë se sa e brishtë, por edhe e plotë është bota që na vjen nga *letrat intime*.


Në këtë parashtrim jemi mbështetur në *të drejtën cezariane* që na vjen prej shembëlltyrës së Jezusit me monedhën perandorake, për t'i dhënë autorit atë që i është dukur më e drejtë dhe lexuesit atë që autorit (*author / ortho logos*) i është e arsyeshme dhe e menduar mirë (*orthos / author logos*) të shfaqë, të manipulojë, të fshehë, të tregohet viktimë dhe të qesëndisë apo edhe të bëhet *vetëreferues*.

Dritëro Agolli ishte 33 vjeç kur i shkruante këto letra, në një moshë gati dy herë më të madhe se e dashura. Ai e kishte provuar një herë një dashuri pasionante: Nina, rusja e rikthyer në atdhe pas ngjarjeve të viteve 1960, në kohën e letërkëmbimit, do të ishte

gjithnjë një dyshim i heshtur në lidhjen e re. I heshtur sepse, me një elegancë të admirueshme, as njëri, as tjetri, nuk e përmendin kund drejtpërsëdrejti historinë e dikurshme. Thjesht rreth e qark vërtitet pyetja për të gjetur një shkak pse njeriu duhet të lëshohet në pije, dhe më tej përgjigjja: *Nuk kam asnjë shkak që të dehem*. Dhe për më shumë siguri: *Ç'budallaqe bëhesh ndonjëherë ti, Sadije! Mendon se unë pi "për të harruar ndonjë kapitull tjetër të jetës sime!" Për këtë asnjë dyshim s'duhet të kesh. Në botë ka vetëm një njeri që unë dua: Sadija*.

Mund të supozojmë se Dritëro Agolli kishte pasur dhe një letërkëmbim dashurie të mëhershme. Në Shën Petërburg kishte jetuar si në një metropol dhe e dinte mirë se ç'ishte një letër për atë shoqëri ku gjendej: atje letrat ishin kult. Është dhe kjo një arsye për të mos u çuditur kur e takojmë Dritëronë ashtu siç na vetëshfaqet në letërkëmbim, jo vetëm shkrimtar dhe mjeshtër i fjalës, por dhe burrë me përvojë, i rafinuar, i zoti për t'u paraqitur si të ishte gjendja: krejt i bindur, madje dhe i nënshtruar; konformist dhe lajkatar; i përbetuar në dashuri, të thuash devocioni vetë, po aq sa dhe finok, përligjës, hileqar, djallëzor, pa e vrarë shumë mendjen se ndonjëherë mund të ishte edhe kundërthënës me veten. *Loja* e mjeshtrit është e papërjashtueshme nga letërkëmbimi dhe në të njëjtën masë *letërsia e pasionit* është krejt e pranishme brenda tij.

Të gjitha këto i japin letërkëmbimit deri-diku dhe pamjen e një ushtrimi stilistik, më shumë krijimtari se letra, më shumë letërsi se kumte për një pritës të vetëm. Ne mund ta konsiderojmë atë tashmë si *letërsi pasioni*, pavarësisht se në krye të herës pa dyshim kishte karakter epistolari. Pikërisht kjo, parakuptimi jo i *një pritësi të vetëm*, por i *një shumësie pritësish*, i bën ato letërsi për të tjerët dhe letra për Sadijen.



Ballina dhe një nga letrat e shkrimtarit Albert Camus drejtuar Maria Casarès.

Për të mbërritur në një bindje të vërtetueshme duhen argumente që kërkojnë vështrime *mikroskopike* dhe *makroskopike*, brenda letërkëmbimit dhe jashtë tij, në jetën vetjake të autorëve dhe në jetën e shoqërisë, në korrespondencë e në letërsi, në përvojën shqiptare dhe në atë botërore. Një trajtim i ngjashëm i është bërë në opinionet letrare franceze letërkëmbimit të shkrimtarit Albert Camus me të dashurën spanjolle Maria Casarès ndërmjet viteve 1944-1959, botuar këtë vit nga *Gallimard*. Ka dhe një simetri tjetër midis dy letërkëmbimeve. Të dyja letërkëmbyeset i shmangen gjuhës së njësuar. Sadije Agolli shkruan në dialektin e shqipes veriperëndimore, ndonjëherë edhe me ndonjë leksemë që duhet të shpjegohet me yllkë për lexuesin e zakonshëm (shqipja letrare nuk ishte njësuar ende); kurse Maria Casarès shkruan frëngjishten e një të huaje, shpesh me gabime morfologjike e sintaksore.

Letra apo letërsi? Qëllim apo art? *Letra është një shprehje e çastit.* Ky është mendimi i Dritëro Agollit për letrat intime, kështu i shkruan më 1964 së dashurës. Mirëpo, nëse do ta nxirrnim jashtë kontekstit të një letre të tillë fragmente si ky i mëposhtmi, lexuesi më shumë do të mendonte për një monolog të ndonjë karakteri në një vepër letrare se për një letër dashurie:

Gjithnjë trurin e kam të kurdisur. Ndofta nga të tëra këto andralla truri nuk më çkurdiset as natën dhe kam një pagjumësi të bezdisur, që meriton mallkim. Siç duket nga pagjumësia ngrihem në mëngjes i hutuar. Nga ky hutimi im i përjetshëm dje u turpërova në rrugë. U përplasa me një grua që kish blerë një tas kos tek një privat që e kemi në mëhallë. U përplasa dhe, o Allah, gruas i ra kosi para këmbëve të mia. Tasi u thye dhe pantallonat e zeza të mia u bënë me pikla kosi të bardha. Një breshëri fjalësh të rrepta u derdh mbi mua nga goja-mitraloz e asaj gruaje. Xhexheja nuk ishte që të m'i fshinte pantallonat dhe u mora vetë me këtë punë, që nuk është aq e këndshme. Ja se ku të shpie pagjumësia!

Pyetja që ne i kemi drejtuar vetes duke lexuar letrat e Dritëro Agollit, shfaqur e zhdukur në një periudhë prej dy vjetësh, është: kush shkruan, i dashuruari apo njeriu i letrave? Dëshmitari apo autori? *Orthos logos* apo *Author logos*? Dhe më tej vjen pyetja: letërshkruesi kumton apo krijon? E para të shpie tek qëllimi, e dyta tek arti. Dhe të dyja, po sipas konceptit aristotelian, aq sa dallohen, aq dhe janë bashkë, sepse në fund të fundit në çdo fjalë ka të vërtetë (*ουδ' εξ κενός ορθού λόγου*).

Nuk është e mundshme të përjashtohet asnjëra përbërëse. Dritëro Agolli shkruan herë si dëshmitar, herë si shkrimtar. Kjo nuk ka pse të na çudisë. Tek e fundit, a nuk është ai një shkrimtar i dashuruar? Dhe, le ta themi edhe këtë: a nuk ishte një *shkrimtar i dashuruar*, me një përvojë dashurie, që mund t'i bashkonte lehtësisht *mjeshtrin* dhe letërshkruesin spontan. Le të krahasojmë dy letra:

Kumtim (*Orthos logos*)

E more vesh? Shoqja jote, Elena e Ismailit, bëri çupë. Të atin e çupës e urova. Ende nuk e di rëndësinë e babajt i gjori Isha nga Ismaili për të uruar çupkën. I shpura edhe një lodër, po, në vend që të lozë çupka, me atë do të lozë e ëma, se është për të mëdhenj, siç duket.

Shkruar në formën e trillit (*Author logos*)

Në Fushë-Krujë shkuam në një teqe. Ishte një vend i bukur. Unë dola në fotografi me një dervish me mjekër të gjatë. Patjetër do të ta dërgoj kur ta shtampos. Donja të hanja drekë me dervishët, po kuzhinieri-dervish ishte pis e i kishte thonjt me baltë.

Për të verifikuar saktësisht çfarë na ofron teksti i autorit në dobi të një përgjigjje të saktë, referuar antinomisë së mësipërme, që dallon tekstin kumt (*orthos logos*) prej tekstit trill (*author logos*) mund të zgjidhnim lehtësisht për krahasim prej një vargu argumentesh që na ofron bujarisht letërkëmbimi: për shembull, dallimet në qëndrim ndaj traditës dhe mbijetesës së saj, dallimet për kulturat e vendeve të lindjes, xhelozitë e papërjashtueshme në çdo lidhje dashurie, mbase dhe prej ndryshimeve në moshë; qëndrimin ndaj parasë, joshjet e jetës, respektin për ceremonitë dhe ritet, besimin dhe bestytnitë. Nuk do të ishte e vështirë që krahasimi të bëhej përmes gjendjeve të vetëpërmbajtura të xhelozisë (frika e humbjes së dashurisë është vetëm një tjetër formë, më e kontrolluara, e saj), që shfaqen në letrat e Dritëroit, xhelozi që mund të kishte lidhje po aq edhe me parahistorinë e dashurisë. Por ndër rreshta aty për aty nxjerr flakë dhe xhelozia e Sadijes për Dritëroin, shkrimtar e reporter, i sapokthyer nga një metropol kulture, njeri i famshëm, me shumë admirues, shkrimet e të cilit botoheshin në një tirazh të përditshëm më të madh se ai i të gjitha gazetave të sotme të marra së bashku. Por preferuam një çështje, vetëm njërën prej tyre, jo vetëm pse ka qenë gjithnjë

e përsëritur në letrat e Dritëro Agollit dhe të Sadijes: pija, rakia si një tabu; por dhe sepse është një çështje lehtësisht e përftueshme prej lexuesit pak a shumë përtac. I pari i ardhur prej një mjedisi bektashi liberal nga Devolli, e dyta e formuar në një familje ku lutjet bëheshin pesë herë në ditë; i pari i rritur me ritualin e dollisë, me nderimin e mikut me shëndete e mirësi; e dyta me dy ndalimet e rrepta të myslimanëve fanatikë shkodranë sipas librit të bukur *Kur'an*.

Shkrimtari, për të shtendosur gjendjen, i bën të gjitha: nënshtrohet, premton, dredhon, qorton rregullat, argumenton pse burri duhet të pijë, mburret me zotësinë për ta mbajtur dollinë, qesëndis shkodranët që *e humbin toruan edhe duke pirë vetëm ujë dhe megjithatë orë e çast i sheh në banjë*, rebelohet ndaj thashethemexhinjve, mbrohet prej tyre, dhe, në fund, kur e humb durimin, mburret edhe më shumë me rekordet e veta në pije. Kjo nuk duhet aspak të na çudisë. Nëse do të krahasonim letrat e Dritëro Agollit me poezitë (nga të paktat poezi) të E. Hemingway-t për konjakun, do të vërenim se midis dy shkrimtarëve ka diçka të përbashkët në këtë parapëlqim e mbase edhe pasion. Hemingway shkruante këto vargje për pijen e tij të dashur:

I'm off'n wild wimmen
I'm off'n wild wimmen
An Cognac
An Sinnin'
For I'm in loOOOOOOve.

Me siguri Dritëro Agolli do të pajtohej krejt me formulimet e njohura të shkrimtarit amerikan: *I drink to make other peoples interesting*; *My only regret in life is that I did not drink more wine*; *The wine is most civilized thing in the world*; *An intelligent man is sometimes forced to be drunk to spend time with his fools*; *Always do sober what you said you'd do drunk: that will teach you keep your mouth shut.* Këtë bindje na e përforcon edhe krahasimi me

letërsinë aforistike tashmë të botuar të Dritëro Agollit. Por ja dhe disa versione të shqipëruara të urtësive të Ernest Hemingway-t për pijen dhe dehjen, përkthime-dhuratë që ia dimë për nder mikut tonë, poetit dhe studiuesit Arian Leka (duke përfshirë dhe përkthimin e poezisë në vijim dhe mjaft sugjerime p*ër thellim n*ë leximin e letërkëmbimit), që gjithashtu i bën të ngjashëm aq shumë dy shkrimtarët: *Një burrë i mençur nganjëherë duhet të jetë tapë për t'u takuar me marrëzinë e tij; Shkruaj i dehur, redakto esëll!*

Dritëro Agolli dhe Ernest Hemingway përafohen edhe prej shumë faktesh të tjera jetësore dhe qëndrimesh intelektuale. Të dy ishin reporterë që krijuan imitues dhe shkolla gazetarie. Të dy kishin të njëjtën qasje ndaj Luftës së Dytë Botërore, para së gjithash si shkatërrimtare e vlerave të njerëzimit dhe vetë më pas edhe si fitore antifashiste. Të dy është vështirë të mund t'i përfytyrosh pa cigaren e ndezur si një zgjatim i gishtave të dorës, madje si një *gisht i shtatë*, sepse gishti i gjashtë për të dy ka qenë lapsi, *lapsi që nuk të le kurrë në baltë*, siç shkruan Dritëro Agolli.

Dikush i ka cilësuar Dritëro Agolli dhe Sadijen me lidhjen e njohur midis Jean-Paul Sartre-it dhe Simone de Beauvoir. Dhe mund të jetë ashtu. Por një paralele më simetrike mund të jetë ajo e lidhjes së E. Hemingway-t me Martha Gellhorn. Ndryshe prej tanëve, martesa e Hemingway-t me Martha Gellhord qe thuajse gjithnjë e pasigurt. Por të dyja zonjat i bashkon diçka tjetër: një ndjenjë e padrojë për pavarësi, për individualitet, për të mos e pranuar *rrojtjen nën hijen e burrit të famshëm*. E Martha Gellhord-it është shprehja e njohur, që u kthye gati në slogan në kontekstin e Luftës së Dytë Botërore: *Make war, not love - Bëj luftë, jo dashuri*. Në vitet 1960 pacifistët e kthyen kokësëprapthi këtë slogan: *Make love, not war*. Sadija gjithashtu në letërkëmbim është gruaja që dashuron dhe urdhëron, autoriteti i saj në letra, i inkurajuar edhe prej traditës, është shprehje e një pavarësie të madhe.

Albert Camus me cigaren e tij të famshme *Gitanes* gjithnjë të pandarë nga gishtërinjtë; Ernest Hemingway gjithnjë në shoqëri me gotën dhe me udhëheqës politikë të së majtës; ndonjëherë,

gjatë ditëve të pushimit në kohë lufte madje edhe i lëshuar ndaj pijes së lirë (jo *Martel*) dhe Dritëro Agolli i ngjashëm me të dy së bashku, më së shumti na sjellin ndërmend Parisin liberal, me të cilin ishte shumë afër edhe Shën Petersburgu i viteve 1960, se *handrà*-në ruse të Moskës. Kam pasur rastin të shkruaj për letërsinë aforistike të Dritëro Agollit dhe aty mund të vërehet një paralele tjetër e mendimit të tij me thënie të njohura të E. Hemingway-n për pijen dhe çmirimin e marrëzisë (të gjenisë, mund të themi, por edhe çmendurisë).

Tani le t'i shohim përkrah njëri-tjetrit të dy *mburramanët* e pijes, rakisë, konjakut, verës, vreshtës, dehjes, me fjalën e tyre:

Ernest Hemingway, poezi

Ishte Zhaku, Ajku, Toni dhe unë, dora vetë
Që nëpër qendrën e Skios vinin vërdallë
Tri ditëve të lejës të duket me vend
Të jesh xurxull, por pishë sytë.
Të shihje si ishin bërë?! Tapë, për atë Zot, tapë.

I mirë është konjaku edhe s'është Martel.
Kyçi i këmbës ka të fshehta që veç ai i di.
Ndonjëherë i ruan ndonjëherë me ty flet.
Pas tri ditësh do kthehemi sërish në Ferr dhe kjo është arsyeja
Pse nuk ka pikë rëndësie nëse ajo që pi nuk është Martel.

Dritëro Agolli, letra

Ke ca të drejtë, po ndofta e ekzagjerojnë pijen time. Dasmat nuk quhen dasma po nuk u pinë njerëzit. Ky ka qënë zakon që në lashtësi. S'kam përse të të gënjej. Unë nuk e kam sëmundje të pirën. Mund të rri pa pirë edhe një pesëvjeçar! Po ta kisha sëmundje pijen, unë nuk do të isha i zoti të bënja asgjë. Ti e sheh se unë ditë përditë botoj. Pse, mos kujton ti se unë i pirë i

shkruaj ato? Unë nuk jam hoxhë, që të mos vë në gojë raki. Ata shkodranët e tu në dasëm u dehën me ujë. E kam zakon që në dasma të jem gazmor e të mos rri, për etiketë, me buzë të varura sikur të më ketë ngrënë macja gjizën. Njerëzit në dasma mund të rrihen, po prapë kjo nuk quhet marrëzi. Qënkan veshgjatë nga më veshgjatët ata që e kanë bërë të madhe pijen time.

Dhe më tej le të vërejmë se si letërshkruesi Dritëro Agolli, më shumë se kumtues i një të vërtete, është një *author logos*, *narrator*, shkrimtari që krijon, që nuk interesohet aq për bindjet (madje nuk kursen as qesëndisjet ndaj sloganeve dhe shprehjeve të ngurta të kohës, të cilat në një letër i quan thjesht *parulla kubaneze*), që trillon e shpërfaqet me një regjistër mendimesh e emocionesh si në një polifoni, duke mos u kujdesur thuajse fare për të vërtetën *safi*, për koherencën, aq të domosdoshme në epistolar dhe aq të tepërt në letërsi:

I. Dritëro Agolli rrëfyes i sinqertë dhe premtues për t'u ndarë nga pija:

Ti tani je lëshuar me tërë forcën tënde për të mos më lënë të pi. E shoh edhe unë që kjo të mundon. Kërkon edhe në letër që të të them si qëndron puna, të të them "me fjalë të thjeshta, po të sinqerta", siç shprehesh ti. S'e mohoj, kam pirë, bile kam pirë shumë. Po ti asgjë nuk di sa kam pirë më parë. Këtë kohë që jam me ty, nga marsi e këtej, unë nuk kam pirë as një të pesëmbëdhjetën e kohës së dikurshme. Sikur të isha alkoolizuar doemos do të vazhdonja në progres gjeometrik të pinja. Ndodhi e kundërta. Unë s'pi. Në raste të rralla kam pirë. Nuk kam kohë. Unë punoj. Si mund të vihem pas pijes? Sikur të ishe ti gjithnjë me mua unë bile edhe një gotë konjaku nuk do ta pinja. Po të dolli nami, një gotë të pish, dhjetë t'i bëjnë.

II. Dritëro Agolli përligj vetveten për pijen: sërish premton ndarjen nga pija:

Nuk kam asnjë shkak që të dehem. Kur nuk më shkojnë mirë punët në krijimtari, ma ka qejfi të hedh një gotë. Tjetër shkak unë, të betohem, nuk kam. Të kisha shkak tjetër, unë nuk do të lidhesha me ty kaq ngushtë. Nuk është e vërtetë që gjithnjë kur më ke takuar ti kam patur hedhur ndonjë gotë. Janë raste të rralla ato kur pi shumë. Edhe këto raste, të siguroj, se do të çduken.

III. Dritëro Agolli përligj vetveten për pije dhe përpiqet të marrë leje:

Unë s'jam nuse, një gotë, patjetër, do të ndodhë që do ta pi. Ama konditë më ke vënë: o gotën, o ty! Ç'të them unë? Të përdor parullën e kubanezëve? Gota jo, Sadija po? Mos u çqetëso fare për këto gjepura. Ti e di që unë kam aq vullnet sa një ves ta çduk. Ky nuk është as ves. Edhe të ketë qenë ves, është çdukur; ka mbetur ndofta jehona e tij. Kaq për këtë të bekuar pije.

IV. Dritëro Agolli kundërshton qortimet e tepërta për pijen:

Për atë që thua ti, se unë shpenzoj duke pirë, prandaj nuk ble pardesy, nuk është edhe aq e vërtetë. Do marr honorare dhe gjithçka do të rregullohet. Për të ardhmen tënde mos ki frikë dhe mos u bëj fisheke. Ajo duhet të jetë e mirë, bile më e mirë se ç'mendon.

V. Dritëro Agolli pranon i penduar qortimet për pijen dhe flet për dëmet e tmerrshme të saj:

Megjithëse kam mjaft shokë dhe nga natyra jam optimist, e ndiej veten çuditërisht të vetmuar dhe me humor të keq. Dje kam pirë shumë konjak që në mëngjes dhe jam bërë

tapë. U zura me njerëzit e shtëpisë dhe më thumboi një grerë në qafë. Aq më dhëmbi, sa për pak më dolli pija. Tani që nuk të kam ty pranë, nuk i vë rëndësi asgjëje: rri i parruar, i pahekurosur dhe me duar në xhepa. Kostumi s'ka ç'më duhet, e kam inat dhe nuk do ta qep.

VI. Dritëro Agolli heq dorë nga apologjitë, rrëfehet dhe mburret *me skandalet pas një dite homerike* në pije:

Nesër nisem për në Gjirokastër. Kthehem në Tiranë pas 10 ditëve. Bëra mirë që po ik, që të harrohen disa skandale që kam kryer pas nja dy pijesh homerike më 30 prill e 1 maj. E di që do të të bjerë humori, po meqë me të vërtetë kam pirë, nuk dua të ta fsheh. Burri yt kështu e ka ndonjëherë: rri, rri dhe i jep një dërmë tronditëse trurit të vet të sëmurë! Po mos u dëshpëro, kur të të kem ty pranë nuk do kem nevojë për këto "tronditje". Kam qënë shumë i dëshpëruar krejt i vetmuar kam qënë. Kushedi sa tavolina kam goditur me grusht.


VII. Një poezi e pabotuar e Dritëro Agollit, *Dionisit shqiptar të pasioneve jetësore, pijes dhe dashurisë*, "*prêtre de Dionysos*", sipas përcaktimit të përkthyesit dhe studiuesit Aleksandre Zotos, shkruar për pijen, dehjen, verën e gëzimet tokësore:


Kjo poezi është shkruar nga Dritëro Agolli dhe është bashkënënshkruar nga poeti Llazar Siliqi gjatë një darke gazmore në Shkodër, në formën e një shakaje miqësore, me një nëntekst sfide për pijen dhe hiret e saj. Poezia është ruajtur në arkivin e piktorit Ismail Lulani dhe botohet për herë të parë. Ajo është me interes edhe për studimin e ceremonialit më të nënçmuar, ceremonialit të dollisë, çuditërisht bashkë me atë të gjamës, gjatë gjithë ekspeditave etnografike shqiptare në shekullin XX:

Treshes

O moj treshja pranë derës
E rakisë dhe e verës
Mos na çani kokën shumë,
Se rakinë e pimë lumë
Dritëroi,
Llazari

PS: Mos u hiqni aq të urtë
Se ju hamë porsi turtë.





Ja dhe një krahasim tjetër midis dy letrave-kumt dhe dy letrave-trill. Dy shkruesit dhe pritësit e letrave, *inkluzivë* njëri më shumë se tjetri po aq sa dhe të dashuruar, na lejojnë që të bëjmë dallimin midis një letre që mund ta quajmë *me qark të mbyllur*, për një pritës të zgjedhur, dhe një letre që eventualisht mund të rezultojë edhe akt krijimi, me dy stacione pritjeje, një në kohën e shkrimit dhe një tjetër në të ardhmen:

Letra e një të fejuare në prag martese
(Sadije Agolli)

I. Mor i shkretë, sa zakone ke lanë ti mbas dore, sa do të tmerroheshe t'i plotësonje. Ndofta do të mbeteshe pa u martue fare sikur të respektojshe këto. Po t'i them tashti që është fundi vetëm sa për kuriozitet dhe jo për gja tjetër. Burri duhet t'i pregadisë grues dhunti si thohet këndej nga ne. Në dhunti bajnë pjesë këto gjana: zakonisht ato që janë me gjendje të mirë si të quejnë ty, tri palë këpucë, një palë

sandale, një pardesy, një pallto, nji kostum stofi, tre fustane stofi, tre fustane të mira vere, triko, unazë, sahat. Merre me mend mor i gjori ti; s'do të martoheshe kurrë se s'do të ishje në gjendje me e pregaditë për pesë vjetë e ma shumë. Ty s'të rrijnë lekë në xhep dhe jo të blejsh këto sende. Qerimi nuk e din se ti nuk bjen asgja, kështu që nana (kësaj i kam tregue) do i thotë që ma ke lanë "dhuntinë" në Tiranë. Tashti jam e gëzueme që ato s'kanë muejtë të më përulin sa unë të thosha ty zakonin e dhuntisë. Kryenaltësia s'më lejonte që të thoshnja asnji fjalë. Më 4 korrik martohet edhe vajza e tezes. Kam shumë inat se asaj i shkon dhunti dhe kushrinjtë do i shesin nanës mend. Ajo e ka plagë këtë dhe do të vuejë.

Letra e një shkrimtari (Dritëro Agolli)

I. Lexova një libër nga Dostojevski dhe më ka lënë pa gjumë me tipat dhe figurat e tij të tmerrshme. Një burrë tërë natën mendon para qivurit të gruas së tij, që ka vrarë veten. Cilat kanë qënë arësyet që gruaja e tij vrau veten? Rreth kësaj shkruhet tregimi. Ka një moment të hatashëm. Burrin e ka ftuar një njeri në duel (përpara se ky të martohej). Ai refuzon, nuk pranon të bëjë duel. Të gjithë e quajnë frikacak. Pas shumë situatash gruaja e çdashuron atë. Ai është shtrirë e fle. Ajo merr revolen dhe ia vë në tëmbth tytën e hekurt. Ai hap sytë, e shikon me gjakftohtësi tytën dhe i mbyll prapë. Gruaja tronditet. Përherë të parë kupton se ky nuk është frikacak. Po si është e mundur që refuzoi duelin? "Të refuzosh duelin - tha ai - kërkon më shumë burrëri!"

Letra e një të fejuare në prag martese (Sadije Agolli)

II. *Këto dreq zakonesh duhet t'i respektoj pak a shumë në Shkodër dhe kjo më mërzit. Ti, as Xhexheja të mos mendoni për petk nusërije, se do gjej vetë në Shkodër sido që të jetë. E kanë për turp të mos vishem se vetëm vajzat e shkueme*

nga mosha dhe gratë e vea nuk vishen, prandaj s'duhet t'ua prishi qejfin. Zakoni e lyp ta bëjë burri po me që ti je kundër zakoneve shkodrane nuk due që të bezdisë.

Letra e një shkrimtari
(Dritëro Agolli)

II. *Unë nuk kam qejf të më duan me rregulla, nuk dua të hyj nëpër unazë si akrobat. Bile unë kam qejf kështu: nuk e ndjen veten mirë me mua një ditë, thua: më mërzite, Dritëro, sot nuk të dua, nesër mund të të dua, m'u çduk tani nga sytë! Po njeriu është edhe rrufjan-hipokrit, që ka frikë të hapet e të shprehë gjithnjë të vërtetën. Megjithëse ti kështu nuk më ke thënë asnjëherë, po unë ka patur raste që çaste të tilla, të shkurtra fatmirësisht, i kam nuhatur. E di që këto janë në natyrën e njeriut, prandaj as jam mërzitur fare. Po mos nuhatnja të tilla çaste, unë nuk do të të desha dhe nuk do martohesha me ty. I marrë, do thuash, po është e vërtetë*

Ekziston një mundësi arsyetimi, për t'i barazuar në status të dyja palët në letërkëmbim: Është krejt normale që në letrat e Dritëro Agollit të ketë më shumë trill se në letrat e Sadijes, siç është gjithashtu krejt e pritshme që në letrat e Sadijes të ketë më shumë etnografizëm se trill, më shumë traditë se fantazi. Secili, përmes letërkëmbimit, shpreh kokëfortësisht individualitetin e vet. Dhe ky është një argument që nuk mund të shpërfillet. Por këtë çështje do të na e zgjidhte përgjigjja ndaj pyetjes: A mendonte Dritëro Agolli se letrat e tij do të ruheshin? Ka të ngjarë që po. Poeti Dritëro Agolli u formua në një mjedis ku letërkëmbimi ishte kult. Ai ishte njohur me traditat e shquara të letrave të dashurisë në botën ruse dhe ndoshta dhe ishte ndikuar prej tyre. Me të njëjtën kulturë ruajtjeje ai kishte mbajtur në arkivin e vet edhe tezën e diplomimit *Skicat dhe tregimet e poetit revolucionar shqiptar Migjeni*, që u bë e njohur në formën e

parashtypjes (*preprint*) në 85-vjetorin e lindjes së shkrimtarit. Nëse te Dritëro Agolli ekzistonte kjo vetëdije, kjo kulturë ruajtjeje, që për ne është e padyshimtë, kjo për ne nënkupton se, kur ai shkruante një letër, mendonte dy pritës: një të afërm, të cilit i drejtohej kumti (*orthos logos*), dhe një të largët në kohë, të cilit i drejtohej arti (*author logos*).

Jemi të prirur të besojmë se Dritëro Agolli e kishte këtë vetëdije. Dihet se ai kishte një kulturë të fortë ruajtjeje. Ai e dinte se ç'do të ishte për historinë e letërsisë shqipe qysh kur botoi vëllimin e parë. Në fund të fundit, a nuk na i kishte lënë ai vetë *të gatshme për botim* letrat e tij, të mbledhura në një fashikull, të sistemuara, të renditura, të përzgjedhura? Pjesë e kësaj kulturë ruajtjeje është dhe përfytyrimi i letërkëmbimit si projeksion, duke nënkuptuar me këtë lexuesin e projektuar. Le të përmendim se ai, shërbyer me vargjet e poetit të njohur Bagrickij, që në krye kishte hyrë në letërsi me një vetëdije tejet vetëvlerësuese:

Në rrugë dolla
Pas meje porta u mbyll.

V. *Dritëro i dashuruar; në vend të mbylljes*

Dashuri në moshën e Krishtit, në moshën kur *Krishti kish dhënë besën e re* dhe *i kishte kryer të gjitha*, po të shpreheshim me fjalët e Kutelit drejtuar Poradecit në vitin 1933: kështu titullohet ky vëllim me letra dashurie të Dritëro Agollit për Sadijen. Një sfidë e madhe, një profani e bukur dhe e këndshme prej autorit vetë, por për lexuesin edhe një tërheqje më shumë. Për Dritëro Agollin edhe bektashi, ashtu sikurse për Naimin (*Përpara Krishtitë*), Krishti dhe Imam Aliu i kishin ardhur kësaj bote si misionarë mesianikë. Vittoria Luisa Guidetti, studiuese italiane bashkëkohëse, në studimin e saj *Angeli piangenti*, kushtuar poemës *Qerbelaja*, e ka vërejtur me shumë mprehtësi

mesianizmin dhe prometeizmin tek të dy *Shpëtimtarët*.

Mund të titullohej po aq me denjësi *Dritëroi i dashuruar*. Lexuesit të mirë shqiptar i është mësuar veshi me këtë përfytyrim, si përfytyrim poetik, që lidhet me titullin e poemës së njohur *Orlando innamorato* të Mario Boiardo-s, shkruar prej tij në kulmin e ndriçimit iluminist europian dhe rishkruar një shekull më vonë nga Francesco Berni.

A do të ishte e besueshme që Dritëro Agolli ka qenë vërtet *i humbur në dashuri*, përherë i dashuruar, i kredhur e i sunduar prej pasioneve të forta dashurore, për më tepër ai i përgjëruar e i përvëluar në dashuri? A ishte Dritëro Agolli një shkrimtar i *letërsisë së pasionit*, apo ishte thjesht fuqia e pasionit të vërtetë, që përkthehej në këtë letërkëmbim të bukur si e tillë, duke pasur për autor një shkrimtar?

Është plotësisht për t'u besuar që po. Dritëro Agolli gjatë gjithë krijimtarisë së tij ka qenë i dashuruar. Madje që nga libri i tij i parë, ku gjenden poezitë e asaj dashurie që ka mbetur ende në Shën Petersburg. Ishte rob i asaj forme dashurie, që ai vetë e citon në krye, si burim frymëzimi për modelin e vargut. Dritëro Agolli e pati quajtur veten madje edhe *i përndjekur i dashurisë*. Dhe kur: në kohën kur botën shqiptare e sundon vetëm një mënyrë të kuptuari të persekucionit, që nuk ka nevojë të ftillohet. Ai mund të jetë i vetmi shkrimtar që është ankuar: *sa pak shkruajmë për gratë*, megjithëse është dhe i vetmi poet në historinë e letërsisë shqipe që i ka kushtuar gruas një vëllim poetik të plotë. Në poezinë *Dy fjalë poetëve që vijnë* ai shkruan:

Ne s'kemi pasur aq kohë të shkruanim për dashurinë,
Megjithëse kemi qenë dashnorë të marrë.
Vendi kërkonte këngë për lirinë.

Dhe, sikur të mos i mjaftonte dashuria, në një rast - *para së dashurës grua* - e ka quajtur veten *i përndjekuri yt erotik*:

Unë jam i burgosuri yt,
Rroj me prangat që ti më ke vënë,
Por çudi, as qelia s'më mbyt as dritarja e zënë.

Ky burgim sa do zgjasë s'e di,
I përjetshëm do kisha dëshirë;
Veç ti eja më shpesh në qeli,
Të përndjekurit tënd do i vijë mirë.

*
* *

Në historinë e letërsisë shqipe vetëm dy shkrimtarë, dy poetë, ia kanë lejuar lexuesit luksin për t'i thirrur në emër: *Naimi* dhe *Dritëroi*. Po të përfytyrojmë për një çast se çfarë refuzimi do të na bënte gjuha nëse do të tentonim t'i drejtoheshim në të njëjtën mënyrë cilitdo shkrimtar tjetër, duke përfshirë edhe ata më popullorët, do ta çmonim ca më shumë këtë luks. Në letërsinë italiane vetëm Dante ka krijuar të njëjtin raport me lexuesin, me njeriun brenda dhe jashtë letërsisë.

Libri *Dashuri në moshën e Krishtit* e afron Dritëroin edhe më ngushtë me lexuesin e vet. Por rëndësia e këtij libri do të provohet edhe nga ndikimi i pritshëm si faktor emancipues, si përurues i një tradite të munguar, gjithashtu dhe si një nxitje për të afërmit e personaliteteve të dijes e të kulturës, që të guxojnë për të publikuar diçka e shumëçka nga *rezervàti* i arkivave familjarë. Mund ta parafytyrojmë se si, në këtë mënyrë, duke i ndarë me lexuesin *të shkruarat për vete*, sa do të ndikohej që letërkëmbimi intim dhe letërsia e pasionit të zinin një vend tjetër ndër llojet dhe nënllojet e letërsisë shqipe. Parë në këtë dritë, Dritëro Agolli me këtë libër i shpërfaqet lexuesit në një anë tjetër, që na lejon ta shohim edhe si një misionar. Ai bëri gati të na rrëfente

të parrëfyeshmen. Jo rastësisht libri mban titullin *Dashuri në moshën e Krishtit*. Me këtë libër duket sikur ai vjen tek lexuesi me *Besëlidhjen* e tij, me *Besëlidhjen e dashurisë*. Dritëro Agolli jetoi brenda një trinie të vetën: gruaja, toka dhe atdheu. Zotin do ta besonte *vetëm po ta shihte duke lëruar ugarin*, kështu ka shkruar.

Shaban Sinani
Tiranë, janar 2018

Shenjim i redaktorëve:

Dashuri në moshën e Krishtit përmban letrat intime të Dritëro Agollit shkruar për Sadijen në vitet 1964-1965, menjëherë pas njohjes dhe lidhjes së fortë me njëri-tjetrin. Njëri në Tiranë e tjetri në Shkodër, gjatë atyre dy viteve pritjeje për t'u bashkuar për gjithë jetën, ata shkruan shumë letra dashurie. Letra shkroi dhe Sadija për Dritëro Agollin, dhe ato përfshihen në këtë vëllim. Janë 44 letra të shkruara nga Dritëroi dhe 20 nga Sadija. Kanë qenë pa dyshim më shumë, por, në *fashikullin Letërkëmbimi me Sadijen, 1964-1965,* që shkrimtari e kishte sistemuar në gjallje të tij si një koleksion i gatshëm për botim, kaq janë ruajtur.

Letërkëmbimi intim i Dritëro Agollit me Sadijen është vetëm një pjesë e epistolarit të tij. Si fashikuj më vete ruhen gjithashtu *letrat me njerëz të njohur, letrat me lexuesit dhe letra të ndryshme.* Por pjesa më e madhe e epistolarit të Dritëro Agollit ruhet në arkivat familjarë të miqve të tij.

Epistolari është i pranishëm në trashëgimin letrar të D. Agollit në të dyja format: si nënlloj letërsie dhe si korrespondencë private. Në romanin *Arka e djallit* në formën e letrës për një mik është shkruar romani *Shakaja e ndaluar* dhe po ashtu edhe 15 letrat që ruhen në sënduk për Hyskë Borobojkën, për t'i lexuar pas vdekjes. Letrat e këmbyera midis Dritëro Agollit dhe Gaqo Veshit në vitet 1968-1969, nënshkruar me heteronimet Bamkë Çomaga dhe Hyskë Borobojka, janë botuar nën titullin *Tre qeshin, një inatoset.* Të shkruarit në formën e korrespondencës vetjake ishte një përpjekje për të krijuar një *vetje tjetër*, një alter ego në krijimtari, më të shpenguar, më të justifikuar për lirinë e mendimit dhe të shprehjes.

Koleksioni që botohet në këtë libër ka shumë rëndësi jo vetëm për të njohur botën brenda shkrimtarit, por dhe për


faktin se tradita e letërkëmbimit intim në Shqipëri është shumë e varfër. Kanë ndikuar shumë faktorë për kufizimet e kësaj forme të shkruari, që nga analfabetizmi deri te kontrolli shtetëror mbi korrespondencën.

Letërkëmbimi i Dritëro Agollit, si çdo letërkëmbim, i është adresuar një lexuesi të vetëm, së dashurës. Por nuk mund të përjashtohet dhe një lexues i projektuar, lexues i së ardhmes, lexues publik. Fakti që vetë shkrimtari i kishte sistemuar në një fashikull, duke i lënë të gatshme për atë që do të donte t'i botonte provon se ky letërkëmbim qysh kur u shkrua ka pasur dy regjistra komunikimi: i pari si letra dashurie dhe i dyti si letërsi pasioni. Stilistikisht është shumë e lehtë të dallohet D. Agolli si letërshkrues, si kumtues, prej D. Agollit si shkrimtar brenda të njëjtit koleksion letrash.

Ky letërkëmbim mund të konsiderohet një rezervàt burimesh dhe të dhënash për atë që mund të quhej *etnografia e shtëpisë*. Studiuesi mund të mësojë përmes tij për mënyrën e jetesës në një familje tradicionale myslimane veriore dhe në një familje liberale bektashiane jugore; për dallimet në rite e zakone, për dallimet kulturore dhe krahinore.

Botimi i këtij letërkëmbimi u shërben studiuesve për të ndërmarrë krahasime midis kumteve joletrare të D. Agollit dhe letërsisë së tij. Këto dy mënyra të shkruari shpesh pajtohen e më shpesh nuk pajtohen. Në njërën anë, në letërkëmbim, gjenden karaktere që shihen në dritë të virtytit e nën hijen e vesit; në anën tjetër, në letërsi, janë karakteret kryesisht entuziaste, nën optikën e optimizmit revolucionar dhe në sfondin e industrializimit e të emancipimit.


DORËSHKRIME



E dashura Eadije,


Po pranoj në shtëpi sod, se dua të mbaroj një artikull nga ata të ciklit të shkëmbimit tim në Korcë. Nuk më pranojnë mëntë. M'u mplovë ti dhe, në vend të 'artikullit', po të shkruaj këtë letër. Sikur ta merrte vesh redaktori, s'kamedi do të ishte!

Më duket se tani unë po e provoj që me të vërtetë të dua. Ndofta za ishe këtu ti, më tërheqje instinktivisht si vajzë, si njeri i imët, që donja të shkëmbeja dy-tri fjalë, që donja të ndjenja një frymëmarrje të njeriut. Po tani tek unë po vjen dukas u thellua një ndjenjë tjetër e fortë, e zgetësuar, me nevoi të mathë. Unë nuk të kam thënë shumë ty për ndjenjat e mija ndaj teje, ose të kam folur mëciptazi, se dukem të të flisnja si pas zakonit të përgjithshëm. Po tani unë vë i vetëm në dhomë e mendoj: Mos vallë unë vecse u ambjentova me këtë vajzë!? Sikur të ishte kështu do të ishte fatkeqësi. Pse? Sepse unë ka gjë më të keqe se za ambjentimi në marredhënie të dy njerëzve që duan të martohen. Ambjentimi është një i fundit, bile pare i aferizmit të ditës. Në ambjentim jeta jonë do të kalonte aferizmit të ditës: Do hanim bukë në mëngjes, do shkonim në punë, do kthehesim në shtëpi, do çlodhesim, do thoshim: «a dalim pak, hanë ndonjë pastë?» Do dilnim, do hynim në «Flora» apo Kafe Tirana», do të ti linja të fusheshe di e para për biv të mirëzjellies dhe edukatës. Do vinim në shtëpi. «E, po na thuaj ndonjë fjalë!» E unë do thosha ndonjë fjalë. Do mbaronim fjalët e do flinim. Ja ky është ambjentimi. Dhe këtij unë i kisha frikë, frikë si djallit. E shoh, pra, se unë nuk jam ambjentuar me ty në këtë mënyrë dhe as që mund të ambjentohem. Unë ty të dua në një mënyrë tjetër. Është një ëndërrë shpirtërore e madhe, janë ca ndjenja të turbullnara, bile ndonjëherë edhe si të egra. Tek ty unë gjithënjë synoj, gjithënjë përpiqem, vij. Vij i ngatërruar, nuk e di sa se vij aq i gatë dhe aq pjekur ti më sjelle e më analizove. Eh, moj fisheke! Vecse gjithënjë të dua.



② më nuk jam aq i zjellshëm. Më mungon shumë etiketa më merëdhënies me sensin delikat. Ti edhe nuna të më-kësto shpesh më mungojnë. Je për shembull. Më shkove në korcë. Nuna të të telefonoje që andej. Harrova. Vij në Shkodër. Duke parë ambjentin, nuna të jem më i regullt në veshje e në të gjithë. Harroj. Nuk i bëj dot. E ndjej që jam ca gjëra të xëgia në zjellëm time, po nuk ju shmangem dot. Më e dij që do ta kesh ca veshtirë me nuna, se jam i papëdhëndur, po ngjesoren më e kam: dashurinë të ëmbëtë për ty, jo një dashuri thjeshtë për një puthje në hënë.

E, si vajti ajo punë! Nis të shkruaj artikull dhe përfundoj në letër dashurie. E di ti se më nuk di të shkruaj letra dashurie? Ti nuk e besoni, po kjo është letra e katërt në tërë jetën time. Letra jote nga Shkodra më bën shumë përshtypje dhe më tremb. Një nit të tërë ty do të mundohen të ta çkulin atë çka ke të bukur e të mirë ndryshe të ëmbëlsë. Ti ate në vrethin tënd më duket se ke lypë si një pykë në një dru të trashë e të vjetër, dru të madh, të pamposhtur. Ky dru çdo pykë nuna të thyejë. Kam frikë, se, megjithëçë dashuria shpesh nxjerr i bën heroike, ti, duke dëgjuar ngahera të flitet keq për nuna, do të mërzitësh e do të ftohesh, do bëhesh si të gjithë dhe druri i madh e i vjetër do vaghdojë jetën e tij të mëparëshme pa u çgetësuar. Cuditem me ca njerëz. Si nuk ka pëlluar ai plaku konshi për të shkuar tek yt ati e për të më mbulluar nuna me baltë? Unë me anjë plak nuk kam punë, se nuk kam ç'të bisedoj me njerëz të tillë. Njëlin kur pi ka dëshirë edhe të bisedojë, të bëjë muhabet. Ne kemi patur një konshi e ky është



(3)

i ati i Ylir Gjylbegut, një shkodran i vjetër dhe i
ndershëm. Ai vetë është një gegë i rrallë sa s'bëhet. Si
është e mundur të vetë dashur mbi mua kaq baltë? Hy
plak i urtë na ka parë me të dyve për krahu. Jam i bindur
se do të vetë gënë ai vetë që i ka folur keq të t'ëti.
Cudi em edhe nga një fakt tjetër. Gruaja e Ylirit,
d.m.th. nusja e plakut, i pat thënë Xhexhesë se
ata kanë një të kushëririn e Ylirit për të mer-
tuar ca kohë do të ishte dikur Dritëroi të fejohej
me të». Natyrisht që më as e vura në zjarr
atë një. Pastaj gruaja e Ylirit filloi të më shajë
në zy të të fjetëve. O Si është e mundur që më
për kushëririn e tyre të mos jem pjesëmarrës dhe
për ty të jem pjesëmarrës? Po ti mos u mërzit nga
këto. Janë thashethëme të zakonëshme. Një njeri i
mirë ka thënë se asaj dardhe që ka kokra i
bijen me gurë.


Ti më thua çë më të bëj një kostum. Më duket
se nuk ka ndonjë rëndësi. Dramaturgu dhe poeti
i dëjnar francez Korneli nuk i jepte asnjë rëndë-
si veshjes dhe deltë jashtë si të mundëte. Kur
një miku i tij desh ta kritikonte për këtë, ai ia
përgjigj: «Mos vallë kështu jam më pak Kornel?»
Me këtë nuk dua të justifikoj veshjen. Sidoqoftë po të duash
ti edhe kostumin mund ta bëj. Më nuk dua që
ty të të bëjnë me nervoz. Bile mendoj që edhe ato
dreq shënja (shënja gjuhen?) A'i dëgoj. Veç ty
mos të të mërzitën.

Më nuk mund të mos të të thosh ty. Ti duhesh të
vish më tiranë herë pas here. Tek më do të vish dhe jo
tek ndonjë i huaj. Është një këmbëngulje e koti ajo
e njëzet të tu. Në qoftë se ti e ke lidhur jetën me
mua s'ka përse të hiqësh dashuri me ferexhe». Tani po
e le letrën se më mërzitën artikujt.

13.VII.1964

Të puth

Dritëro



P. S.

Nuk dosja të mirrja këtë letër, se e dinja që do të vinte më vonë se sa të mbrinja unë në Shkodër. Megjithatë mendova që të dërgoj, pasi ka ëndrra shkruar nuk duhet të humbasë. E mbajta letrën në xhep vetëm për arsye se m'u duk mjaft sentimentale ajo që kisha shkruar. Unë në përgjithësi jam sentimental, megjithëse shkruaj kundër sentimentalizmit. Në përgjithësi unë nuk i kam ato gjëra letrat, po të më shtyjn të bëj kundër dëshirës [illegible] sime. Se të dua, prandaj; mos fjalë!

9.

16. VII-864

5.X.1964 - faqe 43

E dashur Sadije,

Sot nisem në Rrëshen me urgjencë.Dje më telefonoi Ramizi për të gjetur ca volutë,po nuk munda dot të këkoj sepse më duhej me doemos të nisesha.Kur të kthehem perseri në Tiranë me doemos do të gjej aq sa ti kërkon,veçse kam frike se mos i deshe shumë shpejt. Mendoj të shkëputem ndonjë ditë nga Rësheni për të ardhur tek ti.Po të vij shpejt do të dukem drejt nga shkolla jote. Bën ftohtë dhe andej nga ata male të Mirditës do të ngrij,veçse në më ngrohtë fryma jote,po edhe ti do të jesh larg.

Mos u çudit që po të shkruaj me makinë.Nuk e kam penen me vehte dhe përtoj të ngjit shkallët ta marr.


Si je me shëndet,me gjëndje shpirtërore,me punë?

Hë për hë mirupafshim!Shpejtoj.Po më ik autobuzi.Të dua e të puth si gjithënjë.

Yti Dritero.

24.IX.1964

13.X.1964 - faqe 44




E dashur Eadije,

Edhe 33 vjetët e mij mbetën prapa. Që nuk mendonja fare për ditëlindjen, file e kisha harruar. Në mëngjes, Zot, u kujtova. „More, po unë mbush 33 vjeç"?- thashë me vete. Nga s'jam lodhur në këta 33 vjet! Të rriturit të mundohesh të zjen koka. Edhe kaur po ikte i 33 fit, ose më mirë që kur kish lypë, unë të rijoha ty. Gjendafta ka gënë gjëja më e mirë në këta 33 vjet.

E ndjej veten mirë. Ti më dërgove telegram, më more në telefon, të dëgjova të flasësh. Të lëneën ne të dy nuk u ndanë ag mirë. Tërë mugës kam gënë i dëshpëruar dhe asgjë nuk mund të më gëzojsh. Në Milot nga kuitimi e kumba ombellën. Nuk ka gjë, shkoi edhe ajo të kërkojë të tjerat.


Mua më duket se ti ke nevojë që unë të jem pranë teje. Ti nevrikosesh, rrëzohesh dhe duket pa-



2

fjalën të kosh afër një njeri që të të
përëndlelë e të të gëtësojë. Edhe unë
bëhem ndonjëherë i padurueshëm,
po jo se dua. Edhe të bëra ca
pyetje fisheqërk më lëtë: "Mos t'u
mërzita?" Më vetë të kam
zjedhur ty të atillë që mos më
mërzitesh kurrë.

Në dasëm nuk do të shko-
nja atë ditë, po ti po ikuje dyejt
dhe më e shtinje se po më vë-
titej një mërzi më e madhe se
kalaja jnaj. Sikur mos kisha
shkuar do të ishte më keq se
do të ziinja ndonjë gosbe e do
të rrinja vetëm. E dij që dy-
teti jnaj ka shumë fjalë, po mua
nuk më bëjnë përshtypje. Dasmat
praindaj bëheni, që njerëzit të mos
jenë si ditët e zakonëshme. Më
shumë më pëlqen një shofer dhe
i vëllai i Verës. Atje u gjinda




-3-

me rjerrin se për 1'm tallur e
mori këngën «Te vrapi në Mashku-
llorë». Kur tha ai:
Foli cerçizi me bojë:
deri djemtë e mij të shkojnë
Se ju kuq ju këij me bojë

unë i thashë, duke e përmbajtur na-
tin: «Cerçizi ka shkuar në ballë
edhe 'bimbashë, kurse ti nuk
din të shkuçësh as ...» e vetëm
thashë një fjalë që nuk ishte
fjumë e këndëshme.

Librin me vjershat u nënshkrova, duke
e dashilopsuar vetë dhe prandaj
ia dhashë një dashilografisteje.

Ti më thashe në Telegram
se Elena lindi djalë. Unë i
telefonova në shtëpi. Më thanë
se ishte në punë. Ty telefonoj
në punë. Si, moj, e'bën atje?
Ku e ke djalin"? Atje u endë.
Nga e more vesh ti se ka



-4-

kinduer?

Këtu parati mos kij merak se kam vënë agjentë të fortë 'pas të këtunit.


Ka mundësi që pak më vonë të vij andej afër me ndonjë shërbim dhe të diskutoj pa pritur e kujtuar nga ti. Po kij ëndrë këtë për të një projekt.


Si je tani? U getëzove? Jot ra këtesh merak.

Të puth shumë
Dritëro

13 Tetor, 1964


31.XII.1964 - faqe 62





Si e pakesnshme arësyeja.
Mëpjithatë s'ka gjë.
Edhe njëherë të uroj
1965 të uroj sic mund
të urrejë një njeri kaq
i lidhur i lidhur me
ty, e kaq i dashur.
Të puth
Dritëro
31.12.64

10.III.1965 - faqe 100




Ty dashtun,

Të falemnderit për mirsin e 8 Marsit, më kishte vrue, si nji burrë i dashtun. Dashtí po ndëgjojsh nji kangë të bukun italjane dhe dora më shpejton nga ritmi i shpejtë i muzikës. E çmoditëshme sa e ndjej muzikën mbyshsh krejt kahern ma e bukë, më zhdukken nervat. Më ka marrë malli që të ndëgjojsh tek ti muzikën e Betovenit.

Ty dashtun po punon shumë, koalherh ?

Deri tashti jam në regull, se kontrolloll mik kemi pasë. Mërzitem dhe më vjen inat që nxanësit mik pregadisen, dje i shqepa me dyrha. Si shihet do të mbes shumë, asht gjynah t'i kalojsh mik.

Përsëri fillova kartinet, kësaj herë do të vazhdoj me koregjime deri ka so të vijsh si i dashtun në Shkodër. Kohe mungi Mars zoti se iken, mos u mërzit. Sadija s' mundet të ndryshojë mendjen mbas 8 muejve, aliambaj asgjaje mik i dihet në gjetë fundshi por tashti për tashti ty të dua dhe s'ka asnji që të zejë vendopak vendin tand. Të thashë se do bahem serioze në shkollë—. Të hanën ishe apë shumë sa rashë në sy të gjithëve, ma tepër kam ndejë në klasë ose me dërbyezem. Dje isha ma e qetun, e kam zor të ndryshoj tipin po diçka do ta ndryshojë se edhe mue mik më




pëlqen tipi im, fjerët e mania për të kep siç të
thanë by gazetarit shoku i yt.
Dikur kam ishe në Tiranë, në vitin e ~~q~~ e të ~~p~~, kam
më ngacmonte ndonji mugëis kishe një dëshirë të
madhe t'i binja shpullë edhe tashti e kam këtë
dëshirë t'i binja atij buftit Mark. Shiko që nuk e
kam hëtë zinxhirin në shkollë se do e shanja në
ay të gjithëve në drejtori, me mos qenë e sigurtë
a e ka thanë apo jo. Si më njeh ma mirë se
të gjithë s'ke pse të bahesh xheloz. Më kujtohet e
shtrëngja kur endhe dhe u çudisha me horin
sandë të asaj nate. I dashtum mu të di sparë
të dilemej, si ishe në Shkodër dhe si kam
qha të tregoj. Me dy fjalat tuja morëm edhe dy
fjalë nga Shkelzeni që i kishte shkrue para një
muaji esht mënyrë shumë e shkurtë. Mos harro
posaritë e mija, edhe kostumin, gepe se pranvera
endhë, deri për diasëm dilo gepësh edhe një fjetër
kam të manush lekët nga libri.
Në Shkodër fiyen erë e ftohtë, si dukej plakat
duen të sfaqin revoltën e tyne ndaj shtetës së
re, ndaj fjetkisë së vajzave të reja, duen t'i
shëntojnë edhe disa ditë me mgjynën e verdh
(Plakat janë dikë e ftohta të thanit, mgjithësesi
kanë edhe disa dhisë që të vijnë).
Të fotografinë a kane gja, a e mbadhanve. Mos
harro të më bajsh edhe mue një kopjë. Gjith-

Mësuesi nuk kanë për ato të fotografitë që të kam dhanë. Si fol me Vitore në emën tim, gjoje pa e ditë unë se ai ka nji të dashtun.
Megjithse se tuninin e ke të kundisun nuk kanë ta çkundisësh, se dhe të mbesë gjithçkaje i çkundisun, dhe të zëmrohet me ty dhe s'dhe të ndiejsjoje të kundiset ma vonë kur ti nuk kujderesh për ate. Tuninin të vi unë dhe të kerk të nja të tjera që dhe të kundisin tuninin tand pjellor. Ulu dhe shkruej i dashtun tashti se ke kohë të lirë se ma vonë nuk dhe të le unë kohë të lirë.

Të puth shumë
Sadija

10 - 4 - 65.
Ora 10.30 paradreke.

15.IV.1965 - faqe 109



Y dashtmi miku im.
Sot jam pak e sëmurë dhe s'kam shkue as pareare
ke në shkollë, as mbasdreke. Y lajnërova me Melidi-
në. Mirë që kam marrë kaq të kujdesëshme dhe
sikur ma largon pak me shkrimet që më bën
vazhdimisht. * Sot kishe pak edhe se më mbloi
me oby jargava dhe shikë nji dhe kishe të
ftohtë. Pina konjak dhe ai sikur më nxolm
e më ka bredhë në gjumë 3-4 orë. Daneti jam
ma mirë mos u ban mesele, gjana që kalojnë
janë këto. Nana ma ka mexalenu kur të vi në
Tiranë dhe kur të linoli. Di kaq e s'duron, po
ma vonë inhalla bahesh ma e fortë.
Dritëro gjithë këto kohë kam qenë kaq e mërzitur
nuk di as unë. Po e shnej radion se asht nji
muzikë që të shton trishtimin.
Di do të çuditesh se ke kaq kohë që s'ke marrë
letër. Të kam shkrue por nuk t'i kam postue
nga që nuk donja të të mërzitnja ty.
Kam jehue nji javë të tanë me gëzimin se
do të vinja në Tiranë, se do të flenja nji dhomë
kur do t'ma ndante vetëm nji murë. Sa andra
Hmashe nji javë dhe këto u fikën për nji
orë kur mora vesht se nuk ka bilieta.
Unë kam nji dreq koke që nuk i lutem
asnjit të më plotësojnë dëshirën, as ty i dash
tun nuk do të lutesha shumë për nji gjë
por do t'u zëmnojshe. Kështu jam zëmnue

me Dhidin dhe unë i flas, megjithëse si
vjen çdo natë të më marë në shkollë. Dikush
më vjen zor prej tij, ai dy-tre herë më ka
folë, bile e kishte kërshillue që të mos takoj
te ty në Dinarë.
Y dashtun kem do të vijnë në Shkodër më
ka marë malli shumë. Gjej ndonji rast të
të. Libri të ka dalë shumë simpatik po
ato dy të fundit ma mirë të mos i ki
dhe shtue se janë ma tepër reportazhe
me mumo e shifra.
Të shohim tanimo kritikat, i presim me
gota konjakun. Dina me Verin nji gotë ko-
njakun isht tek unë. Mirë që kam shoqeni
në dhe ma largon mërzinë, herë vjen Veri
herë Luigjina me dilin.
Luigjina më thotë që vajzen te punej me
emnin e saj dhe se ka me janë e bukun.
Ç'bindellallëqe librezojnë.
Ishe nji dit paradreke nga ajo për vizitë.
Gjeta dy pleq po bisedonin për histori, penin
dhen e Skenderbeut. Unë u kërita si vajze
e se me diplomë. Më shpëtoj historia që
spreqesj dhe fillova të bëj mundsbet me
ato, se Luigjina mbi ishte.
Veç të mos shkuinje tue ba mundsbet me to do
të peshinje. Ato dinin gjithë të lugja dhe i
Pasha zili. Njeni prej tyne mërsonte Luigji-

italisht. Të kisha lodhë të tinë kisha shkue
edhe unë me mësue, po sa të mbaroj këto orë
paradheke do të filloj edhe unë me rukun, të
ta kaloj ty frengjisht.
Viton a e ke takue, a keni ba muhabet. Ajo
lili esht shumë e bukra, e shoh çdo herë dhe
më duket keq e mirë. Do ta ndilmoj më letërsi
se ka me dhanë provim. Ikenë mbetë vetem
provimet e matures pa dhanë.
Dritëro po blej kostumin e kanjos me valutë,
kesaku që në se a shue mikut tand shumë
kostum të ndamë të bukur amá.
Më duket se të parën oferë lirë në Shkodër, po
më shumë kjo mutra e vogël po mu i besoj
kësaj se e ka pa në shtëpi dhe më gënjen
Elenën i kam shkue kotë. Ofarë dhuruate i
ke gue mor fishek?
Në Shkodër bie shi i mengjishem. Si kem do
të vijsh?


Të puth fort Sadija

15·IV-64

P.S. Harrova të pyes për Shelalin a ke folë.
Mos e len në harresë, ma mbaro këtë
lutje se mu do të mërzis ma.


Të puth Sadija

5.V.1965 - faqe 116



E dashur Ladijé

Biletën e kam me vehte. Nesër ni-
sem për në Gjirokastër. Kthehem
në Tiranë pas 10 ditësh. Bëra
mirë që po ik, që të harrohen
disa skandale që kam krye
pas nja dy pijesh homerike
më 30 prill e 1 Maj. E di
që do të të bjerë humori, po
me që me të vërtetë kam fjalë,
nuk dua të ta fsheh, e da-
shur?! Burri yt vërtetë e ka
ndonjë herë: ri, ri dhe i
jep një dërrmë trondítëse
trurit të vet të zëmurë! Po
mos u dëshpëro, sevr të të
kem tu pranë nuk do kem
nevojë për këto trondítje". Kam
qënë shumë i "dëshpëruar dhe




– 2 –

Vjet sa kesh sa i bashk


kam patur shumë nevojë për ty. Krejt i vetmuar kam qënë. Kushedi sa tavolina kam goditur me grushta. Para një të kam dërguar tri letra, kurse ti asnjë. Merak të madh kam patur: a u shërua vajza e bekuar, apo jo. Ti kam pyetur vëllain. Si e paskë që ti nuk përgjigjeshe të mora në telefon. Atëherë u gëzova. Sa gëzim!

E dashur, ky udhëtim do të jetë i gjatë? Gjirokastër, Memaliaj, Tepelenë. Po ty gjithmonë do të të kem me



– 3 – Sime intervenon kon-
vulte. Pirje dhomerike
nuk do të bëj, të jesh e
siguruar.
Kur të vij në Tiranë, me
siguri do të zjej letrat
e tua të dashura. Gjatë ambulancës?
Të falënderoj të fala të gjithëve
edhe nenës edhe Qeri-
mit
Të puth shumë
shumë para se të
hyp në autobus
Gjitero
5. V. 65

11.V.1965 - faqe 117




— E dashur Sadije,

Ka shumë kohë që nuk të kam parë. Gjatë kësaj kohe kam ndihëmuar, jam zënë me punë, kam qënë i mërzitur. Ehu, c'kanadahun! Po ta shkruaj këtë letër nga një klub i Mamaliajt, që ti jo vetëm që nuk e ke parë po asnjë e ke marrë me mend ndonjë herë. Edhe letër për të të shkruaj ty nuk do të kisha, pikun mos më kish shtënë një libraz-antiquar në gjirokastër para dy-tri vitesh sa të niseshta për në Mamaliaj.

Nuk më duket pikun ka një vit që nuk të kam parë. Edhe fytyra jote më buket tjetër. Më shumë mbaj mënd ato ditët e korrikut të 1964, kur u nisa për në Korcë; të mbaj mënd edhe ty kur të lashë vetëm. C'barbar kam qënë! A po jo?


E dashur, mos i vër re budallë-



– 2 –

llëçet e mija. Mos e vërë re, edhe atë
që pak të shkruaj. Nuk mbeti shumë për
të shkruar. Edhe një muaj e gjysëm
ka mbetur gjer atëherë, kur unë nuk
do të kem nevojë për të të shkruar
ty.


Sot u mora një gjirokastra me Memaliaj.
Më përcolli ca shokë të rinjtë. Vetë
atë ma prenë biletën. U bënë pati më
të gjatë kur më mirën. Më thanë që
të vëheshem prapë. Nuk e dij do
vëtohem a po jo në Gjirokastër
(matyrisht nga andej do të vij në
Tiranë). Bëra një taksim (si shkruatës)
me oficerët e Gjirokastrës. Sa
njerëz të mirë! U mbledhën
të gjithë e dëgjonin fjalë për fe-
lëzinë. Fola sinqerisht, po
më mirë duhet të përgatitesha.
Ata bënë shumë pyetje. Mendova



-3-

se mos bëmin ndonjë pyetje inti-
me (për ty). Të tilla pyetje pa-
rashikojnë takimin me nxënë-
sit e gjimnazit dhe pedagogjikes
se Gjirokastrës. Jane shumë çapkë-
në.

Nuk e dij kur do vij në Shko-
dër. Ose të vij në shpejt. Edhe
dasmën nuk e dij si do ta bej-
më. Oy vëndi pëlmë vere
kam siguruar: në Vlorë e Pogra-
dec. Në Durrës kam shumë shpre-
za. Më mirë në Durrës se
luxhime nuk do të ketë,,
po të jetë fletë-kampi. Ti
mos u mërzit. Të pjitha vijnë
në vijë. Unë, me gjithë mra-
mërzinë e mijë që kam bërë, jam




– 4 –

i forte dhe i dashuruar me
ty si një gjimnazist (sa here
ta rrown thënë! O Zonte Moti!)
Kur të takohemi do të të
them shumë aventura gezha-
rrace.

Të puth shumë, shumë

Mendiaj
11. V. 1965



E dashur Sadije,
Kjo është letra e fundit për
1864-n. Buzun ndodhi me
ne. Na ishin dy njerëz
diku në një gyteh, u ta-
kuan, u dashuruan. Viti
ecte, ecte. Dhe rështu
ndhi dita e fundit e 1864.
Njerin ditën e fundit të
vitit bëhet pak filloso,
apo jo? Të kujtohet
kur më ze takuar mua
me një shishe në dorë
djet në këtë rrohë? Ku të
dinje ti se ai njeri me
atë shishe një ditë do të
bëhej burri yt? E shoh

za të papritura ka në një
vit? Po ti mund të
mos kthehesh gjuaj ime.
Kudo që të ishe e me
kënd që të takoheshe të
do të ishe njeri i mirë dhe
i burrë. Ndofta unë të
të kam ëndërruar edhe
në vite të tjerë, edhe pa
të parë? Ë, ku ta dish? Po
bëhem pak mistik. e
gështrak.

Në fund të këtij viti,
plot dashuri për ty, të
uroj të jesh e mirë,
e burrë, e dashur. Unë
jam ngjehere edhe burrë
edhe i dashuri yt.
të puth shumë, shumë

NË VEND TË NJË MBYLLJEJE

Një zarf pa letër brenda

Vijon në ... →

~~Një~~ Unë e dua shumë Sadijen, gruan time të çuditshme. Më vjen mirë, madje shumë mirë, që kam një grua me çudira; edhe vetë jam i çuditshëm.

Një zarf pa letër brenda

3.1.2015, ora 4.10

Ne të dy, unë dhe Sadija, jemi bjerrë që zihemi me njëri-tjetrin, bie dhe puthemi me katër buzë, zihemi me gjuajo dhe dy unë. A shkëputet kjo kaseshmi? (kaseshe mishi)

office strip
MISTO
Cartiere del Garda
FSC FSC® C002810
PIGNA
1889

3.1.2015, ora 4.10

Ne të dy, unë dhe Sadija, jemi bjerrë që zihemi me njëri-tjetrin, bie dhe puthemi me katër buzë, zihemi me gjuajo dhe dy unë. A shkëputet kjo kaseshmi? (kaseshe mishi)

PËRMBAJTJA

SEKRETI I NJË DASHURIE JETËGJATË
Parathënie nga Sadije Agolli 9

LETËRKËMBIM 1964 27

LETËRKËMBIM 1965 65

LETËRKËMBIM DHE LETËRSI PASIONI
Pasthënie nga prof. Shaban Sinani 135

SHENJIM I REDAKTORËVE 197

DORËSHKRIME 201

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Agolli, Dritëro
Dashuri në moshën e Krishtit:
letërkëmbim 1964- 1965 / Dritëro Agolli, Sadije Agolli;
red. Shaban Sinani. – Tiranë : Dritëro, 2018

232 f. ; 14x20 cm.
(Kronos. Publicistika dhe memuaristika; 10)

ISBN 978-99927-34-73-5

I.Agolli, Sadije

1.Letërsia shqipe 2.Letërkëmbimi
821.18 -6

ISBN 978-99927-34-73-5
9 789992 734735